



Tirana International Conference
of Justice Inspection Services 2022

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E SHËRBIMEVE
TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË
TIRANA 2022

INTERESI I PUBLIKUT
NË ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË
DHE PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE

Organizuar nga:



Bashkëfinancuar nga:

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE
E SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË

Tiranë, 24-25 qershor 2022

**INTERESI I PUBLIKUT
NË ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË
DHE PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE**



INTERESI I PUBLIKUT NË ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË DHE PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE

Botim i institucionit të Inspektorit të Lartë
të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë

Ideuar dhe redaktor teknik ligjor:

Z. Periand Teta,

Inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Organizuar nga:



Bashkëfinancuar nga:



Kjo iniciativë u realizua nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë me mbështetjen e Bashkimit Evropian, si dhe u zbatua nëpërmjet Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ).

© 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet në çfarëdo lloj forme apo mjete pa lejen paraprake me shkrim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit.

Përjashtimi i përgjegjësisë:

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve të shkrimeve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë.

ISBN: _____

Redaktor Gjuhësor: **Arianisa Laze**

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	7
MESAZH I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	8
SESIONI I:	
Kompetencat, organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të inspektimit të drejtësisë. Një këndvështrim krahasues	14
Inspektorati gjyqësor i rumanisë, format e ndryshme të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënia me institucionet e tjera	15
Kryerja e inspektimeve dhe procedurave disiplinore të magistratëve për të rritur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në Greqi	22
Kompetencat, organizimi dhe funksionimi i inspektorateve bullgare përgjegjëse për kontrollin e magistratëve.....	34
Praktika e inspektoratit bullgar lidhur me deklarinimin dhe kontrollin e interesave pasurore të magistratëve si garanci e pavarësisë dhe integritetit të tyre për të rritur besimin e publikut në sistemin gjyqësor.	42
Inspektimi dhe kontrolli i punës së magistratëve dhe gjykatave sipas legjislacionit italian. Roli dhe aktiviteti i shërbimeve të inspektimit.	62
SESIONI II:	
Pavarësia dhe përgjegjshmëria e Magistratëve. Garancitë dhe Procedimi Disiplinor i Magistratëve	78
E drejta e shprehjes së magistratëve dhe kufizimi i saj sipas kërkesave të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Përgjegjësia disiplinore në këto raste.	79
SHTOJCA	
Praktikë gjyqësore e përzgjedhur mbi lirinë e shprehjes së gjyqtarëve	92
Përgjegjësia disiplinore e Magistratëve në lidhje me Pavarësinë e tyre	110
Hetimi dhe procedimi Disiplinor i magistratëve në përputhje me garancitë për një proces të rregullt ligjor sipas kërkesave të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)	118
Përgjegjësia disiplinore dhe kufijtë e kontrollit të punës së magistratëve	130
Shërbimi i inspektimit të drejtësisë, midis pavarësisë dhe përgjegjësive së magistratëve	144
SESIONI III:	
Roli i shërbimeve të inspektimit si garantues për mirëfunksionimin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Metodrat dhe sfidat e së ardhmes	156
Roli i shërbimeve të inspektimit, si një garant i mirëfunksionimit dhe pavarësisë së sistemit të drejtësisë në përputhje me legjislacionin dhe praktikën më të mira evropiane.	157
Kalimi nga organet inspektuese të bazuara në vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (inspektime ndaj magistratëve) në shërbimet përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë dhe performancës së gjykatave (inspektimet e bazuara në gjykata). Disa mësimet nga projektet në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë. Metodrat dhe sfidat e mundshme përpara për shërbimet e inspektimit gjyqësor.....	176
Në vend të mbylljes	183

LISTA E SHKURTIMEVE

AOC	Komisioni i përbashkët hetimor dhe këshillimor holandishtfolës
BAC	Komisioni i emërimeve dhe caktimeve holandishtfolës
BE	Bashkimi Evropian
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
CSM	Këshilli i Lartë i Magjistraturës
CGPJ	Këshilli i Përgjithshëm i Gjyqësorit
CSJ	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
CND	Komisioni i emërimeve dhe caktimeve frëngjishtfolës
CAER	Komisioni i përbashkët hetimor dhe këshillimor
CAE	Komisioni i përbashkët hetimor dhe këshillimor frëngjishtfolës
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë
CJEU	Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian
CCUAFA	Akti kundër korrupsionit dhe për konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme
CCCCIAP	Komisioni Kundër Korrupsionit dhe për Konfiskimin e Pasurive të Përfituara në mënyrë të Paligjshme
CIPA	Ligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar
CISIA	Drejtoria e Përgjithshme e Sistemeve Informatike dhe të Automatizuara
CE	Këshilli i Shtetit
CBA	Byroja Qendrore Kundër Korrupsionit
COPAIRS	Komiteti i Kolegëve të IGJ-së
DSJ	Drejtoria Shërbimeve Gjyqësore
DGSTAT	Drejtoria e Përgjithshme e Statistikave
ENCJ	Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GSP	Sistemet e Menaxhimit Procedural
HJC	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IGJ	Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë
ISJC	Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor
JHC	Këshilli i Lartë Gjyqësor
JSA	Akti i Sistemit Gjyqësor
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KiE	Këshilli i Evropës
LOPJ	Ligjit Organik për Pushtetin Gjyqësor
PDPA	Akti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
RESIJ	Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë
SJC	Këshilli Suprem Gjyqësor
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
UNEP	Zyra për Njoftimin, Ekzekutimet dhe Ankesat



**MESAZH I INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË**

I nderuar lexues!

Në datat 24 dhe 25 qershor 2022, në Tiranë u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Tiranës e Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, me temë “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”.



Kjo konferencë u realizua nga institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, si dhe u zbatua nëpërmjet Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ)[¹].

Ideja e zhvillimit të këtij aktiviteti lindi krejt natyrshëm, duke ndarë disa mendime me homologun tim rumun z. Lucian Netejoru, mbi disa çështje lidhur me administrimin e drejtësisë, pavarësinë e magjistratëve, si dhe rolin e shërbimeve të inspektimit në këtë proces. Të dy ndamë të njëjtin qëndrim: pavarësisht dallimit dhe diversitetit të kulturave tona politike, juridike, sociale apo ekonomike, historia në Evropë dhe jashtë saj po tregon se pavarësia e magjistratëve nuk duhet marrë si e mirëqenë, por mbetet një çështje, që i përket të gjitha vendeve. Ky është standard i një dimensionit të përbashkët i shoqërive tona. Ky është një standard ndërkombëtar.

1 Në vitin 2017, përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të 14 shteteve evropiane ranë dakord për krijimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ). Në të njëjtën kohë, në mbledhjen e RESIJ të datës 10 dhjetor 2021, u vendos që institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë (ILD) të jetë pjesë e këtij rrjeti evropian me status vëzhguesi.

Sot të gjitha vendet duhet të shtojnë përpjekjet për forcimin e kësaj pavarësie, por nga ana tjetër, edhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së organeve të sistemit të drejtësisë. Të dyja nuk mund të ecin, përveçse bashkë. Sa më i përgjegjshëm një magjistrat, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e veta. Sa më i pavarur magjistrati, aq më demokratikisht ecën shoqëria. Të dyja këto standarde, cilësia e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve janë prioritet i të gjitha vendeve.

Në këtë kuadër, gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë nga njëra anë dhe pavarësisë së magjistratëve nga ana tjetër, mbetet një sfidë permanente sepse pavarësia e magjistratëve dhe përgjegjshmëria e tyre janë vlera dinamike. Zhvillimet shoqërore sjellin padyshim edhe transformime shoqërore dhe ekonomike dhe raporti pavarësi/përgjegjshmëri mbetet përherë sfidë profesionale dhe institucionale.

Në këto kushte, duhet që të gjithë ne të gjejmë rrugën e duhur për të bashkëpunuar dhe për të identifikuar mundësitë dhe metodat më të mira të komunikimit dhe shkëmbimit të eksperiencave me njëri-tjetrin. Të gjithë ne duhet të analizojmë, të marrim modelet më të mira të njëri-tjetrit, si dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë në përputhje me vlerat tona të përbashkëta evropiane.

Me këtë mendim, në kuadër të aktiviteteve që RESIJ mund të kryente, vlerësuam se organizimi dhe mbajtja e kësaj konference me karakter ndërkombëtar në Shqipëri është një iniciativë me vlerë. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte të nxiste debatin mes pjesëmarrësve, lidhur me problemet apo sfidat, me të cilat përballen inspektoratet evropiane, që lidhen me administrimin e drejtësisë dhe pavarësinë e magjistratëve.

Në të njëjtën kohë, ideja e përgatitjes së këtij botimi, erdhi jo vetëm si nevojë për të pasur një përmbledhje të dokumentuar të temave

të rëndësishme, të cilat u diskutuan në konferencë, por edhe si një kontribut për një analizë të thelluar, që pasqyron kuadrin e përgjithshëm ekzistues të organizimit, funksionimit, si dhe të aspekteve të rëndësishme ligjore apo administrative, në lidhje me shërbimet e inspektimit në Evropë. Gjithashtu, besoj se, ky botim do të shërbejë si një nxitje dhe do të përbëjë në vetvete, një vlerë të shtuar për kryrjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore nga ana e shërbimeve të inspektimit në funksion të shtetit të së drejtës dhe qytetarëve.

Përveç kësaj, le të shërbejë ky botim modest, edhe si një mjet informimi për të gjithë magistratët, juristët, profesionistët e së drejtës apo studentët, lidhur me problematikat dhe sfidat, që hasen në ditët e sotme vendet evropiane, për sa i përket çështjeve që lidhen me administrimin e drejtësisë dhe pavarësinë e magistratëve.

Botimi është i organizuar në tre sesione, duke respektuar rendin kronologjik të prezantimeve, të ndjekur përgjatë konferencës, si dhe është botuar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në sesionin e parë janë trajtuar një sërë çështjesh të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me kompetencat, organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit të drejtësisë, parë kjo në një këndvështrim krahasues.

Gjatë sesionit të dytë, temat e prezantimeve kanë pasur për objekt trajtimin e çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e magistratëve, analizuar kjo në raport me garancitë, të cilat u afrohen atyre në kuadër të zhvillimit të procedimit disiplinor.

Ndërsa sesioni i tretë, jo më pak i rëndësishëm është fokusuar në trajtimin e çështjeve, lidhur me rolin e rëndësishëm të shërbimeve të inspektimit, si garantues për mirëfunksionimin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Nuk doja ta përfundoja këtë mesazh, pa shprehur disa mirënjohje dhe falënderime. Një falënderim i veçantë shkon për znj. Muriel Decot, z. Roland Gjoni, si dhe z. Olsi Dekovi, nga CEPEJ dhe KiE, për kontributin e vazhdueshëm që japin, duke rritur kapacitetet e vendeve anëtare mbi organizimin dhe funksionimin e sistemeve gjyqësore, duke elaboruar vazhdimisht instrumente dhe mekanizma ligjore ndërkombëtare, lidhur me efikasitetin, cilësinë apo vlerësimin e sistemeve të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, krahas mbështetjes teknike, pa mbështetjen financiare të Këshillit të Evropës, këto aktivitete nuk do të ishin bërë të mundura. Faleminderit për mbështetjen dhe profesionalizmin e treguar!

Në këtë rast, gjithashtu dua të shpreh falënderimin tim, me shumë mirënjohje, edhe për RESIJ, për znj. Delphine Agoguet, z. Lucian Netejoru dhe kolegët e tjerë. ILD është pjesëmarrësi më i ri në RESIJ, por gjatë kësaj kohe të shkurtër, kemi pasur një bashkëpunim intensiv dhe shumë të dobishëm me këtë Rrjet. Organizimi i kësaj konference, është një tregues i qartë, se Rrjeti funksionon, sjell rezultate konkrete dhe produkt në punën e tij. Për këtë arsye, ne duhet të tregojmë besim dhe duhet të kemi vullnetin e mirë ta çojmë përpara këtë iniciativë.

Një falënderim i veçantë shkon gjithashtu për të gjithë drejtuesit dhe përfaqësuesit e shërbimeve të inspektimit, përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë, të cilët ndanë me shumë profesionalizëm eksperiencat e vendeve të tyre, modelet e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të inspektimit, standardet apo metodat më të mira, të cilat të gjithë ne duhet të ndjekim.

Dhe në fund, një falënderim i veçantë për stafin e zyrës së ILD-së dhe bashkëpunëtorët e mi. Ju shpreh mirënjohje për impenjimin, angazhimin, si dhe mbështetjen, që më kanë dhënë për të ndërmarre dhe jetësuar këtë iniciativë.

I nderuar lexues!

Kur po konceptoja bashkë me kolegët e mi, ndërmarrjen e kësaj konference, kishim disa dilema të mëdha. Cila do të ishte tema e kësaj konference?! Cilat do të ishin çështjet e përbashkëta, që na bashkojnë të gjithëve ne?! Cilat janë dallimet?! Apo mbase diversiteti ynë politik, juridik apo social, krijon distancë dhe ndasi shumë të mëdha ndërmjet nesh, e cila nuk mund të afrohet, apo nuk mund të na sjellë të gjithëve bashkë, për të ndarë me njëri-tjetrin ide, problematika të njëjta, apo rrugët e duhura për zgjidhjen e tyre?

Por jo! Kjo konferencë tregoi të kundërtën! Tani mund të them me gjithë bindjen time, se ky organizim, ia vlejti dhe ka arritur qëllimin, për të cilin u konceptua. Kjo për faktin, se në themel të saj tij, qëndroi besimi ynë i përbashkët në vlerat evropiane, si demokracia dhe shteti i së drejtës, partneriteti, komunikimi i suksesshëm, si dhe vullneti i mirë për të kontribuar në zhvillimin e rolit të shërbimeve të inspektimit.

Tani që ky aktivitet ka përfunduar me sukses, besoj fort, se kjo traditë duhet të vazhdojë dhe le të jetë vetëm fillimi i një procesi të gjatë bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet nesh.

Ju uroj lexim të këndshëm!

Artur Metani

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë



SESIONI I:

**KOMPETENCAT, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI
I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË.
NJË KËNDVËSHTRIM KRAHASUES**

INSPEKTORATI GJYQËSOR I RUMANISË, FORMAT E NDRYSHME TË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE MARRËDHËNIA ME INSTITUCIONET E TJERA



Lucian Netejoru

Kryeinspektor i Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë

Z. Lucian Netejoru ka lindur në tetor të vitit 1966 në Giurgiu. Në vitin 1991 është martuar me znj. Mariana Florea dhe kanë një fëmijë, Serban Mihai. Z. Netejoru është diplomuar për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit Ekologjik në vitin 1994. Pas diplomimit në vitin 1996 fillimisht është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Giurgiu-t dhe më pas në vitin 2006 në Tribunalin e Giurgiu-t. Gjatë periudhës kohore 2002-2013, z. Netejoru ka mbajtur pozicionin nënkryetar dhe kryetar pranë këtyre gjykatave. Për periudhën kohore 2014-2015 ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë dhe nga viti 2015 dhe në vazhdim ushtron detyrën e Kryeinspektorit.

Abstrakti i prezantimit

Varësia konceptuale dhe praktike që ekziston midis pavarësisë së pushtetit gjyqësor, paanshmërisë së

gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe reputacionit të tyre profesional, janë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe intensive në literaturë. Për këtë arsye, këto koncepte janë tashmë të njohura gjerësisht. Këto vlera duhet të drejtojnë në mënyrë të përhershme punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe nga ana tjetër, të gjithë qytetarët kanë detyrim t'i respektojnë ato. Shkeljet e këtij detyrimi nuk mund të mohohen, ose me fjalë të tjera, nuk mund të mohohen përpjekjet për të dëmtuar këto vlera, të gjeneruara nga një sërë interesash herë të dukshme dhe herë jo.

Në Rumani, duke filluar me Kushtetutën e vitit 1991, janë gjetur një sërë zgjidhjesh me karakter legjislativ për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë, gjë që nuk është objekt i këtij prezantimi, pasi përgjatë këtij prezantimi do t'u referohemi ekskluzivisht normave ligjore të cilat janë aktualisht në fuqi.

Sipas Kushtetutës së Rumanisë, Këshilli i Lartë i Magjistraturës (CSM), është organi kryesor, i cili garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor në Rumani. Për të luajtur këtë rol, ligji ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e CSM-së në lidhje me mbrojtjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe procedurat e duhura në këtë drejtim, të cilave do t'u referohemi më poshtë.

I. REFERIMI DHE KOMPETENCA

I.A. Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë

1. Veprimi ex officio. Seksionet përkatëse të CSM-së (përkatësisht për gjyqtarët dhe prokurorët) kanë të drejtën dhe detyrimin përkatës që të veprojnë ex officio për të mbrojtur gjyqtarët dhe prokurorët kundër çdo akti ndërhyrjeje ose që do të krijonte dyshime për ndërhyrje në lidhje/të lidhur me veprimtarinë

profesionale, që mund të cenojë pavarësinë ose paanshmërinë e gjyqtarëve apo prokurorëve, në përputhje me ligjin nr. 304/2004 për organizimin gjyqësor, të ndryshuar, plotësuar dhe ribotuar më pas.

2. Veprimi i CSM-së mbi bazë kërkesë. Të drejtën për të paraqitur në CSM kërkesë për mbrojtjen e pavarësisë, paanshmërisë ose reputacionin profesional e kanë kryesisht gjyqtarët ose prokurorët, të cilët konsiderojnë se në çfarëdo mënyre mund t'u cenohet pavarësia, paanshmëria ose reputacioni i tyre profesional. Kjo e drejtë i takon edhe personave të tjerë në përputhje me kushtet procedurale të mëposhtme:
 - a) kërkesat për mbrojtjen e paanshmërisë mund të bëhen vetëm nga magjistratët e interesuar, në të kundërt kërkesat do të rrëzohen nga kryetari i CSM-së;
 - b) kërkesat për mbrojtjen e pavarësisë mund të bëhen edhe nga persona të ndryshëm nga magjistratët, por në këto raste kërkesat do të shqyrtohen fillimisht nga një komision i specializuar i CSM-së, i cili, sipas rastit, do të urdhërojë paraqitjen e kërkesës: (i) të Kryetari i CSM-së me qëllim dërgimin e saj në Inspektimin Gjyqësor për të kryer kontrolle ose për të vlerësuar pretendimin, nëse çështjet e ngritura në të kanë ose jo të bëjnë me veprimtarinë profesionale të magjistratit; ose (ii) të seksioni kompetent i CSM-së nëse nuk është e nevojshme të kryhen kontrolle nga Inspektimi Gjyqësor për zgjidhjen e saj.
 - c) kërkesat për mbrojtjen e pavarësisë së autoritetit gjyqësor në tërësi mund të bëhen si nga Plenumi (Mbledhja plenare) i CSM-së, ex officio, ashtu edhe nga çdo person tjetër. Zgjidhja e këtyre ankesave bëhet nga Plenumi i CSM-së.

I.B. Mbrojtja e reputacionit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Janë seksionet e CSM-së ato që mbrojnë reputacionin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve nëse konsiderojnë se reputacioni i tyre cenohet në çfarëdo mënyre. Ashtu si me kërkesat për mbrojtjen e paanshmërisë, kërkesat për mbrojtjen e reputacionit profesional mund të bëhen vetëm nga gjyqtarët/prokurorët e interesuar, ku dënimi është identik me atë që zbatohet për kërkesat për mbrojtjen e paanshmërisë (trajtimi).

II. PROCEDURA E ZGJIDHJES

II. A. Verifikimi paraprak i çështjeve të ngritura

Si hap i parë, për çështjet që përmban veprimi ex officio, kërkesa e magjistratëve të interesuar apo personave të tjerë, është Inspektimi Gjyqësor ai që, si rregull, kryen kontrollin e nevojshme. Në këtë drejtim, Mbledhja Plenare, Seksionet, Kryetari dhe Zëvendëskryetari i CSM-së do të njoftojnë Inspektimin Gjyqësor nëse plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative në lidhje me çështjet e ngritura, përkatësisht: (i) nevojën objektive për një kontroll paraprak; dhe (ii) natyra e çështjeve ka të bëjë qartë me veprimtarinë profesionale të gjyqtarit.

Nëse kushti i parë nuk plotësohet, seksionet e CSM-së do të trajtojnë drejtpërdrejt kërkesën dhe në rast se nuk plotësohet kushti i dytë atëherë kërkesat nuk do të pranohen. Në të dyja rastet, është Kryetari i CSM-së ai që urdhëron, sipas rastit, dërgimin e referimeve në seksionin kompetent ose trajtimin e saj. Në rastin e fundit kërkesa analizohet nga një komision i specializuar i CSM-së, siç u përmend më sipër. Inspektimi Gjyqësor verifikon çështjet e ngritura sipas një procedure të përbashkët për disa kategori referimesh dhe

rezultati regjistrohet në një raport që duhet t'i dorëzohet seksionit kompetent pasi i është komunikuar gjyqtarit/prokurorit përkatës, i cili ka marrë dijeni për materialin dhe nëse e ka konsideruar të nevojshme ka paraqitur pretendimet e tij. Në raport përfshihet edhe propozimi i Inspektimit Gjyqësor lidhur me zgjidhjen që do t'i japë CSM referimit, duke vendosur pranimin, apo rrëzimin e kërkesës.

II.B. Zgjidhja e kërkesave/referimeve nga CSM

Trajtimi i kërkesave/referimeve për mbrojtjen e pavarësisë, paanshmërisë apo reputacionit profesional të magjistratëve bëhet nga seksionet ose mbledhjet plenare të SCM-së, për sa u theksua dhe më sipër, bazuar në analizën e raportit të Inspektimit Gjyqësor, si dhe pas diskutimit të përmbajtjes së tij edhe nga magjistrati ndaj të cilit janë kryer verifikime.

Në rastet kur cenohet pavarësia, paanshmëria ose reputacioni profesional i gjyqtarit, seksioni/mbledhja plenare e CSM-së urdhëron marrjen e masave të nevojshme dhe siguron publikimin e tyre në faqen e internetit të Këshillit. CSM mund t'ia referojë çështjen organit kompetent për të vendosur mbi masat që duhen marrë ose të urdhërojë çdo masë tjetër të përshtatshme, sipas ligjit. Me kërkesë të gjyqtarit/prokurorit përkatës, deklarata do të vendoset në institucionin ku ai/ajo ushtron veprimtarinë dhe/ose do të publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni.

Trajtimi i kërkesës/referimit mund të shtyhet nëse çështjet e ngritura në të janë objekt i procedimit disiplinor ose i një çështjeje penale në të cilën është urdhëruar vazhdimi i hetimit penal. Në këto raste, shtyrja zgjat deri në përfundimin e çështjes disiplinore ose penale.

Aspektet teknike të përmendura më sipër janë padyshim të parëndësishme për ata që e shikojnë nga jashtë veprimtarinë e realizuar në këtë fushë si nga CSM, ashtu edhe nga Inspektimi Gjyqësor. Përmbledhja e punës së kryer nga Inspektimi Gjyqësor në vitin 2021 ka nxjerrë në pah nevojën e ndërhyrjes së CSM-së për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, si dhe shumëllojshmërinë e mënyrave në të cilat ai kërkon të ndikojë në pavarësinë, paanshmërinë dhe reputacionin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për të mbrojtur pavarësinë e autoritetit gjyqësor në tërësi, Inspektimi Gjyqësor ka kryer 9 kontrolle; Mbledhja plenare e CSM-së ka pranua 5 kërkesa për arsyet e mëposhtme: (i) deklarata nga ambientet publike se si të hetohet një çështje penale; (ii) si të transmetohet publikisht reagimi profesional i një grupi avokatësh ndaj një vendimi gjyqësor me të cilin është dënuar një person që i përket profesionit të avokatit; (iii) kërkesa e bërë nga disa gjyqtarë; (iv) të marra dhe të paraqitura në media deklaratat publike të një personi që nuk ka statusin e magjistratit.

Për të mbrojtur në nivel individual pavarësinë, paanshmërinë dhe reputacionin profesional, inspektorët e Drejtorisë së Inspektimit për Gjyqtarët kanë kryer 9 kontrolle paraprake dhe Seksioni për Gjyqtarët i CSM-së ka pranuar 7 kërkesa duke mbajtur në konsideratë: (i) deklaratat e bëra para një gjyqtari në lidhje me mënyrën në të cilën ai ka trajtuar dhe zgjidhur një çështje; (ii) deklaratat që përfshihen në artikujt e shtypit dhe postimet e bëra në rrjetin social Facebook; (iii) deklaratat e një gjyqtari; (iv) kërkesën për përjashtim të bërë nga një prokuror; (v) deklaratat e gjyqtarëve në lidhje me zhvillimin e një konkursi për emërim në poste të larta; (vi) artikujt e publikuar në internet; (vii) postimet në Facebook. Gjithashtu, në këtë fushë, inspektorët e Drejtorisë së Inspektimit për Prokurorët kanë kryer 17 kontrolle paraprake dhe Seksioni për Prokurorë i CSM-së ka pranuar 11 kërkesa për arsye

të ngjashme me ato të parashtruara.

Duke konsideruar publikimet online dhe mediat sociale si nxitësit kryesorë të shpërndarjes së informacioneve që mund të cenojnë pavarësinë, paanshmërinë ose reputacionin profesional, mund të konkludohet se këto kategori të reja burimi informacioni ndikojnë në veprimtarinë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë drejtim, CSM në konstatimet e saj të shprehura në vendimet e mësipërme ka arsyetuar se këto veprime shkojnë përtej të drejtës për t`u shprehur lirisht. Evolucionin, dinamikën e një realiteti të tillë duhet të ndiqet me kujdes të veçantë për të shmangur rritjen e fenomenit, i cili edhe pse në këtë kohë nuk ka përmasa kritike, mund të ketë efekte të pakontrollueshme në të ardhmen.

KRYERJA E INSPEKTIMEVE DHE PROCEDURAVE DISIPLINORE TË MAGJISTRATËVE PËR TË RRRITUR BESIMIN E PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË GREQI



Nikolaos Pipiligkas

*Nënkryetar i Gjykatës së Lartë për
Çështjet Civile dhe Penale “Areios Pagos”
Greqi.*

Z Nikolaos Pipiligkas ka lindur në Athinë në vitin 1957. Në vitin 1980 është diplomuar me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin Juridik të Universitetit Kombëtar të Athinës. z. Pipiligkas ka kryer shërbimin ushtarak për dy vjet. Në të njëjtën kohë, në vitin 1985 është diplomuar në Fakultetin Ekonomik të të njëjtit Universitet.

Në vitin 1983, pas provimit me shkrim dhe me gojë, është emëruar gjyqtar praktikant në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës dhe më pas në vitin 1985 është emëruar gjyqtar. Në vitin 1989 ka marrë leje njëvjeçare për studime pasuniversitare në Angli. Master në drejtësi (LLM) me temë “E Drejtë e Komunitetit Evropian” dhe “E Drejtë Krahasuese” në Universitetin “Queen Mary” dhe Universitetin “Westfield College” të Londrës. Gjatë periudhës kohore 1985-2003 z. Pipiligkas ka ushtruar detyrën si gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatave të Shkallës së Parë Athinë, Rodos, Kozani, Nafplion, si dhe gjatë periudhës

kohore 2003-2016 ka ushtruar detyrën si gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatave të Apelit Komotini, Athinë, Selanik dhe Pire.

Në vitin 2016 z. Nikolaos Pipiligkas është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale të Greqisë dhe në vitin 2021 zëvendëskryetar i kësaj gjykate. Z. Pipiligkas është emëruar gjithashtu me short për një vit si inspektor për gjyqtarët që shërbejnë në Gjykatat e Apelit të Athinës, Lamia dhe Evvoea dhe një vit më pas si zëvendëskryetar i Bordit Mbikëqyrës. Pas daljes në pension të Kryetarit të këtij Bordi më 30 qershor 2022, është emëruar Kryetar i Bordit Mbikëqyrës për vitin vijues. Është emëruar gjithashtu si pikë qendrore ndërmjet Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale të Greqisë dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Abstrakti i prezantimit

Kushtetuta greke parashikon që inspektimi dhe procesi disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve publik do të ushtrohet nga gjyqtarët e një rangu më të lartë dhe nga Këshillat Gjyqësor Disiplinor të përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë, të zgjedhur me short. Ministri i Drejtësisë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publikë, Zëvendëskryetarët si Kryetarë të Bordeve Mbikëqyrëse të Gjykatave të Larta përkatëse, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetarët ose Prokurorët Publikë të Gjykatave të Apelit kanë kompetencë për të vendosur një masë disiplinore ndaj një gjyqtari ose një prokurori publik që shërben nën juridiksionin e tyre.

Këshillat Gjyqësorë të përbëra ekskluzivisht nga gjyqtarë të zgjedhur me short, që shërbejnë në Gjykatën e Lartë ose në një nga Gjykatat e Apelit në qytetet më të mëdha (për magistratët ose gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë) kanë kompetencë për të shqyrtuar shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët ose prokurorët publikë dhe për të vendosur çdo lloj mase disiplinore, përveç masës disiplinore shkarkim nga detyra. Kjo masë disiplinore mund të vendoset vetëm për shkelje shumë të rënda disiplinore nga

Gjykata e Lartë në seancë publike plenare dhe në prezencë të të gjithë anëtarëve, pavarësisht rangut të magjistratit, i cili procedohet disiplinarisht.

Para të gjitha Këshillave Gjyqësore Disiplinore (dhe para seancës plenare të Gjykatës së Lartë), gjyqtari i akuzuar ose prokurori publik i akuzuar ka të drejtë të paraqesë të gjitha argumentet dhe provat, i shoqëruar nga një avokat. Ankesa e tij shqyrtohet nga Këshilli Gjyqësor i Shkallës së Dytë si në fakt, ashtu edhe në ligj. Vendimet e formës së prerë të Gjykatës së Lartë ku është masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” në seancë publike plenare dhe në prezencë të të gjithë anëtarëve mund të rishikohen nëse paraqiten prova të reja përpara gjykatës. Si konkluzion, legjislacioni përkatës dhe garancitë e parashikuara, rrisin besimin e publikut ndaj sistemit gjyqësor dhe në të njëjtën kohë, rrisin besimin ndaj institucioneve të inspektimit dhe disiplinës nga vetë gjyqtarët.

Hyrje

Gjyqtarët e zakonshëm duhet të gëzojnë pavarësi funksionale dhe personale. Në ushtrimin e funksioneve të tyre ata duhet t'i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Gjatë gjykimit të një çështjeje, gjyqtarët duhet të marrin vendime mbështetur në ligj dhe sipas bindjes së tyre të brendshme. Megjithatë, pavarësia funksionale dhe personale nuk do të thotë imunitet apo mungesë kontrolli. Ligji duhet të parashikojë sa më saktë që të jetë e mundur rregulla në lidhje me shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe për procedimet disiplinore ndaj tyre. Këto procedime duhet të kryhen nga institucione të ndara sa më shumë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i shtetit dhe në mënyrë transparente, të pavarur dhe të paanshme, në mënyrë që të rritet jo vetëm besimi i publikut ndaj sistemit gjyqësor, por edhe besimi ndaj inspektimit dhe institucioneve disiplinore nga vetë gjyqtarët.

Në këtë kuadër, Kushtetuta greke në paragrafin 3, të nenit 87

parashikon shprehimisht se inspektimi i gjyqtarëve të zakonshëm (gjyqtarëve në shkallën e parë dhe të dytë dhe jo i gjyqtarëve të lartë që shërbejnë në një nga Gjykatat e Larta të Greqisë) do të kryhet nga gjyqtarët e një rangu më të lartë, si dhe nga Prokurori dhe Zëvendësprokurori i Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale, ndërsa inspektimi i prokurorëve do të bëhet nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale dhe prokurorë të një rangu më të lartë, në përputhje me ligjin dhe paragrafin 3, të nenit 91, i cili parashikon shprehimisht se shqyrtimi i shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët e zakonshëm kryehet nga këshillat e përbërë nga gjyqtarë të rregullt të zgjedhur me short, si përcaktohet me ligj. Masat disiplinore mund të iniciohen edhe nga Ministri i Drejtësisë.

Duke qenë se nuk kam shumë kohë në dispozicion, do t'i referohem shkurtimisht autoriteteve kompetente për të kërkuar një masë disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori për një shkelje disiplinore të kryer prej tij dhe do të fokusohem në përbërjen dhe funksionin e këshillave disiplinorë, të cilat sipas Kushtetutës dhe ligjit kanë të drejtë të shqyrtojnë shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe të japin masa disiplinore.

1. Autoritetet kompetente për të kërkuar një masë disiplinore ndaj një gjyqtari

Më 6 qershor 2022, me ligjin 4938/2022 (Fletorja Zyrtare A 109) hyri në fuqi një Kod i Ri Organizativ për Gjykatat dhe Gjyqtarët. Dispozitat e tij në lidhje me organet kompetente disiplinore, përbërjen e tyre dhe mënyrën e funksionit të tyre janë pothuajse të ngjashme (me disa ndryshime) me Kodin Organizativ të mëparshëm për Gjykatat dhe Gjyqtarët, d.m.th. ligji 1756/1988, i ndryshuar me ligjin 4356/2015 dhe së fundmi me ligjin 4786/2021. Sipas paragrafit 1 të nenit 117 të Kodit të ri (paragrafi 1 i nenit 99 të atij të mëparshëm), organet kompetente për të kërkuar masë disiplinore ndaj gjyqtarit për shkelje disiplinore të kryer nga ana e tij janë:

- a) Ministri i Drejtësisë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publikë;
- b) Më i madhi nga zëvendëskryetarët e Këshillit të Shtetit (Conseil d' Etat), i cili është emëruar me short në Këshillin Mbikëqyrës, vetëm për ndihmës gjyqtarët dhe gjyqtarët prezantues (hartues), që shërbejnë në Këshillin e Shtetit;
- c) Zëvendëskryetari që është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të gjykatave administrative, vetëm për gjyqtarët që shërbejnë në gjykatat administrative;
- d) Zëvendëskryetari që është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të gjykatave civile dhe penale, vetëm për gjyqtarët dhe prokurorët publikë që shërbejnë në gjykatat civile dhe penale;
- e) Më i madhi nga zëvendëskryetarët e Gjykatës së Auditimit, i cili është emëruar me short në Këshillin Mbikëqyrës, vetëm për ndihmës gjyqtarët dhe gjyqtarët prezantues (hartues), të cilët shërbejnë në Gjykatën e Auditimit;
- f) Kryetari i Gjykatës Civile dhe Penale të Apelit ose Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për gjyqtarët e gjykatave të apelit repektiv, si dhe për kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave të shkallë së parë që funksionojnë pranë brenda juridiksionit territorial të këtyre gjykatave apeli;
- g) Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit pranë gjykatave të shkallës së parë për prokurorët publik të cilët ushtrojnë detyrën pranë këtyre gjykatave dhe funksionojnë pranë brenda juridiksionit territorial të tij.

Duhet përmendur se Kodi i mëparshëm Organizativ parashikonte që Prokurori i Përgjithshëm dhe, (para ndryshimit të fundit të tij me ligjin 4786/20210, kryetarët e Gjykatave të Larta përkatëse kishin gjithashtu kompetencë për të kërkuar një masë disiplinore ndaj gjyqtarëve që shërbenin në Gjykatat e Shkallës së Parë ose Gjykatat e Apelit.

2. Këshillat Disiplinorë: Përbërja dhe Funkzioni

a) Për gjyqtarët e lartë që shërbejnë në Gjykatat e Larta të Greqisë

Sipas paragrafit 1, të nenit 91 të Kushtetutës greke: “Procesi disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale, Zëvendësprokurorit të Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale, ose personave të tjerë të të njëjtit rang apo më lartë, do të kryhet nga Këshilli i Lartë Disiplinor, si përcaktohet në ligj”. Masa disiplinore inicohet nga Ministri i Drejtësisë (paragrafi 2). Këshilli i Lartë Disiplinor përbëhet nga Kryetari i Këshillit të Shtetit si Kryetar; si dhe anëtarë dy Zëvendëskryetarë ose Këshilltarë të Këshillit të Shtetit; dy zëvendëskryetarë ose gjyqtarë të Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale; dy Zëvendëskryetarë ose Këshilltarë të Gjykatës së Auditit dhe dy profesorë të drejtësisë nga Fakultetet Juridike të universiteteve të vendit.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me short midis atyre që kanë të paktën tre vjet eksperiencë në gjykatën e lartë përkatëse ose në fakultetet juridike. Anëtarët e Këshillit të Lartë Disiplinor nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje për gjyqtarët, prokurorin apo subjektet e tjera të cilët i përkasin të së njëjtës gjykatë. Në rastet që përfshijnë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Shtetit, Këshilli i Lartë Disiplinor do të drejtohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale (Paragrafi 4). Vendimet disiplinore të marra në përputhje me parashikimet e këtij neni nuk mund të ankimohen përpara Këshillit të Shtetit”

b) Për të gjithë gjyqtarët e tjerë

Për sa i përket gjyqtarëve që shërbejnë në gjykatat civile dhe penale:

- a) Paragrafi 7, i nenit 113, si dhe paragrafi 1, i nenit 115, të Kodit të Ri Organizativ, parashikon një Këshill Gjyqësor Disiplinor

i përbërë ekskluzivisht nga 7 (shtatë) gjyqtarë të zgjedhur me short që shërbejnë në Gjykatën e Lartë Civile dhe Penale. Ky Këshill është kompetent për të vendosur në shkallë të parë për shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët (duke përfshirë kryetarët) e gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit, si dhe për të vendosur çdo masë disiplinore të parashikuar në ligj (si vërejtje me shkrim, gjobë në masën e pagës nga dy deri në tre muaj, apo pezullim të përkohshëm nga 10 ditë deri në gjashtë muaj- paragrafi 1, i nenit 111 të Kodit të Ri Organizativ). Në të njëjtën kohë, Këshilli nuk ka kompetencë për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, si dhe të gjykojë në shkallë të dytë për ankimet e vendimeve disiplinore të marra nga Këshilli Disiplinor i përbërë nga 5 (anëtarë) të Gjykatës së Apelit (shikoni më poshtë).

- b) Paragrafi 8 i nenit 113, si dhe paragrafi 1 i nenit 115 të Kodit të Ri të Organizativ parashikon një Këshill Gjyqësor Disiplinor prej 9 (nëntë) anëtarësh, i përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë që shërbejnë në Gjykatën e Lartë Civile dhe Penale, të zgjedhur me short, me kompetencë për të gjykuar në shkallë të dytë për ankimet e vendimeve disiplinore të marra nga Këshilli Gjyqësor Disiplinor lartpërmendur i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë.
- c) Paragrafi 11, i nenit 113, si dhe paragrafi 1, i nenit 115 të Kodit të Ri të Organizativ parashikon një Këshill Gjyqësor Disiplinor të Gjykatës së Apelit me 5 (pesë) anëtarë me vendndodhje në Athinë, Pire, Selanik, Patras dhe Larisa, i përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë të zgjedhur me short dhe që shërbejnë në Gjykatën përkatëse të Apelit. Ky Këshill është kompetent për të vendosur në shkallë të parë për shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratët ose gjyqtarët dhe zëvendësprokurorët publikë të gjykatave të shkallës së parë, si dhe për të vendosur çdo masë disiplinore të parashikuar në ligj (si vërejtje me shkrim, gjobë në masën e pagës nga dy

deri në tre muaj, apo pezullim të përkohëshëm nga 10 ditë deri në gjashtë muaj-paragrafi 1, i nenit 111 të Kodit të Ri Organizativ). Në të njëjtën kohë, Këshilli nuk ka kompetencë për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për gjyqtarët që shërbejnë si ndihmës gjyqtarë ose gjyqtarë prezantues (hartues) në Këshillin e Shtetit, Gjykatën e Auditimit, ose për gjyqtarët që shërbejnë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë ose Gjykatat Administrative të Apelit, dispozitat e ligjit janë të ngjashme (paragrafët 5, 6, 9 dhe 11 të nenit 113 të Kodit të Ri Organizativ). Të gjitha këto dispozita janë saktësisht të njëjta me ato të parashikuara nga Kodi i mëparshëm Organizativ.

c) Funkzioni i Këshillave Disiplinorë

Të gjithë këto Këshilla Gjyqësorë Disiplinorë marrin vendime me dyer të mbyllura. Gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor ka të drejtë të paraqitet në seancën para Këshillit me mbrojtësin e tij dhe gjithashtu ka të drejtë t'i drejtojë pyetje dëshmitarëve ose nëse dëshiron të paraqesë prova me shkrim. Vendimet e Këshillave duhet të përmbajnë pjesën arsyetuese, si dhe mendimin kundër nëse ka. Për të garantuar pavarësinë funksionale të gjyqtarëve, Gjykata e Lartë Civile dhe Penale në seancë plenare me praninë e të gjithë anëtarëve në Opinionin e saj Këshillimor 34/1993 është shprehur se një gabim, parregullsi ose veprim në kundërshtim me ligjin mund të përbëjë shkelje disiplinore vetëm nëse është kryer nga ana e gjyqarit me dashje, neglizhencë apo pakujdesi të rëndë.

Si Këshilli Gjyqësor Disiplinor i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, i cili trajton ankimin kundër vendimeve disiplinore të marra nga Këshilli Gjyqësor Disiplinor i Gjykatës së Apelit i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, ashtu edhe Këshilli Gjyqësor Disiplinor i përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë, i cili trajton ankimin kundër vendimeve disiplinore të marra nga Këshilli Gjyqësor Disiplinor i përbërë nga

7 (shtatë) anëtarë kanë kompetencë për të shqyrtuar çështjen si në fakt ashtu edhe në ligj, për të gjitha shkaqet e ankimit, pavarësisht nëse ankimi është paraqitur në Këshillin Gjyqësor Disiplinor të shkallës së dytë nga gjyqtari i dënuar ose jo (në bazë të një arsytimi mospranimi), ose nga Ministri i Drejtësisë apo nga autoritetet e tjera të autorizuar nga ligji për të iniciuar një procedim disiplinor ndaj gjyqtarit, për sa është përmendur tashmë.

Duke qenë se këto Këshilla Gjyqësore Disiplinore në fakt përbëjnë “gjykata”, dhe përbëhen ekskluzivisht nga gjyqtarë të lartë (me përjashtim të Këshillit të Lartë Gjyqësor Disiplinor i cili përbëhet prej shtatë anëtarësh, ku shumica dërrmuese e anëtarëve të tij (pesë anëtarë) janë gjyqtarë), vendimet e tyre disiplinore nuk mund të kundërshtohen përpara gjykatave administrative ose gjykatave të tjera (shikoni gjithashtu paragrafin 4, të nenit 91 të Kushtetutës).

d) Vendosja e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”

Masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” mund të jepet për shkelje shumë të rënda disiplinore (paragrafi 2 i, nenit 111 të Kodit të Ri Organizativ) për të gjithë gjyqtarët që shërbejnë në Gjykatat Civile dhe Penale, vetëm nga Gjykata e Lartë Civile dhe Penale. Gjykata e Lartë Civile dhe Penale vendos në seancë publike plenare me praninë e të gjithë anëtarëve të saj, pavarësisht rangut të magjistratit, i cili procedohet disiplinarisht, me përjashtim të anëtarëve të saj.

Për ndihmës gjyqtarët ose gjyqtarët prezantues (hartues) që shërbejnë në Këshillin e Shtetit ose në Gjykatën e Auditimit apo për gjyqtarët që shërbejnë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë ose Gjykatat Administrative të Apelit, dispozitat e ligjit janë të ngjashme. Për këtë arsye, vetëm Këshilli i Shtetit ose Gjykata e Auditimit në seancë plenare publike me praninë e të gjithë anëtarëve kanë kompetencë për të vendosur masën disiplinore “Shkarkim

nga detyra” për të gjithë gjyqtarët që shërbejnë në këto gjykata, pavarësisht rangut të magjistratit, i cili procedohet disiplinarisht, me përjashtim të anëtarëve të tyre.

Për anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë publikë të Gjykatave të Larta (d.m.th. Gjykata e Lartë Civile dhe Penale, Këshilli i Shtetit, Gjykata e Auditimit), shkarkimi nga detyra si masë disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të jepet vetëm nga Këshilli i Shtetit në seancë plenare publike me praninë e të gjithë anëtarëve (gjyqtarë dhe prokurorë) të Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale ose për anëtarët e Gjykatës së Auditimit.

Për anëtarët e Këshillit të Shtetit, shkarkimi nga detyra si masë disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të vendoset vetëm nga Gjykata e Lartë Civile dhe Penale në seancë publike plenare me praninë e të gjithë anëtarëve (paragrafi 2, i nenit 113 të Kodit të Ri Organizativ, si dhe paragrafi 4, i nenit 88 të Kushtetutës).

Meqenëse të gjitha vendimet (përfshirë vendimet disiplinore) të marra nga Gjykata e Lartë në seancë publike plenare me praninë e të gjithë anëtarëve nuk mund të ankimohen, paragrafi 5 i nenit 123, i Kodit të Ri Organizativ parashikon mundësinë e rishikimit të vendimit disiplinor të kontestuar, nëse gjenden prova të reja. Afati i rishikimit është një vit pas zbulimit të provave të reja. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë Civile dhe Penale jep një interpretim të gjerë të asaj dispozite dhe pranon edhe provat ekzistuese në kohën e vendimit të saj fillestar, nëse ato prova nuk janë paraqitur para Gjykatës në seancën dëgjimore, kur është marrë vendimi i saj fillestar.

3. Disa informacione të tjera rreth shkeljeve disiplinore

Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët (85-90%) kanë të bëjnë me vonesa të pajustificuara në marrjen e vendimit pas gjykimit të çështjes. Disa shkelje të tjera disiplinore kanë të bëjnë me sjellje jo dinjitoze ose të pahijshme të gjyqtarit zakonisht gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndonjëherë edhe jashtë ushtrimit të saj.

4. Konkluzione

Edhe pse ekziston një lidhje midis pushtetit ekzekutiv të shtetit dhe procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, pasi Ministri i Drejtësisë është gjithashtu kompetent për të kërkuar një masë disiplinore ndaj të gjithë gjyqtarëve ose për të apeluar për rishqyrtimin e një vendimi të marrë nga Këshilli Disiplinor i Shkallës së Parë, unë supozoj se Kushtetuta e Greqisë dhe si Kodi i Ri, ashtu edhe Kodi i Vjetër Organizativ për Gjykatat dhe Gjyqtarët parashikojnë garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit në lidhje me procedimet disiplinore. Këto garanci janë:

- a) përbërja e Këshillave Disiplinorë vetëm nga gjyqtarë të zgjedhur me short (me përjashtim të Këshillit të Lartë Gjyqësor Disiplinor i cili përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarësh, ku shumica dërrmuese e anëtarëve të tij (pesë anëtarë) janë gjyqtarë);
- b) mungesa e mundësisë, sipas ligjit, për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të gjyqtarit të zgjedhur me short si anëtar i Këshillit Disiplinor;
- c) kufizimi i mandatit të gjyqtarit të emëruar si anëtar i Këshillit Disiplinor për një periudhë njëvjeçare dhe ndalimi për t'u riemëruar si anëtar i Këshillit Disiplinor për një periudhë kohore të caktuar pas përfundimit të mandatit të tij;
- d) e drejta e magjistratit për t'u paraqitur në seancën përpara

Këshillit Disiplinor, i shoqëruar me një avokat të zgjedhur prej tij, për të paraqitur pretendime, si dhe për t'u njohur me provat;

- e) kompetenca e Këshillit Disiplinor, kur shqyrton ankimin, për të shqyrtuar çështjen në fakt dhe ligj në lidhje me të gjitha shkaqet e paraqitura në ankim ndaj vendimit të kundërshtuar;
- f) masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për të gjithë gjyqtarët, pavarësisht rangut të magjistratit, i cili procedohet disiplinarisht, mund të merret vetëm nga Gjykata e Lartë kompetente në seancë publike plenare dhe në prezencë të të gjithë anëtarëve, si dhe ky vendim mund të rishikohet në disa raste.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, kufizimi i vendimeve të gabuara si shkelje disiplinore vetëm në disa raste ekstreme. Unë besoj se të gjitha këto garanci rrisin besimin e publikut ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi, pasi gjyqtari nuk ka arsye të ketë frikë apo shqetësim për gjykimin e tij dhe më pas nuk ndikohet lehtë nga ata që janë të interesuar. Në të njëjtën kohë, ato rritin besimin ndaj institucioneve të inspektimit dhe disiplinës nga vetë gjyqtarët.

KOMPETENCAT, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSPEKTORATEVE BULLGARE PËRGJEGJËSE PËR KONTROLLIN E MAGJISTRATËVE.



Maria Neykova,

*Inspektore, Inspektorati i Këshillit të
Lartë Gjyqësor, Bullgari*

Znj. Maria Neykova është diplomuar për drejtësi në vitin 1980 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Sofies “St. Kliment Ohridski” duke marrë titullin “Jurist”.

Gjatë periudhës kohore 1984-1995 znj. Neykova ka ushtruar detyrën e Këshilltares Ligjore dhe Kryekëshilltare Ligjore në Ministrinë e Mbrojtjes, CDIA dhe organizata të tjera. Për periudhën kohore 1995-2006 ka punuar si Hetuese në Shërbimin e Investigimit të Sofies, në Krye të Departamentit të Shërbimit Kombëtar të Investigimit.

Znj. Maria Neykova ka një përvojë të gjatë si prokurore duke ushtruar një sërë detyrash si: 2006 prokurore në Prokurorinë e Rrethit të Sofies dhe prokurore në Prokurorinë e Apelit. 2006-2011 prokurore në Prokurorinë e Qytetit të Sofies, prokurore në Prokurorinë e Lartë dhe Prokurorinë Administrative të Lartë. 2011-2014 prokurore në Prokurorinë e Posaçme të Apelit, prokurore në SCP dhe SAP.

2014-2016 Nënkyetare Administrative, Zëvendësprokurore e Apelit në Prokurorinë e Posaçme të Apelit. Në të nëjtën kohë, Znj. Maria Neykovanë vitin 1994 ka kryer një specializim pasuniversitar në fushën e Integritetit Europian, si dhe po në këtë vit ka fituar titullin “Specialist i patentave”.

Ka përfunduar kursin e kualifikimit në urbanizimin e krimit në Aix-en-Provence, Francë, si dhe kursin e kualifikimit në mbrojtjen e interesave financiarë të Bashkimit Europian dhe në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta.

Znj. Maria Neykova është zgjedhur inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Asambleja Kombëtare më 18 shkurt 2016, si dhe ka marrë detyrën e “Inspektorit në ISJC” më 14 mars 2016.

Abstrakti i prezantimit

Kompetencat kryesore të Inspektoratit i referohen veprimtarisë së përgjithshme organizative dhe të administratës së drejtësisë, zbatimit të ligjit, të gjykatave, prokurorive dhe departamenteve të hetimit. Në mënyrë të detajuar, kjo nënkupton inspektime të organizimit të veprimtarisë administrative në gjykata, prokurori dhe departamente hetimore; organizimin e regjistrimit dhe trajtimit të çështjeve dhe dosjeve; respektimin e afateve ligjore; raportimin në organet kompetente - me konstatimin e praktikave të ndryshme me njëra tjetrën; çdo kërkesë për vendime ose akte interpretuese; hartimin e sugjerimeve për vendosjen e sanksioneve disiplinore ose shpërblimin e magjistratëve; dërgimin e raporteve dhe sugjerimeve tek autoritetet e tjera qeveritare; veprimtarinë analitike; inspektimin e kërkesave për shkelje të së drejtës së gjykimit dhe gjykimin e çështjeve brenda afateve të arsyeshme; inspektimet për integritetin dhe konfliktet e interesave të magjistratëve, duke identifikuar veprimet e tyre që cenojnë imazhin e gjyqësorit; si dhe inspektimet

në lidhje me shkeljet e pavarësisë së magistratëve; inspektimet e deklaratave të tyre të pasurisë dhe për shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga gjykatat, prokuroritë dhe departamentet e hetimit.

Inspektorati pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (ISJC) është e organizuar në përputhje me ligjin. Inspektorati është person juridik i pavarur dhe funksionet e tij i ka përcaktuar në mënyrë të detajuar me Rregulloren për organizimin e punës së tij. Është krijuar për të garantuar besimin e shoqërisë në drejtësi dhe transparencë në funksionimin e sistemit gjyqësor.

ISJC-ja u krijua me ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Bullgarisë në vitin 2007. Deri atëherë, kontrolli jogjyqësor mbi autoritetet gjyqësore kryhej nga inspektorët gjyqësorë në Ministrinë e Drejtësisë. Fillimisht, aktivitetet e tyre janë rregulluar në vitin 1910 nga ligji për Strukturën e Gjykatave. Që atëherë “gjyqtarët inspektorë” kanë qenë të detyruar të identifikojnë pengesat për zbatimin e duhur dhe uniform të ligjeve dhe të propozojnë masat e duhura për përmirësim. Për këtë qëllim, vendi ynë ka traditë më shumë se 100-vjeçare në inspektimin e gjyqësorit, i karakterizuar nga një nivel i mirë vazhdimësie. Inspektorati tashmë ekzistues pranë SJC-së vazhdon këtë traditë. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Bullgarisë dhe Aktin Gjyqësor (JA), gjyqtarët, prokurorët dhe magistratët hetues në vend vendosin për çështjet në mënyrë të pavarur dhe e bëjnë atë në përputhje me ligjin dhe bindjen e tyre të brendshme. Kjo i nënshtrohet vetëm kontrollit brenda sistemit gjyqësor. Kontrolli i këtij procesi është i pamundur, por veprimtaria administrative, organizimi i regjistrimit dhe trajtimit të çështjeve dhe respektimi i periudhave kohore përkatëse përfshihen në juridiksionin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo do të thotë se Inspektorati është një nga organet e krijuara në mënyrë të duhur, i cili kërkohet të kontrollojë gjyqësorin e pavarur dhe të

ketë funksione parandaluese në lidhje me dukuritë negative.

Sipas dispozitave të nenit 54 të JA-së, objekti i inspektimeve të ISJC-së është veprimtaria e përgjithshme organizative dhe e administratës së drejtësisë, zbatimit të ligjit, të gjykatave, prokurorive dhe departamenteve të hetimit. Në mënyrë të detajuar, kjo nënkupton inspektime të organizimit të veprimtarisë administrative në gjykata, prokurori dhe departamente hetimore; organizimin e regjistrimit dhe trajtimit të çështjeve dhe dosjeve; respektimin e afateve ligjore; raportimin në organet kompetente - me konstatimin e praktikave të ndryshme me njëra tjetrën; çdo kërkesë për vendime ose akte interpretuese; hartimin e sugjerimeve për vendosjen e sanksioneve disiplinore ose shpërblimin e magjistratëve; dërgimin e raporteve dhe sugjerimeve tek autoritetet e tjera qeveritare; veprimtarinë analitike; inspektimin e kërkesave për shkelje të së drejtës së gjykimit dhe gjykimin e çështjeve brenda afateve të arsyeshme; inspektimet për integritetin dhe konfliktet e interesave të magjistratëve, duke identifikuar veprimet e tyre që cenojnë imazhin e gjyqësorit; si dhe inspektimet në lidhje me shkeljet e pavarësisë së magjistratëve; inspektimet e deklaratave të tyre të pasurisë dhe për shkelje të ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga gjykatat, prokuroritë dhe departamentet e hetimit.

Kompetencat e tij kryesore janë: sigurimi i disiplinës në autoritetet gjyqësore, prokurorisë dhe hetimeve nëpërmjet organizimit të inspektimeve të veprimtarive të tyre administrative; inspektimeve të regjistrimit dhe trajtimit të çështjeve gjyqësore; inspektimeve lidhur me gjykimin e çështjeve brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj; raportimi tek organet kompetente pas konstatimit të praktikës gjyqësore të ndryshme; si dhe dërgimi i raporteve dhe sugjerimeve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe drejtuesit administrativë të autoriteteve gjyqësore për vendosjen e sanksioneve disiplinore ose shpërblimeve.

Kjo do të thotë se Inspektorati ka funksion kontrollues dhe konstataues, funksion referues me gjetjen e arsyeve për të zbatuar përgjegjësinë disiplinore, funksion raportues, duke përfshirë sugjerimet dhe raportimet tek autoritetet e tjera qeveritare, si dhe funksionin sanksionues - dhënien e vendimeve të dënimit.

Kuadri ligjor nuk e parashikon Inspektoratin si pjesë të sistemit gjyqësor, pasi ai nuk është as organ i administrimit të drejtësisë dhe as organ tërësisht administrativ. Gjithashtu, parimi kryesor që ne respektojmë në punën tonë është moscenimi i pavarësisë së gjyqtarëve, prokurorëve dhe magistratëve hetues. Ky është “sanctum sanctorum” për shoqërinë demokratike dhe shqetësimi më i madh për inspektoratin. Kjo është arsyeja pse, gjatë gjithë inspektimeve të tij, ISJC-ja merr parasysh kuadrin ligjor dhe parimet e përgjithshme të ligjit.

ISJC-ja është e organizuar në përputhje me ligjin. Inspektorati është person juridik i pavarur dhe funksionet e tij i ka përcaktuar në mënyrë të detajuar me Rregulloren për organizimin e punës së tij.

Kryeinspektori është i ngarkuar me drejtimin e përgjithshëm organizativ dhe metodologjik të punës së Inspektoratit, e përfaqëson atë, jep udhëzime për buxhetin, kontrollon inspektorët, lidh dhe ndërpret kontratat e punës me ekspertët dhe punonjësit e administratës. Kryeinspektori emërohet nga Asambleja Kombëtare me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit. E njëjta procedurë zbatohet edhe për emërimin e inspektorëve. Në punën e tyre ata mbështeten nga ekspertë me arsim juridik dhe ekonomik, të cilët emërohen mbi baza konkurimi. Puna e Inspektoratit mbështetet nga administrata. Punonjësit në administratën e Inspektoratit janë zyrtarë gjyqësorë. Ata janë të organizuar në administratë të përgjithshme dhe të specializuar. Numri i personelit të administratës nuk duhet të kalojë pesëfishin e numrit të inspektorëve që janë 11, duke përfshirë edhe kryeinspektorin. Zyrtarët gjyqësorë që janë vartës të drejtpërdrejtë të kryeinspektorit janë kontrolluesi financiar dhe

oficeri për sigurinë e informacionit. Në përgjithësi, administrata e Inspektoratit drejtohet nga një sekretar i përgjithshëm. Sekretari i përgjithshëm është gjithashtu në varësi të drejtpërdrejtë të kryeinspektorit dhe i raporton atij. Gjatë marrjes së këtij posti, sekretari i përgjithshëm nuk mund të jetë anëtar i partisë politike apo koalicionit, organizatës me qëllime politike dhe nuk duhet të ushtrojë veprimtari politike. Kontrolluesi financiar është një tjetër figurë në administratë. Ata kryesisht zbatojnë dhe respektojnë ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Sektorin Publik. Përfaqësuesi tjetër i administratës është zyrtari për sigurinë e informacionit. Ata janë përgjegjës për sigurinë e informacionit në Inspektorat duke garantuar respektimin e kërkesave të ligjit për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (CIPA) dhe rregullores në zbatim të tij, mirëmbajtjen e regjistrit të informacionit të klasifikuar, organizimin e duhur për krijimin, marrjen, përpunimin, ruajtjen dhe dërgimin e informacionit të klasifikuar.

Administrata e përgjithshme e Inspektoratit përbëhet nga:

DREJTORIA Administrative	DREJTORIA Juridike, Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore	DREJTORIA për Buxhet dhe Financa	DREJTORIA e Sigurisë Kompjuterike dhe Informacionit
-----------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------	-----------------------------------------------------------------

Administrata e specializuar përbëhet nga ekspertë që mbështesin kryeinspektorin dhe inspektorët në ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit për sa u tha më sipër. Ekspertët janë caktuar për:

1. Njësinë e inspektimit sipas nenit 54, paragrafi 1, pikat 1 dhe 2 të AJ-së, të cilët marrin pjesë në inspektimet në lidhje me organizimin e veprimtarisë administrative të gjykatave, prokurorive dhe organeve të hetimit;

2. Njësinë e inspektimit sipas kreut nëntë, seksioni Ia i AJ-së që marrin pjesë në inspektimet e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve, prokurorëve dhe magjistratëve hetues;
3. Njësinë e inspektimit sipas kreut nëntë, seksioni I6 i JA-së që marrin pjesë në inspektime për integritetin dhe konfliktin e interesit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe magjistratëve hetues, inspektime për identifikimin e veprimeve në cenim të imazhit të gjyqësorit dhe inspektime në lidhje me hetimin e shkeljeve të pavarësisë së magjistratëve;
4. Njësinë e inspektimit sipas Kreut III “a” të JA-së, të cilët marrin pjesë në inspektimin e kërkesave të personave fizikë dhe juridikë kundër veprave, veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve gjyqësore që cenojnë të drejtën e tyre për të dëgjuar dhe për të marrë vendime për çështjet brenda afatit të arsyeshëm;
5. Njësinë analitike që përpunon dhe analizon informacionin nga inspektimet e kryera në autoritetet e gjyqësorit nga të gjitha ekipet e Inspektoratit.

Për sa i përket punës së Inspektoratit, drejtuesit administrativë të autoriteteve të gjyqësorit janë të detyruar me ligj të ndihmojnë kryeinspektorin dhe inspektorët në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe të sigurojnë akses në materialet e nevojshme për këtë qëllim. Gjithashtu, ata janë të detyruar të japin informacion për veprimet që kanë ndërmarrë në lidhje me çdo raport apo sugjerim të dërguar nga Inspektorati.


Si konkluzion, duhet të saktësojmë se Inspektorati është krijuar me idenë për të garantuar besimin e shoqërisë në drejtësi dhe transparencë në funksionimin e sistemit gjyqësor. Për këtë qëllim, publikimi i raporteve vjetore që përshkruajnë rezultatet e arritura nga Inspektorati është një praktikë e mirë. Kjo është një shenjë pozitive për qeverinë dhe qytetarët për të siguruar publicitet dhe transparencë për cilësinë e drejtësisë.

Ky është prezantimi im i shkurtër për kompetencat, organizimin dhe funksionet e ISJC-së të Republikës së Bullgarisë, e ngarkuar me kontrollin e punës së magjistratëve.

Së fundi, dëshiroj të them disa fjalë për temën e konferencës.

Pavarësia është vlera themelore e gjyqësorit, një kusht paraprak për shtetin e së drejtës dhe një garanci për gjykim të drejtë. Ai u mundëson gjyqtarëve që janë përgjegjës për marrjen e vendimeve thelbësore për jetën, liritë, të drejtat, detyrimet dhe pronën e qytetarëve, të vendosin në mënyrë të paanshme dhe të drejtë, si dhe i mbron ata nga ndikimi i drejtpërdrejtë i palëve në mosmarrëveshje dhe nga ndërhyrja e paligjshme e autoriteteve qeveritare, organizatat e jashtme dhe personat fizikë. Pavarësia nuk është prerogativë e gjyqësorit dhe privilegj i gjyqtarit, por kryesisht ekziston në interes të atyre që kërkojnë apo presin drejtësi, pasi shqyrtimi ligjor dhe objektiv i çështjeve penale, civile dhe administrative është vendimtar për një shoqëri paqësore, të begatë dhe demokratike. Pavarësia duhet merituar, fituar dhe mbrojtur. Gjyqësori arrin legjitimitet dhe fiton respektin e qytetarëve me performancën e tij të paqortueshme duke siguruar vendime të drejta dhe të justifikuar, nëpërmjet raportimit, transparencës dhe hapjes ndaj kritikave të arsyeshme. Mbrojtja më e mirë e pavarësisë është ushtrimi sa më mirë i kompetencave të dhëna. Kjo do të çonte në mënyrë të pashmangshme mungesën e mbështetjes publike për sulmet e përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, mediave dhe qytetarëve kundër gjyqtarëve, si dhe do të krijonte besim më të lartë te drejtësia dhe reputacion më të lartë të gjyqësorit. Me punën e saj, ISJC-ja vendos barrierën e parë reale ndaj akteve të paligjshme të organeve të drejtësisë. Për këtë qëllim, ai ka edhe funksion parandalues në drejtim të nxjerrjes së akteve objektive, ligjore dhe të drejta të organeve gjyqësore dhe të prokurorisë. Duke mbrojtur reputacionin dhe pavarësinë e magjistratëve, Inspektorati nuk toleron asnjë akt joetik. Kjo është arsyeja pse, dëshiroj të përsërisë tematikën e kësaj konference dhe t'ju falënderoj paraprakisht për përmirësimin e kapaciteteve të inspektorateve!

**PRAKTIKA E INSPEKTORATIT BULLGAR
LIDHUR ME DEKLARIMIN DHE
KONTROLLIN E INTERESAVE PASURORE
TË MAGJISTRATËVE SI GARANCI E
PAVARËSISË DHE INTEGRITETIT TË TYRE
PËR TË RRRITUR BESIMIN E PUBLIKUT NË
SISTEMIN GJYQËSOR.**



Lyubomir Krumov

*Inspektor, Inspektorati i Këshillit të Lartë
Gjiyqësor, Bullgari*

Z. Lyubomir Krumov është diplomuar në vitin 1994 në Fakultetin e Drejtësisë, duke fituar titullin “Jurist” në Universitetin e Ekonomisë Kombëtare dhe Botërore të Sofies “St. Kliment Ohridski”, si dhe në vitin 2015 ka kryer studimet pasuniversitare “Master në Ekonomik”.

Gjatë periudhës kohore 1995-1996 z. Krumov ka ushtruar detyrën gjyqtarit kandidat pranë Gjykatës së Rrethit të Sofies, si dhe gjatë periudhës 1995-1999, Asistent Hetues dhe Hetues në Shërbimin e Investigimit në Sofie.

Në të njëjtën kohë, z. Krumov është gjyqtar me përvojë dhe ka ushtruar një sërë detyrash si: 1999-2000 Gjyqtar i ri (Ndihmës Ligjor) në Gjykatën e Rrethit të Sofies. 2000-2003 Gjyqtar në Gjykatën Rajonale-Slivnitsa. 1996-2003 Asistent me kohë të pjesshme në të drejtën penale në Fakultetin e

Drejtësisë të Sofies “St. Kliment Ohridski”. 2003-2006 Kryetar i Gjykatës Rajonale-Slivnitsa. 2006-2016. Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit të Sofies-Dhoma Penale. Z. Lyubomir Krumov është zgjedhur inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Asambleja Kombëtare më 18 shkurt 2016, si dhe ka marrë detyrën e “Inspektorit në ISJC” më 14 mars 2016.

Abstrakti i prezantimit

Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor (ISJC) është një organ kontrolli, pjesë e sistemit gjyqësor, i krijuar me amendamentin e katërt të Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë (prom. SG 12/2007). Inspektorati përbëhet nga një Kryeinspektor i Përgjithshëm dhe 10 (dhjetë) Inspektorë, të cilët zgjidhen nga Asambleja Kombëtare me një shumicë prej 2/3 (dy të tretave) të deputetëve të Asamblesë Kombëtare. Mandati i kryeinspektorit është 5 (pesë) vjet dhe i inspektorëve 4 (katër) vjet. Në kryerjen e detyrave të tyre, Kryeinspektori dhe Inspektorët janë të pavarur dhe udhëhiqen vetëm nga ligji. Kompetencat kryesore të ISJC-së parashikohen në Kushtetutë dhe zhvillohen më tej në Aktin e Sistemit Gjyqësor (JSA)-për të kryer kontrole mbi aktivitetet e autoriteteve brenda sistemit gjyqësor duke respektuar pavarësinë e gjyqtarëve, jurive, prokurorëve dhe hetuesve në rrjedhën e kryerjes së funksioneve të tyre.

Me aktin për deklarimin publik të aseteve të personave që mbajnë poste të larta qeveritare (prom. SG 38/05/2000; më pas titulli u ndryshua në: Akt mbi deklarimin publik të aseteve të personave që mbajnë poste të larta qeveritare dhe pozicione të tjera (Titulli u ndryshua – SG 30 dhe 71/2013) parashikohet detyrimi për të deklaruar pronën nga personat e listuar në mënyrë shteruese në ligj, duke përfshirë edhe disa magistratë të lartë. Deklarimi i të ardhurave dhe pasurisë nga personat e detyruar do të bëhet me emërimin e tyre dhe çdo vit maksimumi deri më 31 maj për vitin kalendarik të mëparshëm, si dhe pas largimit së tyre nga detyra

me deklarata në një formë standarde të miratuar nga Ministri i Financave.

Shtesa në JSA (SG 62/2016, në fuqi që nga data 01.01.2017) parashikon detyrimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve për të deklaruar pasurinë e tyre pranë ISJC-së. Duke i besuar ISJC-së funksione të reja në lidhje me miratimin dhe kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe interesave të magjistratëve bullgarë, ndryshimin e modelit të mëparshëm legjislativ për deklarimin dhe kontrollin para autoriteteve jashtë sistemit gjyqësor, statusin e ISJC-së si një autoritet gjyqësor i pavarur, i respektuar dhe efikas me kompetenca kontrolli të përcaktuara qartë në lidhje me veprimtarinë, pronën dhe integritetin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve.

Sipas shtesës në JSA (SG 62/2016, në fuqi që nga data 01.01.2017), gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit janë të detyruar të paraqesin në ISJC një deklaratë me dy pjesë mbi pasurinë dhe interesat brenda afateve të mëposhtme:

-
- ▶ çdo vit deri më 15 maj për vitin kalendarik paraardhës;
 - ▶ brenda një muaji nga marrja e detyrës;
 - ▶ brenda një muaji nga shkarkimi;
 - ▶ brenda një muaji nga kalimi i një viti nga largimi nga puna.

Magjistratët duhet të deklarojnë gjithashtu çdo ndryshim në interesat e deklaruara tashmë në ISJC brenda një muaji nga ndryshimi.

Në deklaratën e pasurisë dhe të interesave, magjistratët tregojnë të dhënat e parashikuara në JSA për pasurinë dhe interesat e tyre, pasurinë e bashkëshortëve ose personave me të cilët ata janë në bashkëjetesë faktike në bazë të martesës, si dhe të fëmijëve të mitur. Në një shtojcë të Aktit të Sistemit Gjyqësor (SG 7/2018), është zgjeruar objekti i të dhënave të deklaruara nga magjistratët,

ku nga 23 janari 2018 është subjekt deklarimi burimi i fondeve në rast të shlyerjes së parakohshme të detyrimeve dhe kredive. Brenda një muaji nga kalimi i afateve kohore për dorëzimin e deklaratave, ISJC-ja duhet të publikojë në faqen e saj të internetit deklaratat e dorëzuara, si dhe listën e personave që nuk i kanë dorëzuar ato brenda afatit të caktuar.

Shpesh gjatë kontrolleve të deklaratave të pasurisë së magistratëve, ISJC-ja përballlet me pamundësinë për të vërtetuar disa fakte dhe të dhëna të rëndësishme për shkak të mungesës së rregullimit ligjor - për shembull, ISJC-ja nuk mund të kërkojë ofrimin e të dhënave për pasuritë e paluajtshme, instrumentet financiare ose llogaritë bankare jashtë vendit, instrumentet financiare që tregtohen nëpërmjet një shoqërie komisionere ose për investime në ar. Për të njëjtën arsye, pagesat e bëra nëpërmjet kompanive të regjistruara sipas ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave (të cilat nuk janë institucione bankare) dhe disponueshmëria në llogari në këto kompani nuk mund të verifikohet. Një vështirësi tjetër në kryerjen e kontrolleve është mungesa e informacionit të besueshëm për vlerën e pasurisë së deklaruar (pasuri e paluajtshme dhe mjete motorike) në regjistrat përkatës në të cilët ISJC-ja ka akses dhe fakti që nuk ekziston një mekanizëm ligjor me të cilin ISJC-ja mund ta konstatojë. Mungesa e këtyre kompetencave e bën të vështirë vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të rëndësishme për kontrollin.

Në konkluzion, mund të përmbliidhet se ISJC-ja ka dëshmuar se është një organ i pavarur mbikëqyrës brenda sistemit gjyqësor, duke luajtur një rol aktiv në parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe ndikimit të jashtëm të panevojshëm mbi gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit. Efikasiteti i kompetencave të ushtruara nga ISJC-ja në këtë drejtim mund të rritet si duke bërë ndryshimet e nevojshme legjislative, ashtu edhe duke zgjeruar bashkëpunimin ndërmjet Inspektoratit dhe organeve dhe institucioneve të tjera që kryejnë kontrolle për konfliktin e interesit dhe për zbulimin e pasurive të personave që mbajnë poste të larta publike.

1. Krijimi dhe kompetencat e Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor (ISJC) është një organ kontrolli, pjesë e sistemit gjyqësor, i krijuar me amendamentin e katërt të Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë (prom. SG 12/2007). Inspektorati përbëhet nga një Kryeinspektori i Përgjithshëm dhe dhjetë Inspektorë, të cilët zgjidhen nga Asambleja Kombëtare me një shumicë prej 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të Asamblesë Kombëtare. Mandati i kryeinspektorit është pesë vjet dhe i inspektorëve katër vjet. Në kryerjen e detyrave të tyre, Kryeinspektori dhe Inspektorët janë të pavarur dhe udhëhiqen vetëm nga ligji. Kompetencat kryesore të ISJC-së parashikohen në Kushtetutë dhe zhvillohen më tej në Aktin e Sistemit Gjyqësor (JSA) - për të kryer kontrole mbi aktivitetet e autoriteteve brenda sistemit gjyqësor duke respektuar pavarësinë e gjyqtarëve, jurive, prokurorëve dhe hetuesve në rrjedhën e kryerjes së funksioneve të tyre.

Duke u krijuar si një nga organet e parashikuara për të mbështetur zbatimin e reformës në drejtësi, kompetencat e ISJC-së kanë evoluar ndjeshëm gjatë viteve. Në vitin 2012, me një shtesë në JSA, Inspektoratit iu caktuan detyrime shtesë-të kryejë kontrole në deklaratat që pretendojnë shkelje të së drejtës për të dëgjuar dhe zgjidhur çështjet brenda një afati të arsyeshëm. Me amendamentin e pestë të Kushtetutës së dhjetorit 2015 (SG 100/2015), funksionet e Inspektoratit u zgjeruan ndjeshëm – ai u autorizua të kryejë kontrole integriteti dhe konflikti interesi për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit, deklaratat e tyre të pasurisë, të identifikojë veprimet që cenojnë prestigjin e sistemit gjyqësor dhe ato që lidhen me shkeljet e pavarësisë së gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve. Kompetencat e reja u zhvilluan më tej në Kapitullin e Nëntë, Seksioni Ia dhe Ib i JSA-së (SG 62/2016) dhe janë në fuqi nga data 1 janar 2017. Objektivi kryesor i kompetencave të ISJC-së ishte rritja e efikasitetit

të autoritetit dhe vendosja e mekanizmave realë për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ndikimit të jashtëm të panevojshëm mbi autoritetet e sistemit gjyqësor. Lidhja e analizimit të fakteve dhe të dhënave të paraqitura në deklaratat e pasurisë me kontrollet e konfliktit të interesit krijon një mundësi reale të zbulimit të ndikimit të padrejtë në veprimtarinë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, si dhe shkelje të pavarësisë së tyre funksionale. Kjo forcon edhe efektin parandalues të detyrimit për paraqitjen e deklaratave të ekzistencës së interesave private dhe deklarimit publik të pasurisë. Dispozitat e reja të Kushtetutës, të zhvilluara më tej në JSA në lidhje me kontrollet e kryera nga ISJC, krijojnë mundësi në aspektin institucional dhe organizativ për funksionimin në kushtet e llogaridhënies, transparencës dhe parandalimit të ndikimit në sistemin gjyqësor. Efekti publik i miratimit të tyre synon rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe krijimin e besimit tek qytetarët se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk është i izoluar nga llogaridhënia dhe mekanizmat e kontrollit publik. Ndryshimi i fundit legjislativ, që parashikon një kompetencë të re të Inspektoratit, është në zbatim të një ndryshimi të Aktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (PDPA), SG Nr. 17 i vitit 2019, i cili mandatoi Inspektoratin të mbikëqyrë dhe të sigurojë përputhjen me Rregulloren (BE) 2016/679, PDPA dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale kur përpunimi i të dhënave personale bëhet nga gjykata, prokuroria dhe organet hetimore në kryerjen e funksioneve të tyre si autoritete të sistemit gjyqësor.

2. Një pasqyrë e shkurtër kronologjike e detyrimit për të deklaruar gjendjen pasurore nga personat që mbajnë poste të larta civile

Me anë të aktit (ligjit) për deklarimin publik të pasurive të personave që mbajnë poste të larta qeveritare (prom. SG 38/05/2000; më pas titulli u ndryshua në: Akt mbi deklarimin publik të pasurive të personave që mbajnë poste të larta qeveritare dhe pozicione të

tjera (Titulli u amendua – SG 30 dhe 71/2013) është parashtruar detyrimi për të deklaruar pronën nga personat e listuar në mënyrë shteruese në ligj, duke përfshirë edhe disa magjistratë të lartë. Deklarimi i të ardhurave dhe pasurisë nga personat e detyruar do të bëhet me emërimin e tyre dhe çdo vit maksimumi deri më 31 maj për vitin kalendarik të mëparshëm, si dhe pas lëshimit të deklaratave në formë standarde të miratuar nga Ministri i Financave. Nën drejtimin e Kryesisë së Gjykatës së Audituesve është krijuar një Regjistër Publik për deklarimin e pasurisë, të ardhurave dhe shpenzimeve nga personat që mbajnë poste të larta qeveritare në Republikën e Bullgarisë. Aksesit publik në të dhënat nga Regjistri Publik u garantohet autoriteteve të autorizuar në bazë të akteve të tjera për të marrë informacion, drejtuesve të administratave, ku përfshihen personat që e kanë të detyrueshme sipas ligjit, si dhe media nëpërmjet organeve të tyre drejtuese. Kërkesat për të dhëna nga Regjistri Publik i drejtohen me shkrim Kryetarit të Gjykatës së Audituesve, i cili është i detyruar të japë informacionin përkatës maksimumi brenda një muaji nga marrja e kërkesës. Çdo vit ndërmjet 1 tetorit dhe 1 nëntorit, Kryetari i Gjykatës së Audituesve presupozohet të bëjë të ditur emrat e zyrtarëve që, sipas këtij ligji, duhet të paraqesin një deklaratë, por që nuk e kanë bërë këtë, me anë të një buletini që do të publikohet në masmedia. Çdo person i detyruar ka të drejtën e aksesit të menjëhershëm në regjistër në lidhje me deklaratat e tij personale.

Shtesa në JSA (SG 62/2016, në fuqi që nga data 01.01.2017) parashikon detyrimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve për të deklaruar pasurinë e tyre pranë ISJC-së. Duke i besuar ISJC-së funksione të reja në lidhje me miratimin dhe kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe interesave të magjistratëve bullgarë, ndryshimin e modelit të mëparshëm legjislativ për deklarimin dhe kontrollin para autoriteteve jashtë sistemit gjyqësor, statusin e ISJC-së si një autoritet gjyqësor i pavarur, i respektuar dhe efikas me kompetenca kontrolli të përcaktuara qartë në lidhje

me veprimtarinë, pronën dhe integritetin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve.

Në vitin 2018, hapa të mëtejshëm vendimtarë u ndërmorën duke hartuar dhe miratuar legjislacionin e ri të konsoliduar për të luftuar korrupsionin midis zyrtarëve të lartë publikë. Paralelisht, me një reformë në ligjin procedural, u ndryshua juridiksioni i krimeve të korrupsionit të niveleve të larta dhe ato u proceduan në gjykatat e specializuara penale. Gjithashtu u forcua kapaciteti i kontrollit të brendshëm administrativ në strukturat e institucioneve qeveritare.

Akti kundër korrupsionit dhe për konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme (CCUAAFA – prom. SG 7/2018) krijoi një organ të ri të vetëm të pavarur kundër korrupsionit – Komisioni Kundër Korrupsionit dhe për Konfiskimin e Pasurive të Përfituara në mënyrë të Paligjshme (CCCCIAP) si një organ i përhershëm qeveritar i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikës kundër korrupsionit dhe për konfiskimin e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme. Fokusi i CCUAAFA është një reformë e kuadrit institucional në fushën e parandalimit dhe kundër korrupsionit me synim një efikasitet më të madh dhe një koordinim më të mirë midis autoriteteve ekzistuese dhe njësive të administratës publike. Komisioni kundër Korrupsionit dhe për Konfiskimin e Pasurive të Përfituara në mënyrë të Paligjshme ka tërhequr kompetencat e një sërë organesh si Komisionin për Parandalimin dhe Krijimin e Konfliktit të Interesit, Qendrën për Parandalimin dhe Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar pranë Këshillit të Ministrave, njësinë përkatëse të Gjykatës së Audituesve lidhur me veprimtarinë e ligjit të shfuqizuar për deklarimin e pasurisë së personave që ushtrojnë poste të larta qeveritare dhe të tjera, si dhe drejtorinë përkatëse të specializuar në Agjencinë Shtetërore të Sigurisë Kombëtare (SANS) për të luftuar korrupsionin midis personave që mbajnë poste të larta qeveritare. Kështu synohet vendosja e lidhjes së nevojshme ndërmjet funksioneve të parandalimit të

korrupsionit, kontrollit të deklaratave të pasurisë, konstatimit të konfliktit të interesit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, ku aktivitetet antikorrupsion intensifikohen duke mbledhur, analizuar dhe kontrolluar informacionin në lidhje dhe me rastin e informacioneve për korrupsion të personave që mbajnë poste të larta publike. Ky bashkim funksionesh është i rëndësishëm, pasi konfliktet e interesit dhe korrupsioni janë shpesh çelësi i pasurisë së pashpjegueshme të personave përkatës. Kjo mundëson ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të rezultateve të arritura deri më tani dhe praktikave të mira të vendosura në fushën e konfiskimit civil. Komisioni është organ kolegjal i përbërë nga pesë anëtarë, një kryetar, një zëvendëskryetar dhe tre anëtarë të tjerë. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga Asambleja Kombëtare me propozimin e deputetëve të Asamblesë Kombëtare. Zëvendëskryetari dhe anëtarët e tjerë të Komisionit zgjidhen nga Asambleja Kombëtare me propozimin e Kryetarit të Komisionit. Mandati i Komisionit është gjashtëvjeçar dhe fillon nga data e emërimit të anëtarëve të tij. Pavarësia e Komisionit sigurohet nëpërmjet parimeve dhe procedurave të propozuara për strukturimin e tij, duke garantuar njëkohësisht transparencë, llogaridhënie dhe publicitet në aktivitetet e tij. Kontrolli parlamentar dhe mekanizmat statutorë për ndërveprimin me institucionet e autoriteteve të tjera ofrojnë garanci ligjore për pavarësinë e organit të sapokrijuar.

Kompetencat dhe funksionet e CCCCIAP mund të përmbliidhen në fushat e mëposhtme:

- Operacionale - lidhur me pranimin dhe kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe interesave; me kontrollet e informacioneve të marra nga sinjalizuesit dhe nëpërmjet mediave; me kryerjen e kontroleve të gjendjes pasurore; procedimet për konstatimin e konfliktit të interesit; procedurat për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme; antikorrupsionin duke zbuluar akte të personave që mbajnë poste të larta publike.

- ▶ Analitike-lidhur me përgatitjen e analizave dhe metodologjive dhe zhvillimin e masave kundër korrupsionit. Parashikohet shprehimisht që analizat dhe propozimet për masat kundër korrupsionit të hartuara nga Komisioni të vihen në dispozicion të organeve kompetente, të cilat janë të detyruara të vendosin për to dhe të informojnë Komisionin për masat e marra.

Duhet theksuar shprehimisht se, sipas një dispozite të shprehur në CCUAAFA, depozitimi dhe kontrolli i deklaratave të pasurisë nga gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit kryhet në përpjthje me dispozitat e JSA-së.

3. Kontrolli i deklaratave të pasurisë së magjistratëve nga ekipet e ISJC-së

Sipas shtesës në JSA (SG 62/2016, në fuqi që nga data 01.01.2017), gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit janë të detyruar të paraqesin në ISJC një deklaratë me dy pjesë mbi pasurinë dhe interesat brenda afateve të mëposhtme:

- ▶ çdo vit deri më 15 maj për vitin kalendarik paraardhës;
- ▶ brenda një muaji nga marrja e detyrës;
- ▶ brenda një muaji nga shkarkimi;
- ▶ brenda një muaji nga skadimi i një viti nga largimi nga puna.

Magjistratët duhet të deklarojnë gjithashtu çdo ndryshim në interesat e deklaruara tashmë në ISJC brenda një muaji nga ndryshimi.

Në deklaratën e pasurisë dhe të interesave, magjistratët tregojnë të dhënat e parashikuara në JSA për pasurinë dhe interesat e tyre, pasurinë e bashkëshortëve ose personave me të cilët ata janë në bashkëjetesë faktike në bazë të martesës, si dhe të fëmijëve të

mitur. Në një shtojcë të Aktit të Sistemit Gjyqësor (SG 7/2018), është zgjeruar objekti i të dhënave të deklaruara nga magistratët, ku nga 23 janari 2018 është subjekt deklarimi burimi i fondeve në rast të shlyerjes së parakohshme të detyrimeve dhe kredive. Brenda një muaji nga kalimi i afateve kohore për dorëzimin e deklaratave, ISJC-ja duhet të publikojë në faqen e saj të internetit deklaratat e dorëzuara, si dhe listën e personave që nuk i kanë dorëzuar ato brenda afatit të caktuar.

Shpesh gjatë kontrolleve të deklaratave të pasurisë së magistratëve, ISJC-ja përballet me pamundësinë për të vërtetuar disa fakte dhe të dhëna të rëndësishme për shkak të mungesës së rregullimit ligjor

- për shembull, ISJC-ja nuk mund të kërkojë ofrimin e të dhënave për pasuritë e paluajtshme, instrumentet financiare ose llogaritë bankare jashtë vendit, instrumentet financiare që tregtohen nëpërmjet një shoqërie komisionere ose për investime në ar. Për të njëjtën arsye, pagesat e bëra nëpërmjet kompanive të regjistruara sipas ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave (të cilat nuk janë institucione bankare) dhe disponueshmëria në llogari në këto kompani nuk mund të verifikohen. Një vështirësi tjetër në kryerjen e kontrolleve është mungesa e informacionit të besueshëm për vlerën e pasurisë së dekluar (pasuri e paluajtshme dhe mjete motorike) në regjistrat përkatës në të cilët ISJC-ja ka akses dhe fakti që nuk ekziston një mekanizëm ligjor me të cilin ISJC-ja mund ta konstatojë. Mungesa e këtyre kompetencave e bën të vështirë vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të rëndësishme për kontrollin.

Brenda 6 muajsh (fillimisht 3 muaj) pas kalimit të afatit për dorëzimin e deklaratës përkatëse, ISJC-ja do të kryejë një kontroll për sa i përket besueshmërisë së të dhënave të deklaruara, që konsiston në krahasimin e tyre me informacionin e mbledhur nga ISJC-ja nga regjistrat publikë përkatës, në të cilët të dhënat i nënshtrohen regjistrimit, deklarimit ose verifikimit. Ligji i jep

ISJC-së kompetenca për të aksesuar burimet e informacionit në lidhje me të dhënat që i nënshtrohen deklaramit. Disa marrëveshje bashkëpunimi janë lidhur nga/dhe ndërmjet ISJC-së dhe autoriteteve dhe institucioneve të tjera publike, duke përfshirë ato, për të cilat të dhënat e deklaruara i nënshtrohen regjistrimit, deklaramit ose verifikimit (me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Punëve Publike, Ministrinë e Brendshme, Agjencinë Kombëtare të të Ardhurave, Agjencinë Ekzekutive “Administrata Detare”). Gjithashtu janë lidhur marrëveshje për shkëmbimin e informacioneve me të gjitha (dhjetë) shoqëritë e sigurimeve për pensione në Republikën e Bullgarisë, të cilat janë krijuar dhe menaxhohen sipas fondeve të Kodit të Sigurimeve Shoqërore për sigurime suplementare për pensionin.

Kontrolli përfundon me një Raport përrputhshmërie kur nuk është vërtetuar mospërrputhje midis fakteve të deklaruara dhe informacionit të marrë ose diferenca e gjetur arrin deri në BGN 10 000. (deri më 10.02.2020 - BGN 5000 me qëllim ndryshimin e JSA-së-SG 11/2020, në fuqi nga data 11.02.2020), dhe në raste të tjera - me një raport mospërrputhjeje. Në rast konstatimi mospërrputhshmërie prej jo më pak se BGN 20 000, e cila nuk korrigjohet brenda 14 ditësh nga njoftimi i personit, ISJC-ja i dërgon raportin autoriteteve kompetente për një kontroll të mëtejshëm të gjendjes pasurore të personave përkatës-Agjencisë Kombëtare të të Ardhurave dhe Komisionit kundër Korrupsionit dhe për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Në rastet e mospërrputhjes në shumën nga BGN 10 000 (deri më 10.02.2020-BGN 5000) në BGN 20 000, si dhe kur ka të dhëna për konflikt interesi, ISJC-ja do të kryejë një kontroll të mëtejshëm, i cili mund të përfundojë me një Raport Përrputhshmërie ose një Raport Mospërrputhshmërie, nëse ka një ndryshim midis të dhënave të deklaruara dhe informacioneve të marra, vlera e pasurisë së të cilit kalon BGN 10 000. (deri më 10 shkurt 2020-BGN 5000). Kur harton një Raport Mospërrputhshmërie, njoftohet edhe Agjencia Kombëtare e të Ardhurave për të ndërmarrë veprimet e duhura.

Përvoja praktike e Inspektoratit në fushën e kontrollit të deklaratave të pasurisë dhe interesave ka treguar se nevojiten disa ndryshime legjislative. Në vitin 2018, me iniciativë të ISJC-së, kuadri i JSA-së për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe interesave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve u ndryshua në këto fusha:

- ▶ afati kohor për kryerjen e kontroleve zgjatet nga tre në gjashtë muaj (neni 175e, paragrafi 1);
- ▶ parashikohet mundësia që magjistratët të bien dakord për dhënien e informacionit që përbën sekretet bankare, kur nuk ka nevojë për një vendim gjykate për zbulimin e tij (neni 175e, paragrafi 6);

dispozita e dënimit administrativ të nenit 408a të JSA-së, për aplikimin e tij edhe për personat që kanë humbur cilësinë e gjyqtarit, prokurorit apo hetuesit, por janë të detyruar të paraqesin deklaratën e pasurisë dhe të interesave brenda afateve sipas nenit 175c, paragrafi 1, pika 3 dhe pika 4 e JSA-së.

Që nga fundi i nëntorit 2018 dhe gjatë gjithë vitit 2019, inspektorët dhe ekspertët e ISJC-së kanë marrë pjesë në një grup pune ndërsektorial nën drejtimin e zv.ministrit të Drejtësisë, i cili ka nxjerrë një projekt-amendament dhe shtojcë të JSA-së. Nga ana e Inspektoratit u propozuan dispozita për korrigjimin e papërsosmërive ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe interesave nga gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit dhe procedurën për kryerjen e kontrollit në deklaratat e dorëzuara. Në këtë drejtim, duhet theksuar se me Aktin për Ndryshimin dhe Plotësimin e JSA-së (prom. SG 11 i datës 07.02.2020, në fuqi nga data 11.02.2020) dispozitat e Kreut 9, Seksioni Ia i JSA-së janë ndryshuar dhe plotësuar në lidhje me të dhënat që do të deklarohen, kohën në të cilën do të deklarohet pasuria, afatin kohor për paraqitjen e deklaratës sipas nenit 175c, paragrafi 1, pika 4 e JSA-së, kushtet paraprake për paraqitjen e deklaratës së origjinës së fondeve sipas nenit 175a, paragrafi 1, pika 2 e JSA-së, etj.

Në lidhje me optimizimin e aktiviteteve të ISJC-së sipas Kreut 9 (nëntë), Seksioni Ia i JSA-së në kuadër të Programit Operativ të Qeverisjes së Mirë 2014-2020 (GGOP), sipas të cilit Inspektorati është përfitues, parashikohet zhvillimi i softuerit të specializuar që do të lejojë dorëzimin plotësisht elektronik të deklaratave të pasurisë dhe të interesave të magjistratëve; do të ofrojë mundësinë e verifikimit të të dhënave të deklaruara nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave nga sistemet elektronike të autoriteteve qendrore dhe vendore dhe administratave të tyre, si dhe autoriteteve të tjera përpara të cilave të dhënat e deklaruara janë objekt regjistrimi, deklarimi ose verifikimi. Synimi është, aty ku është e mundur, të minimizohet regjistrimi i të dhënave nga një operator dhe rrjedhimisht të maksimizohet verifikimi automatik i deklaratave të pasurisë duke siguruar marrjen dhe krahasimin e informacionit në mënyrë elektronike.

Në vitin 2021 janë dorëzuar 4,393 deklaratat pasurie ku përfshihen: 4,125 deklaratat vjetore për vitin 2020, 114 deklaratat fillestare (brenda një muaji nga marrja e detyrës), 54 deklaratat përfundimtare (brenda një muaji nga largimi nga puna) dhe 100 deklaratat përfundimtare (brenda një muaji nga skadimi i një viti pas largimit nga puna). Gjithashtu 343 deklaratat për një ndryshim në të dhënat e deklaruara në deklaratat sipas nenit 175a, paragrafi 1, pika 1 e JSA-së në lidhje me interesat dhe origjinën e fondeve në rastin e shlyerjes së parakohshme të detyrimeve dhe kredive. Janë kontrolluar 4391 deklaratat pasurore dhe në fakt është kontrolluar pasuria e 9935 personave-magjistratëve, bashkëshortëve të tyre, personave me të cilët de facto janë në bashkëjetesë në bazë të martesës dhe dhe e fëmijëve të mitur. Janë konstatuar 393 mospërputhje, të cilat janë korrigjuar me paraqitjen e një deklarate korrigjuese brenda afatit ligjor 14 ditor. Aktualisht, kontrollet për 2 deklaratat pasurie nuk kanë përfunduar, pasi nuk janë marrë të gjitha informacionet nga autoritetet dhe institucionet para të cilave faktet e deklaruara janë objekt regjistrimi, deklarimi ose verifikimi dhe afati 6-mujor për kryerjen e kontrolleve nuk ka kaluar ende.

JSA parashikon përgjegjësi administrative për personat që nuk kanë dorëzuar brenda afatit ligjor një deklaratë pasurie dhe interesash ose një deklaratë ndryshimi në të dhënat e deklaruara në lidhje me interesat dhe origjinën e fondeve në rast të shlyerjes së parakohshme të borxheve dhe kredive (Neni 408a i JSA-së), si dhe në rast konstatimi të mospërputhjes që tejkalon BGN 10.000 pas verifikimit të mëtejshëm (Neni 408b i JSA-së). Në vitin 2021, lidhur me shkeljet ekzistuese të detyrimit për paraqitjen e deklaratës së pasurisë dhe interesave brenda afatit ligjor, u hapën 43 procedime administrative, të cilat përfunduan me lëshimin e:

- ▶ 15 vendime dënimi për një shumë totale gjobash të vendosura prej BGN 4700;
- ▶ 27 vërejtje në të cilat organi ndëshkues, duke marrë parasysh praktikën e krijuar dhe jo të diskutueshme të Gjykatës Administrative të qytetit të Sofjes, ka pranuar se çështja është e lehtë, pasi akti nxjerr në pah shkallë më të ulët të rrezikut publik sesa shkeljet e zakonshme të të njëjtit lloj, duke pasur parasysh vonesën e vogël në dorëzimin e deklaratës përkatëse (një deri në nëntë ditë kalendarike) ose në prani të rrethanave lehtësuese të shumta ose të jashtëzakonshme duke paralajmëruar shkelësin se, në rast të shkeljeve të përsëritura të të njëjtit lloj, do të gjobiten;
- ▶ 1 vendim për pushimin e procedimit administrativ.

Nga 15 vendime dënimi të lëshuar: 9 kanë hyrë në fuqi (me shumën totale të gjobave të vendosura BGN 2800, të cilat janë paguar plotësisht), njëri nuk i është dorëzuar shkelësit dhe 5 janë ankimuar në gjykatë, si dhe ende nuk kanë përfunduar procedurat ligjore.

4. Vështirësitë në procesin e kontrollit të deklaratave të pasurisë dhe sfidat me të cilat përballet ISJC-ja

Shpesh gjatë kontrolleve të deklaratave të pasurisë së magjistratëve,

ISJC-ja përballet me pamundësinë për të vërtetuar disa fakte dhe të dhëna të rëndësishme për shkak të mungesës së rregullimit ligjor - për shembull, ISJC-ja nuk mund të kërkojë ofrimin e të dhënave për pasuritë e paluajtshme, instrumentet financiare ose llogaritë bankare jashtë vendit, instrumentet financiare që tregtohen nëpërmjet një shoqërie komisionere ose për investime në ar. Për të njëjtën arsye, pagesat e bëra nëpërmjet kompanive të regjistruara sipas ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave (të cilat nuk janë institucione bankare) dhe disponueshmëria në llogari në këto kompani nuk mund të verifikohen. Një vështirësi tjetër në kryerjen e kontroleve është mungesa e informacionit të besueshëm për vlerën e pasurisë së deklaruar (pasuri e paluajtshme dhe mjete motorike) në regjistrat përkatës në të cilët ISJC-ja ka akses dhe fakti që nuk ekziston një mekanizëm ligjor me të cilin ISJC-ja mund ta përcaktojë. Mungesa e këtyre kompetencave e bën të vështirë vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të rëndësishme për kontrollin.

Një sfidë serioze për ekipet e kontrollit të ISJC-së është edhe fakti se disa fakte dhe të dhëna që do të deklarohen nuk mund të vërtetohen për shkak të mungesës së regjistrave të vetëm në të cilët ato janë subjekt regjistrimi, deklarimi ose verifikimi. Këto janë, për shembull: konflikti i interesit, bashkëjetesa faktike mbi bazën e martesës, pagesat e arkëtueshme, policat e sigurimit, përdorimi i përhershëm i pasurisë së dikujt tjetër, kostoja e trajnimit ose e udhëtimit kur nuk paguhet me paratë e tyre.

Këtu duhet përmendur edhe mungesa e rregullimit legjislativ në lidhje me monedhat virtuale (të ashtuquajturat “kriptomonedha”). As vendi dhe as Bashkimi Evropian nuk kanë rregullore apo një politikë të përbashkët për aktivitetet që lidhen me monedhat virtuale, dhe deri më tani çdo Shtet Anëtar ka futur rregullat e veta ose zbaton ligjet e tij ekzistuese për analogji. Gjithashtu, nuk ekziston një përkufizim ligjor i termit “monedhë virtuale”.

Megjithatë, në praktikë supozohet se tregtimi në monedha virtuale lejohet me ligj, pasi nuk ka rregulla që e ndalojnë në mënyrë të shprehur këtë lloj veprimtarie. Në opinionin e tij mbi monedhat virtuale të datës 04.07.2014 (EBA/Op/2014/08), Autoriteti Bankar Evropian i përkufizon monedhat virtuale si një paraqitje dixhitale të një vlere që nuk është emetuar nga një bankë qendrore apo autoritet publik dhe as nuk i bashkëngjitet monedhës zyrtare, por përdoret nga persona fizikë ose juridikë si mjet pagese dhe mund të transferohet, ruhet ose tregtohet në mënyrë elektronike. Në Bullgari, mundësinë për të paraqitur qëndrimin e tyre në lidhje me transaksionet në valuta virtuale e kanë pasur Gjykata e Apelit - Sofje, Banka Kombëtare Bullgare, Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Kombëtare e të Ardhurave. Me rastin e pyetjeve të drejtuara nga magjistratët në lidhje me deklarimin e monedhave virtuale që i nënshtrohen përcaktimeve të Kreut 9, seksioni Ia i JSA-së në mbledhjen e mbajtur më 15.04.2020, ISJC-ja mori vendimin që vijon: “Monedhat virtuale nuk bëjnë pjesë në asnjë prej rasteve të përmendura në nenin 175b, paragrafi 1 i JSA-së, i cili liston në mënyrë shteruese llojet e pasurisë dhe interesat që duhet të deklarohen sipas Kreut 9, Seksioni Ia i JSA-së. Pavarësisht mungesës së një detyrimi ligjor për të deklaruar monedhat virtuale, personat që e kanë të detyrueshme sipas JSA-së mund t’i deklarojnë ato në tabelën nr. 7 “Paratë e gatshme në dispozicion”, në Seksionin III të deklaratës standarde të miratuar nga Krye-inspektori i ISJC-së sipas nenit 175a, paragrafi 1, pika 1 e Ligjit për Sistemin Gjyqësor- “Paratë e gatshme, duke përfshirë depozitat, llogaritë bankare dhe të arkëtueshme me vlerë totale që kalon BGN 10,000, duke përfshirë valutën” për të vërtetuar origjinën e fondeve në rast të realizimit të ardhshëm të fitimit nga shitja e tyre”. Pyetjet e parashtruara dhe përgjigjet e tyre publikohen në faqen zyrtare të ISJC-së nën titullin “Pyetje dhe përgjigje për deklaratat e pasurisë” të Seksionit “Kontrollet e deklaratave të pasurisë”.

Në vitin 2022, një vështirësi e konsiderueshme në kryerjen e disa kontrolleve të deklaratave u shkaktua nga fakti se gjykata të ndryshme rajonale refuzuan kërkesat e inspektorëve të ISJC-së për të zbuluar informacione që përbënin sekret bankar në kuptimin e ligjit për institucionet e kreditimit, me arsyetimin se kërkesat erdhën nga një organ i paligjshëm për shkak të një mandati të skaduar (mandati 4-vjeçar i inspektorëve i përcaktuar me Kushtetutë skadoi në mars të vitit 2020). Gjithashtu, një sërë vendimesh të Gjykatës së Shkallës së Parë (Gjykatës Rajonale të Sofjes), të cilat aktualisht janë apeluar në Gjykatën Administrative të qytetit të Sofjes, u anuluan sepse ishin vendime dënimi të paligjshme të Kryeinspektorit, i cili gjobiti magistratët për mosdorëzimin e deklaratave të pasurisë sipas JSA-së brenda afatit kohor, pasi gjykata u shpreh se ato ishin lëshuar në mungesë të juridiksionit për shkak të mandatit të skaduar të Kryeinspektorit (mandati 5-vjeçar i Kryeinspektorit, i përcaktuar në Kushtetutë skadoi në prill të vitit 2020). Në këtë këndvështrim, është e nevojshme të theksohet se në prill të vitit 2022, Plenumi i Gjykatës së Lartë Administrative (SAC) e dërgoi çështjen në Gjykatën Kushtetuese (GjK) duke kërkuar një interpretim të detyrueshëm të dispozitës së nenit 132a duke iu referuar nenit 1, paragrafëve 1 dhe 2, nenit 4, paragrafit 1, nenit 8 dhe nenit 117, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë dhe Gjykata Kushtetuese iu përgjigj pyetjeve të mëposhtme:

“A pushojnë kompetencat e Kryeinspektorit dhe inspektorëve të inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me mbarimin e mandatit të tyre apo vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në zgjedhjen nga Asambleja Kombëtare të një Kryeinspektori të ri dhe përkatësisht të inspektorëve? A lejohet me Kushtetutë pezullimi për kohë të pacaktuar i veprimtarisë së Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkak të skadimit të mandatit të Kryeinspektorit dhe inspektorëve dhe mungesës së veprimtarisë së Kuvendit Kombëtar, i cili me Kushtetutë është i detyruar të zgjedhë Kryeinspektorin dhe përkatësisht inspektorët?”

Me kërkesën e Plenumit të Gjykatës së Lartë Administrative ka filluar çështja kushtetuese nr. 7/2022, për të cilën Gjykata Kushtetuese është në pritje të vendimit.

Një faktor i cili ndikon në tejkalimin e mungesave që vështirëson kryerjen me efikasitet të kontrolleve të deklaratave është nevoja për të përditësuar plotësisht kuadrin ligjor thelbësor në përputhje me kushtet e ndryshuara sociale dhe ekonomike dhe zhvillimin teknologjik të vendit. Mbrojtja efikase e këtyre marrëdhënieve me publikun mund të sigurohet nëpërmjet vendimeve rregullatore që nxisin sjelljen e kujdesshme procedurale të personave që e kanë të detyrueshme sipas JSA-së dhe duke i ofruar ISJC-së një gamë më të gjerë mekanizmash për mbledhjen e provave.

Si përfundim, mund të arrihet në konkluzionin se ISJC-ja ka dëshmuar se është një organ i pavarur mbikëqyrës brenda sistemit gjyqësor, duke luajtur një rol aktiv në parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe ndikimit të jashtëm të panevojshëm mbi gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit. Efikasiteti i kompetencave të ushtruara nga ISJC-ja në këtë drejtim mund të rritet si duke bërë ndryshimet e nevojshme legjislative dhe duke zgjeruar bashkëpunimin ndërmjet Inspektoratit, organeve dhe institucioneve të tjera që kryejnë kontrolle për konfliktin e interesit dhe për zbulimin e pasurive të personave që mbajnë poste të larta publike.

INSPEKTIMI DHE KONTROLLI I PUNËS SË MAGJISTRATËVE DHE GJYKATAVE SIPAS LEGJISLACIONIT ITALIAN. ROLI DHE AKTIVITETI I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT.



Maria Rosaria Covelli

Kryetare e Inspektoratit të Përgjithshëm, Inspektorati i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Itali

Znj. Maria Rosaria Covelli është diplomuar për drejtësi me 110 cum laude në Universitetin “La Sapienza” në Romë, me temën “E Drejtë e Krahasuar”, si dhe është emëruar në fillim Gjyqtare pranë Gjykatës së Milanos. Më pas znj. Covelli është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Romës, si dhe ka ushtruar detyrën e Kryetares së seksionit përgjegjës për korporatat, kontratat apo çështjet gjyqësore me administratën publike. Ndërsa për një periudhë 5 vjeçare znj. Covelli ka ushtruar detyrën e Kryetares së Viterbos.

Nga viti 2021 e në vazhdim znj. Covelli ushtron detyrën e Drejtueses së Inspektoratit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe është Kryetare e Komisionit Ministror për Drejtësinë në Italinë e Jugut.

Gjatë eksperiencës së saj si asistente në Universitetin “La Sapienza” të Romës në të “Drejtën e Krahasuar” ka nxjerrë ndër vite botime të ndryshme në fushën

e të drejtës civile dhe tregtare, komentare për enciklopedinë juridike Treccani mbi rregullat për shoqëritë aksionare, për sa i përket pjesës mbi “grupet e shoqërive në të drejtën e krahasuar”, si dhe gjithashtu shkrime mbi përmbajtjen e vendimeve gjyqësore në lidhje me aplikimin e inteligjencës artificiale në drejtësi.

Këshilli i Lartë i Magjistraturës (CSM-ja) ka vleftësuar mbi 20 praktika të mira të zbatuara në Gjykatën e Viterbos, shumë prej tyre në bashkëpunim me Universitetin e Tuscia-s. Në të njëjtën kohë, znj. Covelli ka mbajtur disa referime në konferenca në lidhje me temën e dhunës gjinore dhe informimit në pushtetin gjyqësor, apo në takime pranë Shkollës së Lartë të Gjyqësorit mbi çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë civile të magistratëve. Aktualisht znj. Covelli ushtron detyrën e koordinatores në lidhje me zhvillimin e takimeve ndërinstitucionale në provincën e Viterbos në lidhje me dëgjimin e viktimave të krimit.

1. Roli dhe veprimtaria e shërbimeve të inspektimit.

Ligji nr. 1311, datë 12 gusht 1962 i ka njohur Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, kompetencën për kryerjen e inspektimeve, për të cilat është vendosur kryerja e tyre nga Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm, në lidhje me:

- ▶ zyrat e shkallës së parë: gjykatat dhe prokuroritë publike;
- ▶ zyrat e rretheve: gjykatat e apelit, prokuroritë e përgjithshme, gjykatat për të mitur dhe prokuroritë publike për të mitur, gjykatat e ekzekutimit;
- ▶ Zyra për Njoftimin, Ekzekutimet dhe Ankesat (UNEP).

Tradicionalisht, në Gjykatën e Kasacionit dhe në Prokurorinë e Përgjithshme Publike pranë Gjykatës së Kasacionit nuk urdhërohet kryerja e asnjë lloji inspektimi, pasi këto zyra kanë një autonomi, e cila duhet të garantohet, lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre.

Personeli i Inspektoratit të Përgjithshëm, përbëhet si më poshtë:

- ▶ 19 Inspektorë Magjistratë të Përgjithshëm përveç Kryetarit dhe Zëvendës Kryetarit;
- ▶ 36 Kryeinspektorë (23 në detyrë);
- ▶ 18 Inspektorë Drejtorë.

PARASHIKIMET LIGJORE

Ligji nr. 1311, i datës 12 gusht 1962:

Seksioni 7 *“Në zbatim të udhëzimeve të ministrit, Shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm urdhëron kryerjen e inspektimeve në të gjitha zyrat e drejtësisë për të verifikuar nëse shërbimet ofrohen sipas ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve në fuqi.*

Inspektimet e përmendura në nënseksionin e mësipërm kryhen, si rregull, çdo tre vjet; Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm mund të urdhërojë që të përsëritet brenda një afati më të shkurtër në zyrat ku janë konstatuar apo raportuar mangësi apo parregullsi.

Në çdo kohë, sa herë që e gjykon të arsyeshme, Ministri mund të urdhërojë kryerjen e inspektimeve në zyrat e drejtësisë. Ministri mund të urdhërojë edhe inspektime të pjesshme në zyrat e drejtësisë, për të përcaktuar efikasitetin e tyre, nivelin dhe shpejtësinë e punës së magjistratëve të caktuar”.

Seksioni 9 *“Në përfundim të verifikimit, inspektori harton një raport ku përmend shkurtimisht parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara në shërbime dhe harton propozimet për eliminimin e tyre.*

Inspektorët Magjistratë raportojnë gjithashtu për nivelin dhe shpejtësinë e punës së kryer nga magjistratët, si dhe për aftësinë, gatishmërinë dhe sjelljen e punonjësve përgjegjës në zyrën e inspektuar.

Për sa i përket veprimtarisë së magjistratëve, zyrtarët e tjerë të cilët janë përfshirë në procesin e inspektimit nuk mund të shprehin vlerësime mbi informacionin e mbledhur në lidhje me personelin apo zyrën e inspektuar, por vetëm mund të mbledhin të dhëna statistikore.

Në rastet kur është urdhëruar një inspektim i ri, sipas Seksionit 7, Nënseksioni 2, si dhe konstatohet vazhdimësia e mangësive apo parregullsive të konstatuara më parë, Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm njofton nëpërmjet një raporti ministrin për masat e mundshme të cilat duhet të merren, qoftë këto edhe disiplinore.”

Seksioni 10 *Raportimi i detyrueshëm -“Nëse gjatë inspektimeve janë konstatuar shkelje ose parregullsi të rënda, Inspektori njofton menjëherë Kryetarin e Inspektoratit të Përgjithshëm, duke formuluar propozime për masat që duhet të merren. Kur vonesa mund të shkaktojë cenim, ai vetë duhet të japë udhëzimet e nevojshme për të shmangur parregullsitë.”*

Seksioni 12 *Hetimi administrativ-“Ministri mund të përdorë Inspektoratin e Përgjithshëm për kryerjen e hetimeve për personelin e drejtësisë dhe për çdo kategori tjetër personeli të punësuar në Ministrinë e Drejtësisë”.*

.....
Inspektori Magjistrat i ngarkuar për kryerjen e një hetimit ndaj një magjistrati, në fund të hetimit, i kërkon pa ndjekur ndonjë procedurë specifike informacion shefit të zyrës, i kërkon shpjegime magjistratit nën hetim, si dhe raporton në lidhje me shërbimin e ofruar nga ky i fundit, qëndrimet dhe aftësitë e shfaqura nga magjistrati nën hetim në ushtrimin e funksioneve gjyqësore, si dhe çdo fakt apo element tjetër që ka rëndësi në aspektin disiplinor. Kritere të ngjashme zbatohen edhe për hetimet që kryen ndaj punonjësve të tjerë.

Në përfundim të hetimit, Inspektori Magjistrati harton një raport të detajuar dhe bashkëngjit të dhënat dhe dokumentet e marra për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit nën hetim. Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm i njofton ministrin raportin e hetimit dhe propozon sipas rastit, për masat që duhet të merren. Një kopje e raportit do t'i njoftohet gjithashtu edhe Drejtorit të Përgjithshëm përgjegjës”.

2. Inspektimi i zakonshëm.

Sipas parashikimeve ligjore, veprimtaria e zakonshme e inspektimit zhvillohet **çdo tre vjet**, me kërkesë të Kryetarit të Inspektoratit, sipas një **programi vjetor**. Inspektimet e zakonshme kryhen nga Inspektorë Magjistratë të Inspektoratit (të cilët ndihmojnë Kryeinspektorët dhe Inspektorët Drejtorë dhe sipas nevojës nga punonjësit e UNEP [2] kompetente për ekzekutimet [3]).

Qëllimi i inspektimit të zakonshëm është kontrolli dhe verifikimi i **funksionimit dhe organizimit të zyrave të drejtësisë**, si për shërbimet administrative ashtu edhe në lidhje me punën e magjistratëve. Në mënyrë të veçantë, krahas detyrave të kontrollit që lid-

2 UNEP- Zyra për Njoftimin, Ekzekutimet dhe Ankesat.

3 Zyrat e NEP që ndodhen pranë gjykatave të apelit inspektohen gjatë kryerjes së kontrolleve në gjykatat e apelit; zyrat e tjera të NEP do të inspektohen gjatë kryerjes së kontrolleve në gjykatat ku ato ndodhen.

hen me rregullsinë e shërbimeve administrative, Inspektorët Magjistratë kanë për detyrë të raportojnë edhe *“për nivelin dhe shpejtësinë e punës së kryer nga magjistratët, si dhe për aftësinë, gatishmërinë dhe sjelljen e punonjësve përgjegjës në zyrën e inspektuar.”*

Zyrtarët e tjerë të inspektimit (Shefat dhe Drejtorët), të koordinuar gjatë procesit të inspektimit nga Kryetari i Grupit të Inspektorëve Magjistratë kanë për detyrë të verifikojnë aspekte të veçanta të shërbimeve, si dhe ata nuk mund të *shprehin vlerësime mbi informacion e mbledhur në lidhje me personelin apo zyrën e inspektuar*, për sa i përket veprimtarisë së magjistratëve, por veprimtaria e tyre duhet të fokusohet vetëm në mbledhjen e të dhënave administrative apo statistikore.

Si rregull, kontrollet dhe inspektimet pranë zyrave të Gjyqtarëve të Paqes, kryhen nga ana e Kryeinspektorëve.

Në përputhje dhe në harmoni të plotë me propozimet e Ministrit të Drejtësisë, Inspektorati i Përgjithshëm ka forcuar kontrollet mbi veprimarinë e zyrave të gjyqësorit, nëpërmjet konstatimit të praktikave të mira organizative që zbatohen nga çdo zyrë, si dhe aplikimit të tyre në zyrat e tjera.

Zhvillimi i inspektimit nënkupton krahas qëllimit monitorues të sipërpërmendur ashtu edhe grumbullimin e elementëve të nevojshëm mbi zbatimin e masave disiplinore, si dhe në të njëjtën kohë, nëpërmjet një procesi monitorimi periodik si një proces mbështetës për zhvillimin e shërbimeve të dhëna nga zyrat e drejtësisë në një aspekt sa më cilësor.

Në këtë këndvështrim, zhvillimi i inspektimit përfaqëson një mundësi për të orientuar shefat e zyrave dhe drejtuesit e administratës për të aplikuar modele organizative më rezultative. Në rast parregullsie, grupet e inspektimit sugjerojnë me prioritet çdo zgjidhje të

mundshme në aspektin organizativ me qëllim përmirësimin e shërbimeve dhe ushtrimit të aktiviteteve, si dhe rekomandon masat që duhet të merren apo jep udhëzimet e nevojshme për të shmangur parregullsitë [4].

Palët e interesuara gjatë një procesi inspektimi të zakonshëm janë:

- ▶ Departamenti i Inspektimit;
- ▶ Ekipi i Inspektimit (Magjistratët, Kryeinspektorët dhe Inspektorët Drejtorë);
- ▶ Departamenti i Statistikave, përgjegjës për:
 - koordinimin e të gjitha aktiviteteve ndërmjet palëve të interesuara të përfshira në procesin e inspektimit;
 - ofrimin e udhëzimeve për zyrat se si të mblidhen të dhënat e inspektimit;
 - kontrollin e unifikimit dhe plotësisë së përmbajtjes së raporteve të inspektimit mbi zhvillimin e procesit të inspektimit dhe efektivitetin e punës së magjistratëve;
 - zhvillimin e treguesve (indikatorët) në lidhje me veprimtarinë dhe menaxhimin e zyrës.
- ▶ Nëpunësi përgjegjës në lidhje me statistikën i deleguar nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Statistikave (DGSTAT);
- ▶ Zyra CISIA (zyra lokale e Drejtorisë së Përgjithshme të Sistemeve të Informacionit dhe Teknologjisë (DGSIA)), e cila ka për detyrë të përpunojë dhe të përditësojë të dhënat informatike të zyrave të gjyqësorit.

3. Inspektimi i jashtëzakonshëm.

Inspektimi i jashtëzakonshëm zhvillohet përpara afatit të zakonshëm tre vjeçar nga kontrolli i fundit. Ai mund të urdhërohet nga Kryetari

4 "Nëse gjatë inspektimeve janë konstatuar shkelje ose parregullsi të rënda, Inspektori njofton menjëherë Kryetarin e Inspektoratit të Përgjithshëm, duke formuluar propozime për masat që duhet të merren. Kur vonesa mund të shkaktojë cenim, ai vetë duhet të japë udhëzimet e nevojshme për të shmangur parregullsitë" (Seksioni 10 i ligjit nr. 1311/1962).

i Inspektoratit të Përgjithshëm^[5], sa herë që Inspektorët konstatojnë ose raportojnë parregullsi të rëndësishme dhe ka nevojë për hetim të mëtejshëm, ose nga Ministri i Drejtësisë kur ai/ajo e gjykon të përshtatshme^[6].

4. Inspektime të pjesshme ose të dedikuara.

Inspektimet e pjesshme ose të dedikuara (për sektorë ose shërbime të veçanta të një zyre gjyqësore) mund të urdhërohen ekskluzivisht nga Ministri i Drejtësisë^[7] për të vlerësuar efincencën e veprimtarisë së zyrave të gjyqësorit ose parregullsitë dhe mosfunksionimet në sektorë të caktuar, si dhe shpejtësinë e punës së zyrave ose magjistratëve të caktuar.

5. Hetimi administrativ.

Ministri i Drejtësisë *“Nëpërmjet Inspektoratit të Përgjithshëm mund të kryej hetime për personelin gjyqësor dhe për çdo kategori tjetër të personelit të punësuar nga Ministria e Drejtësisë”*. Veprimtaria e hetimit ka për qëllim hetimin dhe vërtetimin e fakteve ose sjelljeve të papërshtatshme nga ana e magjistratëve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore si psh. një rast papajtueshmërie ambientale apo papajtueshmërie për shkak të funksionit (Seksioni 2 i Aktit të Garancisë, Dekreti Legjislativ Mbretëror nr. 511 i datës 31 maj 1946). Në këto kushte, hetimi kryhet i autorizuar nga ministri dhe ka të bëjë me veprimtarinë e individëve dhe jo atë të zyrave. Gjatë hetimit individi subjekt hetimi me kërkesë të tij mund të kërkojë të dëgjohet, t'i nënshtrohet kontrollit, duke i'u garantuar e drejta e mbrojtjes.

Si rregull, punonjësi i Ministrisë së Drejtësisë është i detyruar të bashkëpunojë në këtë proces hetimi, detyrim ky, i cili lind në zbatim të parimit të besnikërisë dhe korrektësisë që nëpunësi civil është detyruar të respektojë.

5 Shembull, Seksioni 7, Nënseksioni 2, ligji nr. 1311/1962.

6 Shembull, Seksioni 7, Nënseksioni i fundit, ligji nr. 1311/1962.

7 Shembull Seksioni 7 Nënseksioni i fundit ligji nr. 1311/1962.

6. Mënyrat e planifikimit të procesit të inspektimit.

Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm çdo gjashtë muaj identifikon zyrat që do t'i nënshtrohen procesit të inspektimit; harton programin e inspektimit; cakton datën e fillimit për çdo inspektim; cakton inspektorët dhe organizon grupet e inspektimit.

Procesi i Inspektimi kryhet sipas “Udhëzuesit të Përgjithshëm” që Kreu i Inspektoratit ka miratuar dhe i cili mund të ndryshohet në bazë të objektivave të çdo viti, apo në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë. Në përgjithësi, gjatë vitit organizohen gjashtë cikle inspektimi. Në çdo cikël do të inspektohen rreth 6/7 e zyrave gjyqësore.

Për sa edhe është përmendur, inspektimet në zyrat gjyqësore do të kryhen nga një grup i përbërë nga një Inspektor Magjistrat, si kryetar grupi, si dhe nga disa inspektorë magjistratë ose Kryeninpektorë apo Inspektorë Drejtorë nga personeli administrativ, të cilët ushtrojnë funksione inspektimi.

Inspektorët Magjistratë janë gjyqtarë ose prokurorë. Secili prej tyre mund të caktohet për të inspektuar si gjykatat (zyrat e gjykimit) dhe prokuroritë (zyrat e hetimit). Inspektori Magjistrat, pasi caktohet si kryetar grupi, ushtron këto detyra:

- bën ndarjen e detyrave të inspektorët e tjerë;
- jep udhëzime për inspektorët për kryerjen e inspektimit;
- udhëzon inspektorët që të kryejnë inspektimet, në përputhje me udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara nga Kryetari i Inspektoratit të Përgjithshëm;
- kontakton me shefin e zyrës (kryetarin e Gjykatës dhe Gjykatës së Apelit - Prokurorin Publik dhe Prokurorin e Përgjithshëm) dhe i kërkon të hartojë një raport paraprak për gjendjen e veprimtarisë së zyrës dhe të plotësojë një pyetësor

me të gjitha të dhënat të cilat kanë lidhje me inspektimin dhe që do t'i nënshtrohen verifikimit në vend nga ana e grupit të inspektorëve.

Nga ana e tyre, inspektorët kontaktojnë me zyrtarët administrativë të zyrës që do të inspektohet dhe në radhë të parë u dërgojnë kërkesa për të dhëna statistikore (formularë dhe kërkesa të standardizuara).

Kohëzgjatja e inspektimeve ndryshon në varësi të madhësisë së zyrave gjyqësore që do të inspektohen. Si rregull, pas pandemisë Covid-19, kohëzgjatja e inspektimit është katër deri në pesë javë. Procesi i inspektimit fillon “në distancë”, pra “në distancë” për një javë; vazhdon me inspektim në vend për 10-15 ditë; përfundon me një javë të fundit “në distancë”.

6.1. Veprimtaria Paraprake.

Sipas një kalendarit të përbashkët për të gjitha inspektimet e zakonshme, i cili përcakton aktivitetet që do të kryhen dhe afatet brenda, të cilave duhet të kryhen ato, para fillimit të inspektimit (faza para inspektimit), fillon mbledhja e dokumentacionit të inspektimit: të ashtuquajturat “formate të detyrueshme” dërgohen pranë zyrës, e cila do të inspektohet për të siguruar të dhëna në lidhje me:

- Gjendjen e personelit gjyqësor dhe administrativ;
- Organizimin e veprimtarisë gjyqësore, veprimtarinë e personelit gjyqësor dhe shpërndarjen e çështjeve;
- Organizimin e shërbimeve administrative;
- Menaxhimin dhe krahasimin e çështjeve dhe zgjidhjen e procedimeve në fusha të ndryshme (civile dhe penale), aktet e punës së magjistratëve, si dhe kërkesat e standardizuara të përgatitura nga Inspektorati, me qëllim kryesor verifikimin e funksionimit të zyrës dhe çdo vonesë në lëshimin e urdhrave.

Vitet e fundit, prania në vend e grupit të inspektimit është zvogëluar për shkak të shkëmbimit dhe përpunimit të të dhënave në distancë, të cilat janë kërkuar nga ana e inspektorëve. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet aksesit në distancë në sistemet e informacionit të zyrës së inspektuar-të autorizuar nga drejtuesi i zyrës dhe nëpërmjet shkëmbimit të formateve të detyrueshme, pyetjeve dhe dokumenteve të standardizuara në platformën SHAREPOINT (një platformë dixhitale e përbashkët ku zyra e gjyqësorit e inspektuar, grupi i inspektimit, statisticienët dhe drejtuesi i inspektimit mund të veprojnë).

6.2. Mjetet teknike për ekstrapolimën e të dhënave.

Të dhënat ekstrapolohen nga sistemet e informacionit të departamentit, të cilat përdoren në fusha të ndryshme të veprimtarisë së zyrës gjyqësore:

Instanca e gjykimit	Funksioni	Zyrat gjyqësore	Sektori	Regjistrat elektronikë	Përpunimi i të dhënave statistikore	
Shkalla e Parë	Gjyqtarë	Gjykatë	Civile	SICID	Magazina e të Dhënave	Paketa e Inspektorëve
			Procedurat e falimentimit (paaftësisë paguese) dhe ekzekutimet	SIECIC		
			Penale	SICP	CONSOLLE	SIRIS/ARES
			Masat e Sigurimit	SITMP		
	Prokurorë Publikë	Prokuroria Publike	Penale	SICP	CONSOLLE	SIRIS/ARES
			Civile	SICID		
			Zbatimi i dënimeve	SIEP	Përmbledhje Inspektimi	

Instanca e gjykimt	Funksioni	Zyrat gjyqësore	Sektori	Regjistrat elektronikë	Përpunimi i të dhënave statistikore	
			Masat e Sigurimit	SICP/SIPPI/SIT-MP	Monitorimi Statistikor	
Shkalla e Dytë	Gjyqtarë	Gjykata e Apelit	Civile	SICID	Magazina e të Dhënave	Paketa e Inspektorëve
			Penale	SICP	CONSOLLE	SIRIS/ARES
			Masat e Sigurimit	SICP/SIPPI/SIT-MP	Monitorimi Statistikor	
	Prokurorë Publikë	Prokuroria Publike	Penale	SICP		SIRIS/ARES
			Civile	SICID		
			Masat e Sigurimit	SICP/SIPPI/SIT-MP	Monitorimi Statistikor	
Shkalla e Parë	Gjyqtarë	Gjykata e të Miturve	Civile	SIGMA	Statistika SIGMA	Paketa e Inspektorëve Minorenë
			Penale	SIGMA		
			Mbikëqyrje	SIUS (since 2018)	Monitorimi Statistikor	
Shkalla e Parë	Prokurorë Publikë	Prokuroria Publike e Gjykatës së të Miturve	Civile	SIGMA	Statistika SIGMA	Paketa e Inspektorëve Minorenë
			Penale	SIGMA		
Shkalla e Parë	Gjyqtarë	Gjykata dhe Zyra e Mbikëqyrjes	Penale	SIUS	Monitorimi Statistikor	
Shkalla e Parë	Gjyqtarë	Gjyqtarët e Paqes	Civile	SIGP		
Shkalla e Parë	Gjyqtarë	Gjyqtarët e Paqes	Penale	SIGP		

Për nxjerrjen e të dhënave nga gjykatat civile (zyrat e shkallës së parë) përdoret një sistem veprimi, i ashtuquajtur i “*paketë e inspek-*

torëve”. Ky është një sistem organik i nxjerrjes së të dhënave nga regjistrat elektronikë civilë, që iu vihet në dispozicion inspektorëve, drejtuesve të zyrave gjyqësore dhe vetë magjistratëve, për të krijuar një mjet fleksibël dhe të menjëhershëm për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e zyrave.

Nga njëra anë, ky sistem favorizon përmirësimin e planifikimit të aktiviteteve të zyrave të ndryshme gjyqësore dhe nga ana tjetër, siguron si identifikimin në kohë të aspekteve jofunksionale ashtu edhe optimizimin e kohës për mbledhjen e të dhënave. Ky mjet është shtrirë në Prokurorinë Publike dhe po studiohet shtrirja e tij në të gjithë sektorin e drejtësisë penale, për ta vënë atë në funksion për të gjitha fushat e veprimtarisë gjyqësore.

Në mënyrë të ngjashme, që nga viti 2020, mbledhja e të dhënave në distancë është përmirësuar, në fazën para inspektimit, duke thjeshtuar mbledhjen tyre në lidhje me çështjet në sektorin civil në shkallë të parë dhe duke i transferuar ato në “magazinën e të dhënave” të drejtësisë civile (DËGC) në vend të zyrave të caktuara të gjykatës.

Transmetimi i të dhënave në distancë siguron: (i) lehtësimin e ngarkesës së punës për zyrat individuale gjatë inspektimeve periodike dhe krahasimin e të dhënave të tyre me kalimin e kohës; si dhe (ii) një grumbullim të të dhënave të zyrave të ndryshme sipas një sistemi të unifikuar, duke sjellë si pasojë krahasimin e tyre në mënyrë sa më reale dhe objektive.

Një nga objektivat e Inspektoratit është krijimi i një baze të dhënash të vetme në të cilën mund të futen të gjitha rezultatet e inspektimeve individuale, sipas skemave homogjene të përfaqësimit të të dhënave. Kjo do t'i mundësojë Inspektoratit të kontribuojë më mirë në propozimin dhe punën e zhvillimit të strukturave të ndryshme ministrore dhe kabinetit të ministrit, duke rritur nivelin

e përqendrimit të të dhënave, të cilat aktualisht janë të shpërndara dhe grumbullohen në kuadër të zhvillimit të inspektiveve të veçanta.

6.3. Veprimtaria e Inspektimit.

Gjatë veprimtarisë së inspektimit, do të shqyrtohen të dhënat nga sistemi i informacionit dhe disa modele skedarësh për të verifikuar menaxhimin e duhur të shërbimeve të ndryshme.

Në mënyrë të veçantë, inspektorët kontrollojnë:

- **Shërbime administrative dhe kontabiliteti:** personeli, shpenzimet gjyqësore, mbledhja e borxheve, evidenca, asetet e sekuestruara, shërbimet, lista e këshilltarëve teknikë dhe lista e ekspertëve;
- **Shërbimet e drejtësisë civile:** proceset gjyqësore civile, procedurat e punës, procedurat e sigurimeve shoqërore dhe të mirëqenies, çështjet civile jokontestimore dhe çështjet me dyer të mbyllura - kujdestaria - trashëgimia - ndërmjetësimi për zgjidhjen e martesës dhe divorcin, procedurat përmbarimore civile (kundër pasurive të luajtshme, me ose pa palë të treta dhe pasurive të paluajtshme), procedurat e falimentimit;
- **Shërbimet e drejtësisë penale:** Zyra e Gjykatësit të Hetimit Paraprak, Zyra e Sesionit të Gjykatës Penale, Gjykata e Rishqyrtimit, masat e sigurimit, Gjykata Penale.

Gjithashtu, në kuadër të funksionimit të përgjithshëm të zyrave gjyqësore inspektorët do të kontrollojnë:

- Numrin e stafit gjyqësor dhe administrativ në raport me vendet e lira të punës;
- Zbatimin organigramës së zyrës hartuar nga nëpunësi përgjegjës dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës;

- Shpërndarjen e saktë të personelit administrativ;
- Menaxhimin e çështjeve civile dhe penale, vlerësimin e rasteve dhe për rrjedhojë mënyrën e ushtrimit të funksioneve;
- Praktikën e mira organizative dhe modelet më të sukseshme të cilat duhet të ndiqen;
- Vonesat në procedimin e çështjeve, parë në këndvështrimin e kohëzgjatjes së gjykimit;
- Depozitimin me vonesë të vendimeve gjyqësore nga gjyqtarët, të cilat kanë sjellë si pasojë lirimin me vonesë nga burgu të individëve;
- Gjendjen e teknologjisë së informacionit dhe nevojat në lidhje me mënyrën e përdorimit të këtyre sistemeve.

6.4. Parregullsi të konstatuara gjatë kontrollit.

Gjatë inspektimit, inspektorët i raportojnë Inspektorit Magjistrat (kryetarit të grupit) parregullsitë që Zyra nuk mund t'i zgjidhë në mënyrë të menjëhershme dhe/ose spontane. Inspektori Magjistrat do të informojë Shefin e Zyrës për këto parregullsi dhe kërkon shpjegime. Në këtë kuadër, Inspektori Magjistrat mund:

- ▶ të vendosë ndërprerjen e procesit të marrjes së të dhënave dhe shpjegimeve, si dhe:
 - nëse parregullsitë nuk janë serioze ose të rëndësishme, të cilat kërkojnë marrjen e masave të posaçme, mund të lëshojë rekomandime mbi mënyrën e zgjidhjes së tyre;
 - nëse parregullsitë janë serioze apo të rëndësishme propozon marrjen e “masave administrative” për zgjidhjen e këtyre parregullsive me një afat gjashtëmuor (neni 10, ligji nr. 1311/1962):
- ▶ të raportojë mbi parregullsitë apo konstatimin e shkeljeve disiplinore të Kryetarit të Inspektoratit të Përgjithshëm;
- ▶ t'i raportojë Kryetarit të Inspektoratit të Përgjithshëm mundësinë për t'i propozuar Ministrin të Drejtësisë të urdhërojë:

- kryerjen e një “inspektimi të dedikuar”, kur gjatë zhvillimit të një “inspektimi të zakonshëm” është shfaqur një situatë e komplikuar dhe komplekse lidhur me ofrimin e shërbimeve, e cila nuk mund të trajtohet nëpërmjet procesit të një inspektimi të zakonshëm;
- kryerjen e një “hetimi administrativ”, kur në një sektor të caktuar janë konstatuar parregullsi të rënda në veprimtarinë gjyqësore ose në sjelljen e magistratit/ëve;
- ▶ të raportojë në Prokurorinë Publike të Gjykatës së Audituesve në rast të një dëmi financiar të provuar, dhe të kërkojë nga zyra marrjen e masave për të parandaluar që situata të tilla të ndodhin në të ardhmen.

6.5. Raporti Përfundimtar.

Rezultatet përfundimtare në lidhje me zhvillimin e inspektimit dokumentohen:

- Në një raport individual nga ana e çdo inspektori, i cili ka qenë përgjegjës për kontrollin e ofrimit të shërbimeve. Në rastet kur parregullsitë në lidhje me ofrimin e shërbimeve nuk kanë ndonjë karakter të rëndë, atëherë inspektori përgjegjës harton edhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e tyre.
- Në kuadër të “Vërejtjeve të Përgjithshme”, të hartuara nga kryetari i grupit të inspektimit;
- Në kuadër të përmbledhur, ku pasqyrohet në mënyrë skematike dhe me grafikë të dhëna në lidhje me veprimtarinë, apo kapacitetet e zyrës në raport me ngarkesën e punës.

Në kuadër të “Vërejtjeve të Përgjithshme” kryetari i grupit të inspektimit analizon dhe trajton çështje, të cilat kanë të bëjnë me:

- situatën e ndërtesës, arredimin dhe pajisjet e punës;
- shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës (me një pyetësor

- specifik për Drejtuesin e Zyrës);
- përpunimin dhe trajtimin e të dhënave personale;
 - marrëveshjet dhe protokollet e nënshkruara nga Zyra (me Dhomën e Avokatëve, Urdhrat Profesionalë, Autoritetet Vendore, Universitetet);
 - përbërjen e zyrës (magjistratët dhe personelin administrativ) dhe aspekte të caktuar organizative, duke përfshirë shpërndarjen e detyrave dhe kriteret e caktimit të çështjeve tek magjistratët;
 - vlerësime mbi marrëdhënien që ekziston ndërmjet organizimit të zyrës dhe ushtrimit të funksioneve nga ana e saj;
 - ngarkesën e punës, produktivitetin dhe kohën e përpunimit të të dhënave në lidhje me sektorin në fushën penale dhe civile (Regjistrimi i procedimeve; Kapaciteti i zyrës për të trajtuar çështjet e ardhura; Analiza e të dhënave të mbledhura; Normat mesatare mbi trajtimin e çështjeve, si dhe ndryshimi i tyre në raport me çështjet e regjistruara, të trajtuara, si dhe të përfunduara, sipas secilit sektor; Produktiviteti; Procedurat në distancë; Koha mesatare e zhvillimit të procedimeve dhe koha e depozitimit të vendimeve; Masat organizative për të garantuar afatin kohor dhe përfundimin në kohë të çështjeve individuale; Gjendja e informacionit, praktikat e mira dhe modelet më të sukseshme, të cilat duhet të ndiqen; Vlerësime përfundimtare në lidhje me gjithë veprimtarinë e zyrës).

Rezultatet u komunikohen strukturave të ndryshme të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Magjistraturës, apo drejtuesve të zyrave në rrethe. Vërejtjet me karakter të përgjithshëm si dhe përmbledhjet e raportit, të cilat mund të bëhen publike, (për momentin, vetëm për zyrat e shkallës së parë) publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë.



SESIONI II:

**PAVARËSIA DHE PËRGJEGJSHMËRIA
E MAGJISTRATËVE.**

**GARANCITË DHE PROCEDIMI
DISIPLINOR I MAGJISTRATËVE.**

E DREJTA E SHPREHJES SË MAGJISTRATËVE DHE KUFIZIMI I SAJ SIPAS KËRKESAVE TË KONVENTËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (KEDNJ). PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE NË KËTO RASTE



Darian Pavli

Gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Z. Darian Pavli ka lindur më 7 prill 1975 në Vlorë, Shqipëri. Gjatë vitit 1993-1997 ka kryer studimet Bachelor në Drejtësi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe gjatë viteve 1997-1998 ka kryer studimet Master në Drejtësi (LL. M), Universiteti i Evropës Qendrore, Budapest, Hungari.

Z. Pavli është jurist me përvojë dhe ka ushtruar një sërë detyrash si: Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) Tiranë, 1998-2000; Asistent Pedagog i së “Drejtës Kushtetuese”, Universiteti i Tiranës, 1998-2000; Master në Drejtësi (LL. M), Univesiteti i Nju Jork-ut, Fakulteti i Drejtësisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 2000-2001; Studiues për situatën e të drejtave të njeriut në Evropën Juglindore, Vëzhgimi i të Drejtave të Njeriut 2001-2003; Avokat me përvojë, praktika e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut përpara gjykatave dhe mekanizmave më të rëndësishme ndërkombëtare,

Nisma për Drejtësi e Shoqërisë së Hapur, 2003-2015; Anëtar i grupit të punës për hartimin e Konventës së Këshillit Evropian për Aksesin e Dokumenteve Zyrtare, 2006-2008; Anëtar i grupit të punës për hartimin e Projektligjit për të Drejtën e Informimit për organizatën e Shteteve të Bashkuara, 2010; Hartuesi kryesor për reformat për ligjin kundër shpifjes (Kodi Penal dhe Kodi Civil) 2012; Këshilltar, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, Parlamenti i Shqipërisë, 2015-2016; Ekspert i ligjit për të Drejtat dhe Politikat e të Drejtave të Njeriut për Këshillin e Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare, Tiranë, 2017-2018; Ekspert me përvojë për projektin e Bashkimit Evropian mbi konsolidimin e Reformës në Drejtësi në Shqipëri, 2018; Anëtar i Komisionit të Ekspertëve të Këshillit Evropian mbi Gazetarinë Cilësore në Epokën Digjitale 2018; Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që prej 7 janar 2019.

Abstrakti i prezantimit

Qëllimi i këtij prezantimi të shkurtër është paraqitja e parimeve kryesore të zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet që përfshijnë sanksione të vendosura ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me deklaratat publike të bëra prej tyre ose që implikojnë në mënyra të tjera të drejtat e tyre të fjalës së lirë. Ndërkohë që ka vënë theks të madh në aftësinë e magistratëve për të folur për çështje të ndryshme me interes publik dhe veçanërisht ato që lidhen me ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit. Gjykata ka pranuar gjithashtu se magistratët në hapësirën ligjore evropiane janë subjekt i ushtrimit të diskrecionit që është i nevojshëm për të ruajtur besimin e publikut në autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit (siç parashikon shprehimisht paragrafi i dytë i nenit 10 të KEDNJ-së).

Garancitë procedurale - duke përfshirë të drejtën e aksesit në gjykatë, sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, për të kundërshtuar sanksionet e vendosura ndaj magistratëve - janë bërë një aspekt

thelbësor i analizës së Gjykatës. Sidomos në një kontekst evropian në të cilin kërcënimet sistematike ndaj pavarësisë së gjyqësorit duket se po shumëfishohen, duke kërkuar që të zbatohet një kontroll më i rreptë në Strasburg.

Do të filloj me një diskutim të çështjes kryesore të Dhomës së Madhe mbi temën “Baka kundër Hungarisë” e cila do të pasohet me referenca të shkurtra ndaj një numri çështjesh të tjera në të cilat Gjykata ka gjetur shkelje të ngjashme të nenit 10; dhe disa raste në të cilat, anasjelltas, nuk është konstatuar shkelje e atij neni. Më pas do të ofrohen disa vërejtje përmbyllëse.

Përmbledhje më të gjata të rasteve dhe disa burime shtesë mund të gjenden në vërejtjet e mia me shkrim, të cilat janë vënë në dispozicion të organizatorëve të kësaj konference.

A. Baka kundër Hungarisë (GC, 2016): një çështje kryesore mbi lirinë gjyqësore të shprehjes

Neni 6-1: Aksesi në gjykatë-të drejtat dhe detyrimet civile

Pamundësia e Kryetarit të Gjykatës Supreme për të kundërshtuar përfundimin e parakohshëm të mandatit të tij: shkelje e nenit 6.

Neni 10-Liria e shprehjes

Përfundimi i parakohshëm i mandatit të kryetarit të Gjykatës së Lartë si rezultat i qëndrimeve të shprehura publikisht në cilësinë e tij profesionale: *shkelje*

Faktet

Kërkuesi, ish-gjyqtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, u zgjodh Kryetar i Gjykatës Supreme të Hungarisë për një afat gjashtëvjeçar që përfundonte në vitin 2015. Në cilësinë e tij si kryetar i kësaj Gjykate dhe i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, ai

shprehu pikëpamjet e tij mbi reformat e ndryshme legislative që ndikonin në sistemin gjyqësor. Dispozitat kalimtare të Kushtetutës së re (Ligji Themelor i Hungarisë i vitit 2011) parashikonin që pasardhësi ligjor i Gjykatës Supreme do të ishte Kúria^[8] dhe se mandati i kryetarit të Gjykatës Supreme do të përfundonte pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së re. Si rrjedhojë, mandati i aplikantit si kryetar i Gjykatës Supreme përfundoi më 1 janar 2012. Sipas kriterëve për zgjedhjen e Kryetarit të Ri të Kúria, kandidatëve u kërkohesh që të kishin të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar në Hungari. Koha që shërbeu si gjyqtar në një gjykatë ndërkombëtare nuk u llogaritur. Kjo solli pamundësinë e aplikimit të tij për postin e Kryetarit të Kúria-s së Re.

Neni 6 § 1

Gjykata konkludoi se z. Baka kishte një të drejtë të diskutueshme për të qëndruar në pozicionin e tij për një mandat të plotë 6-vjeçar; dhe se kjo e drejtë kishte karakter civil sipas testit *Vilho Eskelinen*. Pika e parë e atij testi (për përjashtimin e zbatueshmërisë së nenit 6) nuk ishte përmbushur pasi ligji kombëtar nuk e përjashtonte shprehimisht aksesin në gjykatë përpara ndryshimeve kushtetuese. Legjislacioni kombëtar që përjashton aksesin në gjykatë duhej të ishte në përputhje me shtetin e së drejtës, i cili ndalonte ligjet që drejtoheshin kundër një personi të caktuar.

Në themel, u konstatua se vetë thelbi i të drejtës së aksesit në gjykatë ishte cenuar nga ndryshimet kushtetuese.

[Praktika gjyqësore Post-Baka: në rastet që përfshijnë ndërhyrje në statusin e gjyqtarëve—që përfshijnë funksionin e tyre të menjëhershëm gjyqësor, por edhe role të tjera që ata luajnë në sistemin e drejtësisë—pika e parë e testit Vilho Eskelinen është bërë kryesisht e parëndësishme pasi GJEDNJ-ja konstatoi gjithnjë e më shumë se pika e dytë e testit (besnikëria ndaj shtetit në funksione të caktuara

8 Emri historik i gjykatës më të lartë në Hungari

publike) nuk zbatohet pasi përgjegjësia e parë e gjyqtarëve është besnikëria ndaj shtetit të së drejtës. Shikoni në veçanti vendimin e fundit në Grzeda kundër Polonisë, GC. Si rezultat, neni 6 (1) kërkon që gjyqtarët të mund të kundërshtojnë ndërhyrjet në të drejtat e tyre civile të lidhura me statusin përpara një organi gjyqësor.]

Neni 10

a) Ekzistenca e një ndërhyrjeje

Në rastin konkret, asnjë gjykatë vendase nuk i kishte shqyrtuar ndonjëherë pretendimet e ankuesit ose arsyet e përfundimit të mandatit të tij. Prandaj, faktet e çështjes duhej të vlerësoheshin dhe konsideroheshin “në tërësinë e tyre” dhe, në vlerësimin e provave, Gjykata miratoi standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm”.

Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se në vitin 2011 kërkuesi, në cilësinë e tij profesionale si Kryetar i Gjykatës së Lartë dhe Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, kishte shprehur publikisht pikëpamje kritike për reforma të ndryshme legjislative që prekin gjyqësorin. Propozimet për t'i dhënë fund mandatit të kërkuesit u bënë publike dhe u dorëzuan në Parlament menjëherë pasi ai mbajti një fjalim parlamentar në nëntor 2011 dhe u miratuan brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër. Duke pasur parasysh sekuencën e ngjarjeve në tërësinë e tyre, *kishte prova prima facie të një lidhjeje shkakësore midis ushtrimit të lirisë së tij të shprehjes nga kërkuesi dhe përfundimit të mandatit të tij*. Kështu, barra e provës i kaloi Qeverisë.

Për sa i përket arsyeve të paraqitura nga qeveria për të justifikuar masën e kundërshtuar, nuk ishte e qartë se ndryshimet e bëra në funksionet e autoritetit të lartë gjyqësor ose detyrave të Kryetarit të tij ishin të një natyre kaq themelore sa mund ose duhej të kishin nxitur ndërprerjen e parakohshme e mandatit të kërkuesit. Si rrjedhojë, Qeveria nuk kishte treguar bindshëm se

masa e kundërshtuar lidhej me shtypjen e postit dhe funksioneve të kërkuesit në kuadrin e reformës së autoritetit të lartë gjyqësor. Rrjedhimisht, mund të supozohet se ndërprerja e parakohshme e mandatit të kërkuesit ishte nxitur nga pikëpamjet dhe kritikrat që ai kishte shprehur publikisht në cilësinë e tij profesionale, dhe në këtë mënyrë përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

b) *Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar*

Edhe pse ishte e dyshimtë se legjislacioni në fjalë ishte në përputhje me kërkesat e shtetit të së drejtës, Gjykata vazhdoi me supozimin se ndërhyrja ishte e përcaktuar me ligj. Shtetet Palë nuk mund t'i referoheshin në mënyrë legjitime pavarësisë së gjyqësorit për të justifikuar një masë të tillë si përfundimi i parakohshëm i mandatit të kryetarit të gjykatës për arsye që nuk ishin përcaktuar me ligj dhe që nuk kishin të bënin me ndonjë bazë të paaftësisë profesionale ose sjellje të papërshtatshme. Në këto rrethana, masa e kundërshtuar dukej se ishte e papajtueshme me qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit.

1. Në rastin konkret, ndërhyrja e kundërshtuar ishte nxitur nga kritikrat që kërkuesi kishte shprehur publikisht në cilësinë e tij profesionale si Kryetar i Gjykatës së Lartë dhe i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë. Nuk ishte vetëm e drejta e tij, por edhe detyra e tij për të shprehur mendimin e tij për reformat legjislative, të cilat mund të kishin ndikim në gjyqësor dhe në pavarësinë e tij.
2. Kërkuesi kishte shprehur pikëpamjet dhe kritikrat e tij për çështje me interes publik dhe deklaratat e tij nuk kishin shkuar përtej kritikës së thjeshtë nga një këndvështrim strikt profesional. Rrjedhimisht, pozicioni dhe deklaratat e tij kërkonin një shkallë të lartë mbrojtjeje për lirinë e tij të shprehjes dhe shqyrtim të rreptë të çdo ndërhyrjeje, me një diferencë të ngushtë vlerësimi që u jepet autoriteteve vendase.

3. Gjithashtu, ai u hoq nga detyra më shumë se tre vjet përpara përfundimit të afatit të caktuar të zbatueshëm sipas legjislacionit në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij. Kjo vështirë se mund të pajtohej me konsideratën e veçantë që duhet t'i kushtohej natyrës së funksionit gjyqësor si një degë e pavarur e pushtetit shtetëror dhe parimit të pandryshueshmërisë së gjyqtarëve, i cili ishte një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.
4. Përfundimi i parakohshëm i mandatit të kërkuesit padyshim pati një efekt drithërues në atë që duhet të ketë dekurajuar jo vetëm atë, por edhe gjyqtarët dhe kryetarët e tjerë të gjykatave në të ardhmen nga pjesëmarrja në debatin publik mbi reformat legjislative që prekin gjyqësorin dhe në përgjithësi për çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqësorit.
5. Së fundi, në kuadrin e gjetjeve të Gjykatës sipas nenit 6 § 1, kufizimet e kundërshtuara nuk ishin shoqëruar nga masa mbrojtëse efikase dhe të përshtatshme kundër abuzimit. Në përmbledhje, arsyet në të cilat mbështetet shteti i paditur nuk mund të konsideroheshin si të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja, për të cilat u bë ankimi, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

B. Çështje të tjera të përzgjedhura që konstatojnë shkelje të lirisë së shprehjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve⁹

Kudeshkina kundër Rosisë (2009)

Kërkuesja dha dorëheqjen nga detyra gjyqësore dhe kandidoi për zgjedhje parlamentare, por nuk u zgjodh. Ajo dha intervista në media gjatë fushatës zgjedhore që ishin shumë kritike për presionet mbi gjyqësorin nga ana e kryetarëve të gjykatave dhe aktorëve të jashtëm, mungesën e pavarësisë së gjyqësorit, madje

⁹ Shikoni Shtojcën për përmbledhje më të detajuara. I jam mirënjohës praktikantes sime, Ayse Guzel Ozturk, për ndihmën e saj në përgatitjen e kësaj shtojcjeje.

edhe ndërhyrjen e drejtpërdrejtë në funksionin e saj gjyqësor në një çështje të profilit të lartë.

Statusi i saj gjyqësor u ndërpre pas procedurave disiplinore për deklarata të rreme dhe shkaktim të humbjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor rus.

GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të të drejtave të saj të nenit 10 në bazë të faktit se deklaratat e kërkueses ishin në natyrën e opinioneve dhe nuk zbuluan ndonjë sekret konsultativ. Ato prekën çështje me interes të madh publik dhe nuk përbënin sulme personale të pabaza. Fakti që çështja e saj u dëgjua nga Gjykata e qytetit të Moskës, të cilën ajo e kishte kritikuar në deklaratat e saj publike, përbënte një të metë të rëndë procedurale. Dënimi ishte i rëndë dhe mund të kishte një efekt drithërues për gjyqtarët e tjerë.

Brisë kundër Rumanisë (2018)

Një prokuror i lartë që vepronte gjithashtu si ndërlihdës shtypi, bëri një deklaratë për mediat mbi një hetim penal në proces për tregtimin e ndikimit brenda sistemit penitenciar. Një gjyqtar që mbikëqyrte burgun në fjalë bëri një ankesë disiplinore, duke argumentuar se deklaratat e kërkuesit, ku përmendeshin pretendimet e bëra nga një i dyshuar, kishin krijuar përshtypjen se gjyqtari kishte qenë pjesë e skemës së korrupsionit. Kërkuesi u qortua dhe u ul nga pozicioni i tij.

GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 10 mbi bazën se deklaratat e kërkuesit, të bëra gjatë ushtrimit të detyrave të tij si oficer shtypi, nuk kishin zbuluar asnjë sekret hetimor dhe nuk kishin përmendur asnjë individ, pasi ishin bërë disa arrestime. Gjykatat vendase nuk kishin kryer një balancim të duhur të të drejtave të kërkuesit me dëmtimin e supozuar të reputacionit të gjyqtarit të prekur.

Kërkuesi ishte gjyqtar i gjykatës rajonale dhe anëtar i këshillit kombëtar të gjyqësorit (KKGj), si dhe zëdhënës i KKGj-së. Në këtë cilësi, ai bëri komente kritike për propozimet legislative të qeverisë për reformat në Gjykatën Kushtetuese, KKGJ dhe gjykatat e zakonshme. Ai u ankua se gjyqësori nuk ishte konsultuar për reformat e propozuara.

Byroja kundër korrupsionit kreu një auditim të deklaratave financiare të kërkuesit. Ministria e Drejtësisë urdhëroi një inspektim të vendimmarrjes së tij gjyqësore bazuar në një letër anonime. Kryetari i ri i gjykatës rajonale e shkarkoi kërkuesin nga roli i tij si zëdhënës i asaj gjykate.

Gjykata gjeti një ndërhyrje në të drejtat e nenit 10 të kërkuesit bazuar në grumbullimin e masave të ndryshme, të cilat u konstatuan se kishin për qëllim që ta bënin atë të heshtte. Ishte veçanërisht e rëndësishme që deklaratat e tij, të cilat nuk sulmonin asnjë koleg gjyqësor, të bëheshin në cilësinë e zëdhënësit të KKGJ-së, organ i ngarkuar me ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së degës së drejtësisë. Ata nuk shkuan përtej kritikave nga një këndvështrim strikt profesional.

C. Çështjet e përzgjedhura që rezultojnë në konstatimin se nuk ka shkelje të nenit 10: detyrat e diskrecionit të magjistratëve dhe arsye të tjera të lejueshme të kufizimit

Kërkuesi ishte kryetar i Gjykatës së Lartë në kohën përkatëse. Ai vazhdimisht refuzoi të lejonte një grup audituesish nga Ministria e Financave të kryenin një auditim në Gjykatën e Lartë, me argumentin se autoriteti për të kryer auditime të tilla i takonte zyrës së lartë të auditimit.

Ministri i Drejtësisë nisi procedimin disiplinor pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila e shpalli kërkuesin fajtor për një shkelje të rëndë disiplinore dhe vendosi sanksion disiplinor (ulje page). Kërkuesi pretendoi se ai ishte sanksionuar për shkak të opinioneve të tij ligjore.

GJEDNJ-ja e shpalli ankesën të papranueshme pasi nuk kishte të bënte me një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuesit. Sanksionet lidheshin me kryerjen e detyrave të tij administrative si kryetar i drejtësisë dhe nuk buronin nga pikëpamjet e shprehura prej tij për çështje me interes publik.

Di Giovanni kundër Italisë (2013)

Kërkuesja, kryetare e një gjykate të Napolit në atë kohë, dha një intervistë në media në lidhje me një hetim penal në pritje për një ndërhyrje të supozuar në rezultatet e një konkursi gjyqësor. Ajo deklaroi se kjo gjë kishte qenë për të favorizuar një të afërm të një gjyqtari tjetër dhe ish-anëtar të CSM-së, të cilit nuk ia përmendi emrin, por ishte i identifikueshëm nga deklaratat e saj.

Prokurorja publike në Gjykatën e Kasacionit ka iniciuar procedurë disiplinore për mospërbushje të detyrës së saj të diskrecionit dhe respektimit të kolegëve të saj. Kërkueses iu dha një paralajmërim.

GJEDNJ-ja nuk gjeti shkelje të nenit 10. Kërkuesja kishte bërë akuza të rënda që përfshinin një koleg, bazuar në thashethemet që më vonë rezultuan të pabaza dhe pa e cilësuar vërtetësinë e tyre. Organi disiplinor kishte dhënë arsye bindëse për gjetjet e tyre dhe sanksioni i vendosur ishte më pak i rëndë nga ato të parashikuara nga ligji kombëtar. Prandaj, çështja kishte dallim nga çështja Kudeshkina, ku kritikrat e kërkueses ndaj gjyqtarëve të tjerë bazoheshin në përvojën e saj të drejtpërdrejtë dhe u konfirmuan nga dëshmitarët.

D. Konkluzione

Disa nga çështjet kryesore në këtë fushë kanë të bëjnë me situatat në të cilat gjyqtarët e lartë janë sanksionuar nga organet disiplinore ose u është ndërprerë mandati, në thelb, sepse kanë folur kundër politikave legislative ose ekzekutive që ata konsideronin se përbënin një kërcënim për pavarësinë e gjyqësorit dhe shtetin e së drejtës. Të dyja çështjet Baka dhe Zurek janë ilustruese të këtij trendi.

Prandaj nuk është befasuese që, përballë një situatë erozioni të shtetit të së drejtës në shtete anëtare të caktuara të Këshillit të Evropës, jurisprudenca e gjykatës ka qenë fuqimisht dhe gjithnjë e më shumë mbrojtëse ndaj aftësisë së gjyqtarëve për të shprehur shqetësimet e tyre dhe për t'u përfshirë në debatin publik rreth kërcënimeve të perceptuara ndaj integritetit të degës gjyqësore.

Forcimi i garancive procedurale, sipas nenit 6 (1) të KEDNJ-së (aksesi në gjykatë), i cili mbron të drejtën e magjistratëve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore ndaj një game të gjerë masash që ndikojnë negativisht në statusin e tyre, është zhvilluar në një drejtim të ngjashëm. Këto masa mbrojtëse procedurale zbatohen gjerësisht për “përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile”, duke përfshirë në parim çdo sanksion të vendosur në lidhje me ushtrimin e lirisë së shprehjes nga ana e magjistratëve.

Në të njëjtën kohë, jurisprudenca e Gjykatës ka pranuar vazhdimisht se statusi i veçantë i funksionit gjyqësor vendos gjithashtu kufizime të caktuara legjitime në aftësinë e gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë të drejtësisë për të folur në publik. Këto kufizime janë jo vetëm të lejueshme, por edhe të nevojshme për të ruajtur dinjitetin dhe autoritetin e funksionit gjyqësor, besimin e publikut në sistem si dhe të drejtat e palëve ndërgjyqëse në proceset gjyqësore.

Në vitin 2021, Gjykata e Strasburgut përditësoi dhe përmirësoi

Rezolutën e saj mbi Etikën Gjyqësore. Parimi VI i Rezolutës parashikon si më poshtë:

VI. Shprehja dhe kontaktet

“Gjyqtarët duhet të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes në një mënyrë të pajtueshme me dinjitetin e detyrës së tyre dhe me besnikërinë e tyre ndaj institucionit të Gjykatës. Ata do të përmbahen nga të shprehurit, në çfarëdo forme dhe mjedisi, në një mënyrë që mund të dëmtojë autoritetin dhe reputacionin e Gjykatës ose të shkaktojë dyshime të arsyeshme në lidhje me pavarësinë ose paanshmërinë e tyre. Kjo vlen njëllë për ushtrimin e funksionit gjyqësor, përfaqësimin e Gjykatës dhe për aktivitete akademike ose të tjera publike ose private jashtë Gjykatës. Ata do të procedojnë me kujdesin maksimal nëse përdorin mediat sociale.”

E. Burime të mëtejshme të GJEDNJ-së

1. Mbrojtja e gjyqtarëve (Neni 6–pjesa civile): <https://echrlink/dm?document=6309761>
Përmbledhja përfshin referenca të shkurtra në praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas neneve 8 dhe 10 që kanë të bëjnë me lirinë e fjalës dhe të drejtën për jetën private të gjyqtarëve.
2. Udhëzues i praktikës gjyqësore për nenin 10: https://echr.coe.int/Documents/Guide_Art_10_ENG.pdf
Ai përfshin një kapitull mbi “mbrojtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë dhe lirisë së shprehjes: e drejta për lirinë e shprehjes në kontekstin e procedurave gjyqësore dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve në debatin publik” (fq. 74-84).

3. Rezoluta e GJEDNJ-së për Etikën Gjyqësore (2021): https://echr.coe.int/Documents/Resolution_Judicial_Ethics_ENG.pdf.



SHTOJCA

**PRAKTIKË GJYQËSORE E PËRZGJEDHUR MBI
LIRINË E SHPREHJES SË GJYQTARËVE**

**1. Kudeshkina kundër Rusisë,
29492/05, 26 shkurt 2009 (shkelje)**

Fjalimi i kërkueses

Kërkuesja, e cila punonte si gjyqtare prej 18 vjetësh dhe mbante detyrën gjyqësore në Gjykatën e Qytetit të Moskës, kandidoi për zgjedhje të përgjithshme në Dumën e Shtetit. Ajo dha intervista për dy gazeta dhe një stacion radio gjatë fushatës së saj zgjedhore, e cila përfshinte një program për reformën në drejtësi. Ajo kritikoi shumë gjyqësorin rus, shprehu dyshimet e saj për ekzistencën e gjykatave të pavarura në Rusi dhe përmendi “rastet kur një gjykatë është vënë nën presion për të marrë një vendim të caktuar”. Ajo deklaroi se “gjykatat përdoren si instrument i manipulimit tregtar, politik apo personal”, se “gjyqtari, megjithëse i përcaktuar me ligj si mishërim i pushtetit gjyqësor dhe i pavarur në këtë cilësi, në fakt shpesh e gjen veten në pozicionin e një nëpunësi të zakonshëm, vartësit të një kryetari gjykate”, “askush nuk mund të jetë i sigurt se çështja e tij – civile, penale apo administrative do të zgjidhet në përputhje me ligjin dhe jo vetëm për të kënaqur dikë” dhe se “nëse të gjithë gjyqtarët heshtin, ky vend së shpejti mund të përfundojë në një [gjendje] paligjshmërie gjyqësore”. Ajo tha gjithashtu: “Në Siberi ... gjykatat janë shumë më të pastra se në Moskë. Atje nuk mund të imagjinohet një manipulim kaq brutal dhe nuk do të flitej për korrupsion në një masë të tillë”. Kërkuesja përmendi gjithashtu se prokurori publik dhe kryetari i Gjykatës së qytetit

të Moskës ushtronin presion ndaj saj në një çështje të profilit të lartë në lidhje me abuzimin e pushtetit nga një hetues policie, z. Zaytsev, dhe se Kryetari vendosi më pas të tërheqë çështjen nga ajo pa asnjë shpjegim. Kërkuesja nuk u zgjodh dhe nuk u rikthye në detyrën e saj të mëparshme gjyqësore.

Sanksionet dhe motivet e dhëna

Bordi i Kualifikimit të Gjyqësorit të Moskës e ngarkoi kërkuesen me një shkëlqje disiplinore për shkak të një sërë deklaratash të bëra gjatë tre intervistave të saj në media dhe vendosi të ndërpresë detyrën e saj si gjyqtare në përputhje me ligjin për Statusin e Gjyqtarëve në Rusi. Disa pjesë të arsyetimit lexohen si më poshtë:

“[Ajo] me vetëdije dhe qëllimisht shpërndau në shoqërinë civile trillime të rreme dhe të pavërteta në lidhje me arbitraritetin që pretendohet se mbizotëron në sferën gjyqësore ...

... shpërndarja nga ana e një gjyqtareje e një informacioni të tillë përbën një rrezik të madh publik ... [kjo] çon në humbjen e besimit të publikut në drejtësinë dhe paanshmërinë e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura përpara gjykatave.

...

Përveç kësaj,... [ajo] zbuloi informacione specifike faktike në lidhje me procedurën penale në rastin kundër Zaytsev, para se vendimi në këtë rast të hynte në fuqi.

...

Në zgjedhjen e sanksionit disiplinor që do t'i vendoset [kërkueses], bordi i kualifikimit merr parasysh se në bërjen e deklaratave të saj [ajo] çnderoi gjyqtarët dhe sistemin gjyqësor të Ruisë; ajo shpërndau informacione të rreme për kolegët e saj; ajo tregtoi dinjitetin, përgjegjësinë dhe integritetin e një gjyqtari me një karrierë politike; ka treguar njëanshmëri gjatë dëgjimit të një çështjeje; preferoi interesat e saj politike dhe

interesa të tjera ndaj vlerave të drejtësisë; abuzoi me statusin e saj si gjyqtare në propagandimin e nihilizmit ligjor duke shkaktuar dëme të pariparueshme në themelet e autoritetit gjyqësor.”

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës së qytetit të Moskës, e cila më pas la në fuqi vendimin e bordit të kualifikimit, duke arritur në përfundimin se kërkuesja kishte abuzuar me të drejtën e lirisë së shprehjes për ambiciet politike, se ajo kishte mohuar publikisht shtetin e së drejtës dhe se një sjellje e tillë ishte e papajtueshme me ushtrimin e funksionit gjyqësor. Ajo gjithashtu u shpreh se gjatë pezullimit të detyrës së saj gjyqësore për fushatën e saj zgjedhore, ajo vazhdonte të ishte e detyruar të zbatonte rregullat e sjelljes së zbatueshme për gjyqtarët.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10, duke u shprehur se autoritetet vendase nuk arritën ekuilibrin e duhur midis nevojës për të mbrojtur autoritetin e gjyqësorit dhe mbrojtjes së reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, nga njëra anë, dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kërkueses për lirinë e shprehjes nga ana tjetër. Pasi supozoi se masa në fjalë përputhej me dy kushtet e para, Gjykata vazhdoi të shqyrtonte nëse ajo ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Komentet e kërkueses për procedurat në pritje në çështjen Zaytsev duhet të konsiderohen si deklarata fakti të cilat, në kontekstin e dhënë, ishin të pandashme nga opinionet e saj në të njëjtat intervista. Nuk kishte asgjë në këto intervista që do të justifikonte pretendimet për “zbulim informacionesh”.

Kërkuesja bëri kritika publike në lidhje me gjyqësorin rus dhe ngriti një çështje shumë të rëndësishme me interes publik, e cila duhet

të jetë e hapur për debat të lirë në një shoqëri demokratike. Edhe nëse kërkuësja i lejonte vetes një shkallë të caktuar ekzagjerimi dhe përgjithësimi, karakteristikë e axhitimit parazgjedhor, deklaratat e saj nuk ishin plotësisht pa asnjë bazë faktike dhe për këtë arsye nuk duhet të konsideroheshin si një sulm personal pa pagesë, por si një koment i drejtë për një çështje me rëndësi të madhe publike.

Mënyra e vendosjes së sanksionit disiplinor ndaj kërkuëses nuk kishte arritur të siguronte garanci të rëndësishme procedurale. Megjithëse kërkuësja kërkoi si nga Gjykata e qytetit të Moskës, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë që çështja të transferohej nga Gjykata e qytetit të Moskës në një gjykatë tjetër të shkallës së parë me arsyetimin se anëtarëve të asaj gjykate do t'u mungonte paanësia objektive, ata e shpërfillën këtë kërkesë. Sipas mendimit të Gjykatës, ky dështim përbënte një mosveprim të rëndë procedural.

Gjykata gjeti dënimin e vendosur ndaj kërkuëses “të rëndë në mënyrë disproporcionale”, dhe, për më tepër, me “efekt drithërues” për gjyqtarët që dëshironin të merrnin pjesë në debatin publik mbi efikasitetin e institucioneve gjyqësore.

2. Tosti kundër Italisë (dec.), 27791/06, 12 maj 2009 (i papranueshëm)

Fjalimi i kërkuësit

Kërkuësi, i cili është magjistrat, kishte një lidhje me një grua të martuar, e cila mbeti shtatzënë. Fëmija u njoh nga burri i gruas dhe gruaja i dha fund marrëdhënies së saj me kërkuësin. Kërkuësi, duke qenë i bindur se ai ishte babai i fëmijës, bëri një ankesë për të përcaktuar atësinë e fëmijës. Gjatë kësaj procedure, kërkuësi dërgoi një psikolog në shtëpinë e çiftit të martuar për të informuar bashkëshortin se fëmija nuk ishte djali i tij. Çështja u publikua

gjerësisht dhe kërkuesi dha disa intervista dhe u shfaq në një shfaqje televizive për të kërkuar atësinë.

Sanksionet dhe motivet e dhëna

Pas një ankese të çiftit të martuar, Këshilli i Lartë i Magjistraturës (*le Conseil supérieur de la magistrature, CSM*) filloi procedimin disiplinor kundër kërkuesit me arsyetimin se ai ishte sjellë në mënyrë persekutuese ndaj çiftit dhe jo në përputhje me dinjitetin e funksionit. CSM-ja vendosi të transferonte kërkuesin në një qytet tjetër për arsye papajtueshmërie. Le Conseil d'Etat la në fuqi vendimin, nga i cili ishte e qartë se transferimi i diskutueshëm plotësonte nevojën për të parandaluar dhe kufizuar rrezikun e cenimit të pavarësisë dhe prestigjit të funksionit gjyqësor.

Arsyetimi i Gjykatës

Pasi vuri në dukje se transferimi i kërkuesit u vendos për shkak të sjelljes së tij - përfshirë intervistat - ndaj çiftit në fjalë, Gjykata deklaroi se transferimi i kërkuesit mund të analizohej si një ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Gjykata konstatoi se masa përmbushte qëllimin legjitim për të garantuar “autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit”. Për sa i përket faktit nëse transferimi i kërkuesit ishte “i nevojshëm”, Gjykata vlerësoi se masa në fjalë nuk ishte në disproporcion me qëllimin e ndjekur. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazë dhe duhet refuzuar. (Shënim i brendshëm: Nuk e kuptova pse Gjykata nuk vendosi që nuk kishte shkelje, por përkundrazi e gjeti ankesën si haptazi të pabazë.)

3. Harabin kundër Sllovakisë, 58688/11, 20 nëntor 2012 (e papranueshme)

Sjellja e kërkuesit

Kërkuesi, i cili është Kryetar i Gjykatës së Lartë, nuk lejoi një grup audituesish nga Ministria e Financave të kryenin një auditim në Gjykatën e Lartë, me arsyetimin se ishte Zyra e Lartë e Auditimit ajo që kishte autoritetin për të mbikëqyrur administrimin e fondeve publike nga Gjykata e Lartë. Kishte qëndrime të ndryshme se cili organ kishte të drejtë të kryente auditimin në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi argumenton se procedimi disiplinor i nisur kundër tij ndoqi qëllimin e sanksionimit të tij për opinionet e tij ligjore, në kundërshtim me të drejtën e tij për lirinë e shprehjes dhe mendimit.

Sanksionet dhe motivet e dhëna

Pas një parashtrimi të Ministrit të Financave që tregonte se kërkuesi kishte penguar katër herë një grup audituesish nga Ministria e Financave për të kryer një auditim, Ministri i Drejtësisë nisi procedimin disiplinor ndaj kërkuesit në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkuesin fajtor për një shkelje të rëndë disiplinore, duke deklaruar se ai nuk kishte përmbushur siç duhet, me ndërgjegje dhe në kohën e duhur detyrimet e tij në lidhje me administrimin e gjykatës. Gjykata Kushtetuese vendosi një sanksion disiplinor ndaj kërkuesit, i cili konsistonte në një ulje prej 70% të pagës së tij vjetore (që korrespondon me 51,299.96 Euro).

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata arriti në përfundimin se masa e kontestuar nuk përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së kërkuesit për lirinë e

shprehjes, dhe për këtë arsye, ankesa është qartazi e pabazë dhe duhet të refuzohet.

Sjellja profesionale e kërkuesit në kontekstin e administrimit të drejtësisë dhe në lidhje me një autoritet tjetër shtetëror përfaqëson aspektin thelbësor të çështjes. Procedimi disiplinor kishte të bënte me shkarkimin nga kërkuesi të detyrave të tij si Kryetar i Gjykatës së Lartë, dhe për rrjedhojë shtrirjen në sferën e punësimit të tij në shërbimin civil. Shkelja disiplinore nuk përfshinte asnjë deklaratë apo pikëpamje të shprehur prej tij në kontekstin e një debati publik apo në media. Gjykata e dalloi çështjen në fjalë nga rastet e tjera, në të cilat masat në thelb lidheshin me lirinë e shprehjes (Wille kundër Lihtenshtejnit [GC], pikëpamje të shprehura nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Lihtenshtejnit gjatë një leksioni publik; Kudeshkina kundër Ruisë, deklaratat e një gjyqtari për mediat; Kayasu kundër Turqisë, forma dhe përmbajtja e teksteve të hartuara nga një prokuror publik dhe një nëpunës civil të shpërndara më pas në shtyp).

4. Di Giovanni kundër Italisë, 51160/06, 9 korrik 2013 (asnjë shkelje)

Fjalimi i kërkueses

Pas një konkursi publik për rekrutimin e gjyqtarëve, u hap një hetim penal ndaj një anëtari të jurisë së konkursit, i akuzuar se kishte falsifikuar rezultatet e konkursit për të favorizuar një kandidat. Kërkuesja, e cila ishte Kryetare e Gjykatës së Ekzekutimit të Dënimeve të Napolit në atë kohë materiale, dha një intervistë për një gazetë të përditshme, e cila publikoi deklaratat e mëposhtme të kërkueses:

“...Në ditët e fundit mësuam një lajm jashtëzakonisht të rëndë në lidhje me ndërhyrjen e një anëtari të jurisë së konkursit të fundit [për akses në drejtësi] në favor të një të njohuri të një magjistrati të njohur napolitan, i cili është padyshim tashmë një anëtar i CSM [Këshilli i Lartë i Magjistraturës] dhe, edhe më natyrshëm, anëtar aktual i shquar i ANM [Shoqata Kombëtare e Magjistratëve].”

Gazeta e përditshme botoi një intervistë të dytë me kërkuesen, në të cilën ajo sqaroi deklaratat e saj të mëparshme. Pas publikimit të intervistave, në shtyp dolën artikuj të tjerë që lidhnin një magjistrat napolitan, E. F., me veprat penale që lidheshin me konkursin publik.

Sanksionet dhe motivet e dhëna

Prokurori publik në Gjykatën e Kasacionit filloi procedimin disiplinor kundër kërkueses me arsyetimin se ajo nuk kishte përmbushur detyrat e saj të respektimit dhe diskrecionit ndaj anëtarëve të CSM-së dhe një prej kolegëve të saj. Seksioni Disiplinor i KSHM-së e shpalli kërkuesen pjesërisht fajtores për veprat për të cilat ajo akuzohej dhe i dha një paralajmërim.

Seksioni Disiplinor konsideroi, në radhë të parë, se kritikën e kërkueses ndaj veprimtarisë dhe funksionimit të CSM-së dhe ANM-së përbënin shprehjen e lirë të një bindjeje personale, e cila si e tillë nuk mund të jetë subjekt i sanksioneve. Nga ana tjetër, deklaratat e kërkueses në lidhje me një nga koleget e saj kishin karakterin e një shkeljeje disiplinore. Detajet e dhëna nga kërkuesja i referoheshin padiskutim E. F., i vetmi ish-anëtar i CSM-së dhe anëtar aktual i shquar i ANM-së, vajza e të cilit kishte marrë pjesë në konkursin për rekrutimin e gjyqtarëve në fjalë. Në këtë mënyrë, deklaratat në fjalë tentonin të konfirmonin për opinionin publik thashethemet e pabaza për një koleg.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 10. Masa në fjalë nuk ishte në disproporcion me qëllimin e ndjekur (mbrojtja e “reputacionit ose të drejtave të të tjerëve” dhe garantimi i “autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit”) dhe se ndërhyrja mund të konsiderohej si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” sipas kuptimit të nenit 10 § 2.

Gjykata vuri në dukje se objekti i dënimit të kërkueses konsistonte në thelb në deklaratat e saj për shtyp në lidhje me veprimet e pretenduara të një magjistrati për të favorizuar vajzën e tij në kontekstin e një konkursi publik. Kërkuesi nuk e kurseu mundësinë e dyshimit për vërtetësinë e informacionit dhe në këtë mënyrë kontribuoi në paraqitjen para opinionit publik të një thashethemi që më vonë doli të ishte i pabazuar.

Gjykata vuri në dukje se nëse balancimi i të drejtës për respektimin e jetës private dhe të drejtës për lirinë e shprehjes nga autoritetet kombëtare është kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, duhet të ekzistojnë arsye serioze që Gjykata të zëvendësojë mendimin e saj me atë të gjykatave vendase. Sipas mendimit të Gjykatës, nuk kishte arsye të tilla në rastin konkret.

Gjykata u shpreh se arsyet e dhëna nga Divizioni Disiplinor për të justifikuar sanksionin ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Gjithashtu, sanksioni ishte më i ulëti nga ata të parashikuar në legjislacionin e brendshëm, përkatësisht një paralajmërim, i cili për rrjedhojë nuk mund të konsiderohej si joproporcional. Gjykata gjithashtu vërejti se çështja në fjalë ndryshonte nga çështja Koudechkina kundër Ruisë, në të cilën kishte gjetur shkelje të nenit 10. Ndryshe nga kërkuësja, znj. Koudechkina ishte penalizuar për kritika të përgjithshme për funksionimin e gjykatave të Moskës

dhe sistemin gjyqësor gjatë fushatës së saj zgjedhore. Akuzat që ajo kishte bërë kundër individëve të identifikueshëm (në veçanti, kryetarit të gjykatës së Moskës) bazoheshin në përvojën e saj të drejtpërdrejtë dhe ishin konfirmuar pjesërisht nga disa dëshmitarë. Gjithashtu, sanksioni i vendosur ndaj znj. Koudechkina rezultoi në humbjen e pozicionit të saj dhe çdo mundësi për të shërbyer si gjyqtare.

5. Brisc kundër Rumanisë, 26238/10, 11 dhjetor 2018 (shkelje)

Fjalimi i kërkuesit

Në kohën përkatëse, kërkuesja ishte kryeprokurore dhe punonjëse prokurorie e ngarkuar me ofrimin e informacionit për mediat në lidhje me procedimet penale. Në lidhje me një operacion në flagrancë në lidhje me një hetim penal për shitje ndikimi, kërkuesja lëshoi një deklaratë për shtyp, ku thuhet si më poshtë:

“Pasi u njoftova nga policia se V. F., kërkon dhe merr para nga individë në këmbim të ndërhyrjes në favor të lirimit me kusht të të paraburgosurve të mbajtur në burgun Baia Mare, prokuroria ... organizoi një operacion në flagrancë më 21 tetor 2009.

V. F., u kap në flagrancë duke pranuar shumë prej 1650 euro nga një i afërm i të arrestuarit... U hap një hetim penal për shitje ndikimi dhe sipas konstatimeve fillestare të çështjes, u konstatua se i dyshuari kishte marrë euro. 9,850 nga 11,000 euro që ajo kishte kërkuar për të ndërhyrë për të ndikuar pozitivisht në lirimin me kusht të atij të paraburgosuri ose në ndarjen e vendeve të punës së tij.

Sipas të arrestuarit, i dyshuari ka pretenduar se përfituesit e parave kanë qenë punonjës të burgut me përgjegjësi për ndarjen e punës të të paraburgosurve ose anëtarëve të komisionit për lirim me kusht. Për më tepër, i dyshuari i tha të arrestuarit se një pjesë e parave do t'i shkonin magistratëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjegjës për lirimin me kusht të të arrestuarve.

Si objekt i veprës penale shitje ndikimi ishte një shumë parash mbi 10,000 Euro, dosja i kaloi Departamentit Kombëtar Antikorrupsion.”

Kërkuesja dha gjithashtu një deklaratë të shkurtër për një kanal televiziv lokal duke dhënë kryesisht të njëjtin informacion siç përmbahej në njoftimin për shtyp.

Sanksionet dhe motivet e dhëna

Gjyqtari G. E., paraqiti një ankesë kundër kërkueses, duke argumentuar se në atë kohë ajo kishte qenë gjyqtare e deleguar në burgun Baia Mare dhe për shkak të njoftimit për shtyp dhe intervistës së kërkueses, media sugjeroi se ajo mund të ishte marrësja e supozuar e parave. Komisioni disiplinor i prokurorëve filloi një hetim kundër kërkueses në lidhje me dy shkelje disiplinore: (i) mosrespektimin e fshehtësisë së diskutimeve ose konfidencialitetit të dokumenteve që janë të natyrës sekrete dhe (ii) marrjen e një qëndrimi mosrespektues ndaj kolegëve në ushtrimin e detyrave të veta. Komisioni disiplinor e shpalli kërkuesen fajtoreshë për këto dy vepra dhe i vendosi sanksion disiplinor në formë qortimi. Ai gjithashtu konstatoi se kërkuesja ka shkelur një dispozitë në lidhje me kufizimin e aksesit të qytetarëve në informacion në lidhje me procedimet penale në fazën e hetimit. Arsyet e deklaruara nga komisioni: gjatë dhënies së informacionit

për marrësin e pretenduar të parave nga V. F., kërkuesja nuk ka kontrolluar saktësinë e deklaratave të të arrestuarit dhe ky informacion ka çuar në identifikimin e gjyqtarit G. E., si një nga përfituesit e supozuar të parave.

Në ditën kur vendimi mori formë të prerë, komisioni disiplinor i prokurorëve e largoi kërkuesen nga posti i kryeprokurores. Sipas ligjit vendas, shkarkimi i prokurorit/magjistratit nga pozicioni drejtues pas vendosjes së sanksionit disiplinor ishte i detyrueshëm.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10, duke u shprehur se gjykatat vendase nuk dhanë arsye “relevante dhe të mjaftueshme” për të treguar se ndërhyrja, për të cilën pati ankesë, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e autoritetit të gjyqësorit dhe mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve. Ai ka dhënë informacione për mediat në kuadër të kryerjes së detyrës së tij profesionale si punonjës i caktuar në këtë drejtim, detyrë që ai e kishte në pesë vitet e fundit. Tema e deklaratës për shtyp ishte një çështje me interes publik.

Deklaratat e kundërshtuara nuk cenojnë sekretin e hetimit penal. Kërkuesi vazhdoi me kujdes, duke u përmbajtur nga identifikimi me emër i ndonjë prej individëve të përfshirë në pritje të përfundimit të hetimit gjyqësor. Kërkuesi nuk mbajti asnjë qëndrim në lidhje me fajësinë e asnjërit prej personave të përfshirë, por thjesht dha një përshkrim të përmbledhur të çështjes së prokurorisë në fazën fillestare. Për më tepër, kërkuesi nuk përdori apo citoi asnjë dokument të mbrojtur nga sekretin e një hetimi gjyqësor. Informacioni për operacionin nuk ishte më konfidencial pasi dy gazetarë të pranishëm në incident kishin publikuar shkrime të shoqëruara me fotografi të bëra me atë rast.

Për sa i përket ndikimit të pretenduar në reputacionin profesional

të gjyqtarit G. E., Gjykata nuk ishte e bindur se njoftimi për shtyp dhe intervista mund të konsideroheshin si një sulm që arrinte pragun e nevojshëm të seriozitetit dhe që mund të shkaktonte cenim ndaj reputacionit profesional të G. E., Autoritetet vendase nuk i kushtuan rëndësi faktit që deklaratat nuk vinin nga kërkuesi, por u identifikuan qartë se ishin bërë nga një palë tjetër (the media). Gjykata u shpreh se nuk kishte prova që autoritetet vendase kryen një ushtrim balancimi midis nevojës për të mbrojtur reputacionin e gjyqtarit G. E., dhe të drejtës së kërkuesit për të dhënë informacion për çështje me interes të përgjithshëm në lidhje me hetimet penale në proces. Ata e kufizuan analizën e tyre në një diskutim të thjeshtë të dëmtimit të reputacionit të paditësit pa iu përgjigjur pikës së kërkuesit se deklaratat e kundërshtuara ishin bërë nga një palë e tretë dhe pa marrë parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

6. Žurek kundër Polonisë, 39650/18, 16 qershor 2022 (shkelje)

Fjalimi i kërkuesit

Kërkuesi ishte gjyqtar në Gjykatën Rajonale të Krakovës, zëdhënës i asaj gjykate, anëtar gjyqësor i Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (NCJ), organi kushtetues i ngarkuar me ruajtjen e pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, si dhe zëdhënës i NCJ-së që nga viti 2014. Në cilësinë e kësaj të fundit, ai ishte një nga kritikët kryesorë të ndryshimeve në gjyqësor të iniciuara nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i qeverisë së re të zgjedhur në vitin 2015. Ai komentoi publikisht në forume të ndryshme propozimet legislative të qeverisë në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, NCJ-në, Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e zakonshme. Ai vuri në dukje kërcënimet ndaj shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së gjyqësorit që rrjedhin nga propozimet e Qeverisë.

Ai dha intervista për gazeta dhe portale të ndryshme; botoi një

artikull në një portal interneti me titull “Kjo është për marrjen e Gjykatës së Lartë?”; prezantoi opinionet e NCJ-së në kanalën e saj zyrtar në YouTube dhe u shfaq në kanalën e lajmeve televizive. Disa fragmente të deklaratave të aplikantit në këto forume mund të gjenden më poshtë:

“Gjyqtarët duhet të emërohen në NCJ dhe jo të zgjidhen [nga kolegët e tyre] si aktualisht. Ne do ta kontestojmë këtë projekt. ...”

“...Për fat të keq, [projekt-amendamenti i Qeverisë në Aktin e NCJ-së] përmban disa zgjidhje të cilat janë të papajtueshme me Kushtetutën. ... Nuk mund të përgatisni një reformë të madhe pa e diskutuar me gjyqtarët e gjykatave më të larta ... Ekipi ministror po e bën të gjithë këtë pa asnjë konsultim me NCJ-në, duke harruar se anëtarët gjyqësorë në Këshillin aktual u zgjodhën nga një shumicë dërrmuese e delegatëve nga të gjitha gjykatat ...”

“Autoritetet po përdorin problemet e gjyqësorit si pretekst për të çmontuar sistemin e drejtësisë ...”

“Dëshiroj t’ju tregoj disa të meta themelore të projektligjeve [për drejtësinë], të cilat sipas NCJ-së janë në kundërshtim me Kushtetutën ... Ministri kërkon gjithashtu t’u shuajë mandatin anëtarëve gjyqësorë të NCJ-së. Pavarësisht se Kushtetuta flet për një mandat katërvjeçar, ministri dëshiron ta bëjë këtë me një ligj të zakonshëm, pra qartësisht [do të ketë] shkelje të drejtpërdrejtë të Kushtetutës ...”

“Ne jemi vetëm në pragun e shkatërrimit të shtetit ligjor dhe ndarjes së pushteteve ... Mund të më pushojnë nga puna, por nuk do ta thyej betimin si gjyqtar ...”

“Nuk dua të përdor fjalën “reformë”, sepse për mendimin

tim është një dekonstruksion i sistemit juridik. Do të çojë në politizimin e gjykatave, në marrjen e plotë të gjykatave nga politika. Nuk kemi pasur ende një situatë të tillë që kur rifituum pavarësinë.”

Sanksionet dhe motivet e dhëna

- a) Në vitin 2016 Byroja Qendrore Kundër Korrupsionit (CBA) carried out an audit of the applicant’s financial declarations) kreu një auditim të deklaratave financiare të kërkuarit, i cili kishte të bënte me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaratave të tij financiare të bëra në vitet 2012-2017. CBA-ja e shtriu auditimin e saj edhe tek gruaja e kërkuarit dhe shërbimi i prokurorisë mori në pyetje prindërit e kërkuarit. Për më tepër, në disa raste kërkuari u thirr në CBA për të dhënë shpjegime. CBA-ja nuk i dha asnjëherë kërkuarit informacion (përveç referimit ndaj “aktiviteteve rutinë” të CBA-së) të kërkuara prej tij për arsyet e auditimit dhe kohëzgjatjen e tij. CBA-ja përgatiti një raport auditimi dhe ia dërgoi prokurorisë. Kërkuari nuk u informua kurrë për ndonjë hetim nga ndonjë prokuror për çështjet e tij financiare ose tatimore.
- b) Pas një kërkesë të paraqitur në një letër anonime për parregullsi në kryerjen e detyrave gjyqësore nga kërkuari në vitin 2017, Ministria e Drejtësisë urdhëroi inspektimin e punës gjyqësore të kërkuarit në Gjykatën Rajonale (dëshironte të informohej nëse kërkuari kishte vendosur për çështjet në përputhje me programin e përcaktuar dhe nëse kishte pasur ankesa për efikasitetin e procedimeve në çështjet e tij. Gjithashtu kërkoi informacion statistikor për numrin e seancave të zhvilluara nga kërkuari dhe numrin e çështjeve të caktuara dhe të përfunduara prej tij kundrejt mesatares në divizionin e tij).
- c) Pas emërimit të një Kryetari të ri të Gjykatës Rajonale të Krakovës nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2018, kërkuari

u shkarkua nga posti i tij i zëdhënësit të Gjykatës Rajonale të Krakovës nga kryetari pas supozimit se kishte marrë një opinion të favorshëm nga Bordi i asaj Gjykate (gjashhtë nga tetë anëtarë të Bordit më vonë shpjeguan se kjo çështje nuk ishte hedhur në votim dhe as që kishte qenë në axhendën e mbledhjes së Bordit).

- d) Kërkuesi i kërkoi Kryetarit të Gjykatës së Apelit t'i jepte deklaratës së tij financiare, e cila është e disponueshme publikisht në internet, status konfidencial për shkak të shqetësimeve të tij për sigurinë e tij dhe të familjes së tij për shkak të kërcënimeve të marra me email dhe telefon. Megjithëse Kryetari e pranoi këtë kërkesë, Ministria e Drejtësisë e ktheu atë vendim pa dhënë asnjë arsye (deklasifikimi i deklaratës financiare të kërkuesit).

Në vitin 2018, mandati i kërkuesit si anëtar i NCJ-së u ndërpre para kohe ex lege pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri në kontekstin e reformës në shkallë të gjerë në gjyqësor në Poloni (veçanërisht amendamenti që i jep Sejm-it (Dhoma më e ulët e Parlamentit polak) kompetencën për të zgjedhur anëtarët gjyqësorë të NCJ-së). Si rezultat i kësaj mase, kërkuesi pushoi së vepruari si zëdhënës i NCJ-së. (Shënim: Masat në këtë paragraf u trajtuan sipas nenit 6.)

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10. Duke pasur parasysh grumbullimin e masave të marra kundër kërkuesit—duke përfshirë (i) auditimin e deklaratave të tij financiare; (ii) inspektimin e punës së tij gjyqësore; (iii) shkarkimin e tij nga posti i tij si zëdhënës i Gjykatës Rajonale të Krakovës; dhe (iv) deklasifikimin e deklaratës financiare të kërkuesit, –Gjykata deklaroi se ato mund të karakterizoheshin si një strategji që synon frikësimin (ose edhe heshtjen) e kërkuesit në lidhje me pikëpamjet që ai kishte shprehur në mbrojtje të shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e gjyqësorit.

Gjykata konstatoi se ndërhyrja e kundërshtuar ishte nxitur nga pikëpamjet dhe kritikak që kërkuesi kishte shprehur publikisht në ushtrimin e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Gjykata i kushtoi një rëndësi të veçantë detyrës së kërkuesit, funksionet dhe detyrat e të cilit përfshinin shprehjen e pikëpamjeve të tij mbi reformat legjislativë, të cilat do të kishin ndikim në gjyqësor dhe pavarësinë e tij.

Gjykata e dalloi çështjen në fjalë nga rastet e tjera, pasi çështja në fjalë kishte të bënte me besimin e publikut në gjyqësor dhe nevojën për të mbrojtur një besim të tillë kundër sulmeve shkatërruese (shiko *Di Giovanni kundër Italisë*, § 81, dhe *Kudeshkina kundër Ruisë*, § 86). Pikëpamjet dhe deklaratat e shprehura publikisht nga kërkuesi nuk përmbanin asnjë sulm kundër anëtarëve të tjerë të gjyqësorit (krahasoni *Di Giovanni*); as nuk kishin të bënin me kritikak në lidhje me sjelljen e gjyqësorit që merret me proceset (shikoni *Kudeshkina kundër Ruisë*, § 94).

Përkundrazi, Gjykata deklaroi se kërkuesi shprehu pikëpamjet dhe kritikak e tij për reformat legjislativë në lidhje me funksionimin e sistemit gjyqësor, statusin e NCJ-së dhe pavarësinë dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve, të cilat janë të gjitha çështje me interes publik (Shikoni *Baka*, § 171). Deklaratat e tij nuk shkuan përtej kritikave të thjeshta nga një këndvështrim strikt profesional. Prandaj, Gjykata vlerësoi se pozicioni dhe deklaratat e kërkuesit, të cilat qartazi binin në kontekstin e një debati për çështje me interes të madh publik, kërkonin një shkallë të lartë mbrojtjeje për lirinë e tij të shprehjes dhe një shqyrtim të rreptë të çdo ndërhyrjeje, me një kufi të ngushtë vlerësimi që u jepet autoriteteve të shtetit të paditur.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E MAGJISTRATËVE NË LIDHJE ME PAVARËSINË E TYRE



Vitor Manuel Ribeiro

Inspektor Gjyqësor,

Këshilli i Lartë i Magjistraturës, Portugali

Z. Vitor Manuel Ribeiro ka lindur më 14.11.1966, në Oporto, Portugali. Z. Ribeiro është diplomuar për drejtësi në korrik të vitit 1990, si dhe gjatë periudhës kohore shtator 1990 - korrik 1991 ka kryer trajnimin në fushën e Drejtësisë ofruar nga Shoqata Portugeze e Avokatëve. Gjatë periudhës kohore maj-shtator të vitit 1992 ka ushtruar detyrën e Inspektorit të Policisë Gjyqësore Ushtarake, si dhe në muajin shtator 1992 është pranuar në Qendrën për Studimet Gjyqësore.

Gjatë periudhës kohore shtator 1993 - gusht 1994, z. Ribeiro ka mbajtur pozicionin e Audituesit të Drejtësisë dhe gjatë periudhës shtator 1994 deri në maj 1995 si Gjyqtar Praktikant. Për periudhën maj 1995 - gusht 2012 z. Ribeiro ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në disa gjykata rrethesh në të gjithë vendin, si dhe gjatë periudhës shtator 2012-maj 2015 ka mbajtur pozicionin e Nënkyetarit të Këshillit të Përmbaruesve. Nga muaji shtator 2016 ka mbajtur pozicionin e Zëvendës Gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Lisbonës, si dhe atë të gjyqtarit nga muaji Shtator 2017. Nga muaji shtator 2015

e në vazhdim ushtron detyrën e Inspektorit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

A. Përgjegjësia disiplinore e magistratëve në lidhje me pavarësinë e tyre

A.1. Pavarësia e gjykatave dhe pavarësia e gjyqtarëve.

Në përputhje me parashikimet e nenit 203 të Kushtetutës së Republikës së Portugalisë, gjykatat të cilat janë organet sovrane të autorizuara për të administruar drejtësinë në emër të popullit, janë të pavarura dhe i nënshtrohen vetëm ligjit. Pavarësia e gjykatave nënkupton edhe pavarësinë e zyrtarëve të organeve të tilla, përkatësisht të gjyqtarëve.

Pavarësia e gjyqtarëve manifestohet në rolin e gjyqtarit. Pra, gjyqtarët gjykojnë vetëm në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin dhe nuk u nënshtrohen urdhrave apo udhëzimeve, me përjashtim të detyrimit të gjykatave më të ulëta për të zbatuar vendimet e dhëna nga gjykata e apelit apo gjykatat më të larta.

A.2. Garancitë e pavarësisë së gjyqtarëve.

A.2.1. Mungesa e përgjegjësisë së gjyqtarëve për vendimet e tyre.

Për të garantuar pavarësinë e gjyqtarëve, neni 216, paragrafi 2, i Kushtetutës të Republikës së Portugalisë, parashikon mungesën e përgjegjësisë së gjyqtarëve, duke përcaktuar se gjyqtarët nuk mund të jenë përgjegjës për vendimet e tyre. Kjo mungesë përgjegjësie do të thotë se mënyra e vetme për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është me ankim në një gjykatë më të lartë dhe jo me ndonjë mjet tjetër, përkatësisht disiplinor.

Parimi i mungesës së përgjegjësisë qëndron në themel të idesë se një gjyqtar nuk mund të ushtrojë funksionimin e tij/saj duke shpresuar se do të favorizohet apo ndëshkohet lidhur me vendimarrjen e tij/saj.

A.2.2. Mungesa e përgjegjësisë disiplinore në lidhje me interpretimin e ligjit, si dhe vlerësimin e fakteve dhe provave.

Pavarësia në interpretimin e ligjit, si dhe në vlerësimin e fakteve dhe provave janë tregues kryesor të parimit të pavarësisë së gjyqtarëve. Për këtë arsye, për veprime të tilla, të cilat përbëjnë thelbin e veprimtarisë së funksionit gjyqësor, përjashtohet mundësia e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit. Megjithatë, veprimtaria që kryen gjyqtari përgjatë ushtrimit të funksionit të tij, kryhet brenda disa rregullave dhe kufijve.

A.2.3. Kufijtë e mungesës së përgjegjësisë disiplinore gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore, mosrespektimi i parimeve themelore dhe mosushtrimi i detyrave funksionale.

Funksionet gjyqësore, duhet të ushtrohen në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe paanshmërisë, si dhe në përmbushje të plotë të detyrave funksionale të gjyqtarit. Me tejkalimin e këtyre kufijve, veprimtaria e gjyqtarit nuk konsiderohet si ushtrim i drejtë i funksionit të gjyqtarit në kuadër të pavarësisë që atij/asaj i garantohet dhe për rrjedhojë, veprimtaria gjyqësore mund të jetë objekt hetimi dhe gjyqtari subjekt i përgjegjësisë disiplinore.

Kjo rezulton nga pjesa e parë e nenit 82 të Statutit të Magjistratëve Gjyqësorë, ku parashikohet shprehimisht se: *“Veprimet e kryera me faj nga magjistratët në kundërshtim me parimet dhe detyrat e parashikuara në këtë Statut, përbëjnë shkelje disiplinore”*. Në këto kushte, gjyqtari mund të mbajë përgjegjësi disiplinore në lidhje me një vendim që ka marrë, i cili nuk mund të merrej, për asnjë arsye ose i pabazuar në çdo aspekt.

Në këto kushte, veprimet dhe aktet e gjyqtarit në vend që të

përbëjnë ushtrimin e funksioneve të gjykimit, përbëjnë në vetvete shkelje të parimit të ligshmërisë, pasi vendimi nuk është bazuar në një vlerësim objektiv të fakteve dhe në një interpretim korrekt dhe të paanshëm të ligjit, si dhe është marrë në të njëjtën kohë në kushtet e mungesës së kujdesit të duhur dhe të cilësisë që duhet të karakterizojë veprimtarinë e gjyqtarit.

B. Hetimi dhe procedura disiplinore e magistratëve në përputhje me garancitë e një procesi të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

B.1. Zbatimi i nenit 6 (1) të KEDNJ-së në procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, parashikon shprehimisht se: *“1. Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj”.*

Objekti i nenit 6 (1) të Konventës është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve civile ose një akuze penale. Duke qenë se procedimet disiplinore, veçanërisht ato kundër gjyqtarëve, janë në thelb gjykime të natyrës administrative dhe shkelja e pretenduar në këto çështje është e natyrës administrative, pasi lidhet me shkeljen e detyrimeve të karakterit profesional, është e rëndësishme të diskutohet nëse në këto raste neni 6 i KEDNJ-së është ose jo i zbatueshëm.

Në lidhje me procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka arritur në përfundimin për sa është e qartë edhe nga praktika e saj gjyqësore (*Oleksandr Volkov kundër Ukrainës; Kamenos kundër Qipros; Ramos Nunes de*

Carvalho e Sá kundër Portugalisë), se këto procedura janë brenda aspektit civil të nenit 6 (1) të Konventës. Në të kundërt, Gjykata Evropiane u shpreh se nuk zbatohet aspekti penal i nenit 6 (shikoni Xhoxhaj kundër Shqipërisë).

B.2. Modeli i procedurës disiplinore të parashikuar në Statutin e Magjistratëve Gjyqësorë.

Sipas Statutit të Magjistratëve Gjyqësorë, procedimi disiplinor i magjistratëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë si më poshtë:

Procedura përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor nga momenti i paraqitjes së kërkesës dhe në vazhdim kryhet në përputhje me parimin e kontradiktorialitetit. Gjyqtari në fjalë ka të drejtë të dëgjohet; ai ose ajo mund të përfaqësohet nga një avokat dhe mund të konsultohet me kërkesën për procedim dhe të paraqesë argumente në lidhje me këtë. Ai ose ajo gjithashtu ka të drejtë të marrë pjesë në procedurë duke kundërshtuar akuzat, duke paraqitur kërkesa, duke paraqitur prova dhe duke pretenduar mbi pavlefshëminë e akteve. Gjithashtu, vendimi përfundimtar duhet të jetë i arsyetuar. Organi hetimor që ka kryer hetimin nuk merr pjesë në vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor (JHC). Gjithashtu, vendimet e JHC-së janë objekt ankimi në Gjykatën e Lartë.

B.3. Zhvillimi i procedurës disiplinore në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

Le të shqyrtojmë tani nëse mënyra e zhvillimit të procedurës disiplinore është në përputhje me të drejtën e aksesit në gjykatë, të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme dhe të drejtën për një seancë dëgjimore publike, të gjitha këto të parashikuara në nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

B.4. E drejta e aksesit në gjykatë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi disiplinor i gjyqtarëve. Këshilli i Lartë Gjyqësor është organ administrativ. Nuk është organ gjyqësor. Në lidhje me këtë, jurisprudenca e vendosur e GJEDNJ-së përcakton se, nuk mund të konstatohet shkelje e Konventës sipas kërkesave të nenit 6 (1) të saj, kur një organ administrativ ka vendosur për “të drejtat dhe detyrimet civile” dhe procedurat përpara atij organi i nënshtrohen “kontrollit të mëvonshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë dhe siguron garancitë e nenit 6 (1)” (shikoni *Albert and Le Compte v Belgium*; kundër Mbretërisë së Bashkuar).

Në procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve portugezë, ekziston mundësia e ankimimit të vendimeve të JHC-së në Seksionin Gjyqësor të Gjykatës së Lartë. Kështu, garantohet e drejta e aksesit në gjykatë.

B.5. E drejta për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Në çështjen *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane, duke marrë në konsideratë garancitë që ekzistojnë lidhur me mbrojtjen e veprimtarisë së Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë nga presionet e jashtme, ka konsideruar se sistemi në fuqi në Portugali për rishikimin e vendimeve disiplinore të JHC-së nuk ka shkelur kërkesën e pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 (1) të Konventës.

B.6. E drejta për një dëgjuesë (seancë) publike.

E drejta për një “dëgjuesë publike” në nenin 6(1) nënkupton domosdoshmërisht një të drejtë për “për të marrë pjesë” një të drejtë për “t`u shprehur verbalisht dhe dëgjuar” (shikoni *Döry kundër*

Suedisë, §37). E drejta për një seancë dëgjimore verbale është një faktor për të siguruar barazinë e përgjithshme të armëve ndërmjet palëve në një proces (*shikoni Margaretić kundër Kroacisë*).

Në procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve portugezë, përpara ndryshimeve të bëra në Statutin e Magjistratëve Gjyqësorë me ligjin 67/2019, datë 27.08, procedimet para seancës plenare të JHC-së ishin me shkrim dhe gjyqtari nuk mund të merrte pjesë në seancat e tij; sipas legjislacionit kombëtar, ato seanca nuk ishin të hapura as për gjyqtarin e parashikuar dhe as për publikun. JHC-ja nuk ishte e detyruar me ligj të zhvillonte seanca dëgjimore publike.

Lidhur me procedurat para organit gjyqësor - Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë - personi i përfshirë në procedurë kishte të drejtë dhe ende ka, që të kërkojë një seancë dëgjimore publike. Ndonëse Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë nuk ka juridiksion për të rishqyrtuar faktet dhe provat, mbajtja e një seance dëgjimore publike para Divizionit Gjyqësor nuk është një praktikë e zakonshme dhe, kur kërkohet, shpesh refuzohet sepse konsiderohet e pakuptimtë.

Pra, deri në ndryshimet e mësipërme të Statutit të Magjistratëve Gjyqësorë me ligjin 67/2019, datë 27.08, nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore as pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe, për arsyet e sipërpërmendura, as para Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë.

Duke pasur parasysh atë që është në rrezik, domethënë ndikimin e dënimeve të mundshme në jetën dhe karrierën e personave në fjalë dhe pasojat e tyre financiare, Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane ka shqyrtuar, në çështjen *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, se, në kontekstin e procedimeve disiplinore, mosmbajtja e një seance dëgjimore duhet të jetë një masë e jashtëzakonshme dhe duhet të justifikohet siç duhet sipas praktikës gjyqësore të institucioneve të Konventës.

Rrjedhimisht, Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane ka arritur në përfundimin, në çështjen e sipërpërmendur, se mungesa e një seance dëgjimore qoftë në fazën e procedimit disiplinor, qoftë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, nënkuptonte se çështja nuk ishte dëgjuar në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të Konventës.

Me ligjin 67/2019, datë 27 gusht, u parashikua një nen i ri në Statutin e Magjistratëve Gjyqësorë. Neni 120-A, i cili parashikon shprehimisht se gjyqtari, ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor, mund të kërkojë mbajtjen e një seance publike për të paraqitur mbrojtjen e tij. Kështu, shkelja e nenit 6(1) të Konventës e zbuluar nga Gjykata Evropiane është korrigjuar.

HETIMI DHE PROCEDIMI DISIPLINOR I MAGJISTRATËVE NË PËRPUTHJE ME GARANCITË PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR SIPAS KËRKESAVE TË NENIT 6/1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (KEDNJ)



Béatrice Del Volgo,

*Inspektore e Përgjithshme, Inspektorati i
Përgjithshëm i Francës*

Znj. Béatrice Del Volgo ka hyrë në sistemin e drejtësisë nëpërmjet një provimi-konkursi pas diplomimit në nivelin master për të drejtën private. Në fillim ka punuar si gjyqtare për seancat paraprake në Korsikë dhe Marsejë, ku është specializuar në krimin e organizuar dhe më pas në çështjet ekonomike dhe financiare.

Znj. Del Volgo ka vijuar të punojë në të njëjtën fushë si këshilltare në Gjykatën e Apelit të Aix en Provence në Dhomën Korrektuese të specializuar në çështjet ekonomike dhe financiare, si dhe më pas për disa vite ka ushtruar profesionin pranë organit të prokurorisë, ku është përqendruar kryesisht në çështjet e të miturëve.

Znj. Del Volgo ka punuar si Inspektore në Inspektoratin e Përgjithshëm të Shërbimeve Gjyqësore dhe më vonë Inspektore e Përgjithshme në Inspektoratin e Përgjithshëm të Drejtësisë.

Aktualisht drejton Departamentin e Etikës dhe Inspektimeve Administrative.

Abstrakti i prezantimit

Si shtyllë e demokracisë, Drejtësia mishërohet nga magjistrati; vendi i tij në shoqëri është thelbësor. Për të përmbushur misionin e tyre, magjistratët duhet të jenë shembullorë në kryerjen e detyrave të tyre. Nëse ata kanë të drejtë për një jetë private, kjo nuk duhet të ndikojë në besimin e dhënë ndaj tyre; e njëjta gjë vlen edhe për veprimet tjera të tyre.

Magjistrati i dyshuar për mosrespektim të parimeve themelore të etikës duhet të paraqesë shpjegimet e tij përpara institucioneve përgjegjëse. Në ushtrimin e të drejtave të tyre, institucionet disiplinore të ngarkuara për hetimin dhe gjykimin mbi kryerjen e shkeljeve disiplinore nga ana e magjistratit duhet të krijohen, organizohen, si dhe funksionojnë në bazë të ligjit. Në të njëjtën kohë, duhet të respektojnë edhe të drejtën e mbrojtjes për magjistratin.

Ata, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, duhet të veprojnë plotësisht në mënyrë të pavarur, në mënyrë që të mos krijohet një dyshim se kanë kontribuar në shkarkimin e magjistratëve për arsye të pabaza, për shembull në lidhje me vendimet që ata kanë marrë ose që mund t'u kërkohet të marrin.

Në praktikë, janë personat përgjegjës për kryerjen e hetimeve disiplinore, etika e tyre, metodologjia dhe mekanizmat e kontrollit të vendosura nga institucioni i tyre që pasqyrojnë mënyrën e trajtimit të çdo rasti.

Në aspekt të zhvillimit të procedimit disiplinor, duhet të shtrohet për diskutim gjithashtu çështja e kohës së trajtimit të rastit, burimeve materiale dhe njerëzore, si dhe marrëdhënieve ndërmjet organit që kryen hetimin disiplinor dhe organit, i cili vendos për kryerjen e shkeljes disiplinore.

Krijimi i një ekulibri të drejtë ndërmjet realizimit të një hetimi disiplinor të besueshëm në raport me shkeljet disiplinore, të cilat mund të jenë kryer nga ana e magjistratit dhe garancive të cilat i sigurohen atij gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor sjell si pasojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Shembulli francez me metodologjinë e zhvilluar ndër vite nga Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë, procedura disiplinore pranë Këshillit të Lartë të Gjyqësorit të përcaktuar nga ligji organik që lidhet me statusin e gjyqësorit dhe kontrollin e ushtruar nga Këshilli i Shtetit, është një ilustrim i këtij procesi të vazhdueshëm për vendosjen e këtij ekuilibri.

Hyrje

Neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikon se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet në mënyrë të rregullt, publike dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Vendimi duhet të jepet publikisht, por qasja në sallën e gjyqit mund të ndalohet për shtypin dhe publikun.

Nëse në sistemin francez gjykimi i magjistratit para Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (CSM) dhe Këshillit të Shtetit (CE) rregullohet rreptësisht nga ligji që plotëson kushtet e një procesi të rregullt, procedura e hetimit paraprak që i besohet Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë (IGJ) rregullohet në pjesën më të madhe, jo nga një korpus legjislativ, por nga një praktikë e përcaktuar në përputhje me të drejtën disiplinore. Kjo praktikë ka evoluar gjerësisht për t'iu përgjigjur kërkesave të një procesi të rregullt ligjor.

1. NJË PROCES HETIMOR QË SIGURON PAVARËSINË DHE PAANSHMËRINË E TIJ

Në shumicën e rasteve, procedimi i filluar kundër një magjistrati bazohet në hetimin administrativ të kryer nga IGJ. Për këtë arsye, është e rëndësishme që ky hetim administrativ që i është besuar Ministrit të Drejtësisë të respektojë parimet themelore të një procesi të rregullt: paanshmërinë, pavarësinë, të drejtën e mbrojtjes.

Vetëm magjistratët e inspektoratit janë të autorizuar për të kryer një hetim administrativ në lidhje me një magjistrat. Ashtu si kreu i IGJ-së, ata emërohen pas një miratimi paraprak të CSM.

IGJ-ja, nuk është një drejtori pjesë përbërëse e Ministrisë së Drejtësisë, por ka një status më vetë^[10]: ai është i vendosur pranë Ministrit të Drejtësisë. Ky status i veçantë u lejon inspektorëve të përgjithshëm dhe inspektorëve të ngarkuar për të kryer hetime administrative të sigurojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

1.1 Inspektorët i nënshtrohen rregullave deontologjike

Kompetentë për të gjykuar kolegët e tyre, inspektorët duhet të zbatojnë rregullat deontologjike të përcaktuara në aktin ligjor, i cili rregullon veprimtarinë e inspektoratit, ndër të cilat, në radhë të parë, renditen pavarësia dhe paanshmëria.^[11] Këto rregulla marrin formë çdo ditë, në korrespondencën, përcaktimin e strategjisë së hetimit, komunikimin me gojë dhe me shkrim dhe natyrisht në analizën e situatës dhe rastit që kanë në trajtim.

Respektimi i këtyre detyrimeve është një vlerë e rëndësishme, sepse ngjall besim në atë moment dhe në vazhdimësi, si dhe i jep një autoritet dhe reputacion procesit të inspektimit. Për t'i bërë të

10 Neni 1 i Dekretit të datës 5 dhjetor 2016 për krijimin e IGJ-së.

11 Si dhe integriteti, konfidencialiteti dhe diskrecioni profesional, drejtësia, besnikëria, maturia dhe mirësjellja, kritere këto të parashikuara dhe në statutin e RESJ për anëtarët e tij.

zbatueshme këto kërkesa të nivelit të lartë, çdo inspektorat duhet të përcaktojë njëkohësisht parimet e tij metodologjike, t'i zbatojë ato dhe të nxjerrë përfundimet e nevojshme.

1.2 Një linjë metodologjike e përcaktuar paraprakisht.

Metodologjia e përcaktuar nga IGJ francez^[12] është në formën e një udhëzuesi praktik për përdorim nga inspektorët. Ky dokument në formë të shkruar shërben si një udhërrëfyes (mjet pedagogjik) dhe një kujtesë për detyrimet e përcaktuara në të gjitha fazat e hetimit. Ky dokument përditësohet rregullisht në kuadër të zhvillimit jurisprudencës, praktikës dhe marrëdhënieve me sindikatat e magjistratëve.

Publikimi i udhëzimeve dhe garancive që u jepen magjistratëve^[13] kontribuon në transparencën e metodologjisë dhe ndihmon në zbatimin e saj.

Ky publikim i metodologjisë siguron trajtim të barabartë të magjistratëve objekt të një hetimi.

1.3 Mjetet e kërkimit të provave dhe administrimi i tyre.

Kryerja e hetimit administrativ kërkon njohuri (know-how) dhe përvojë.

Ai konsiston gjithmonë në marrjen në pyetje dhe dëgjimin e eprorëve sipas shkallës së hierarkisë, të kolegëve të punës, të punonjësve të sekretarisë dhe më së shpeshti të personave të cilët janë të përfshirë. Ky proces shpesh ngjall shqetësim te personi, i cili merret në pyetje, gjë që kërkon krijimin e besimit dhe një aftësi për të dëgjuar.

12 Në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Dekretit për krijimin e IGJ-së, IGJ-ja përcakton lirisht parimet e metodologjisë së veprimtarisë së tij.

13 Ky akt i publikuar është i disponueshëm në faqen e internetit të IGJ-së.

Në varësi të natyrës së akteve, të cilat duhet të provohen, dokumentimi apo regjistrimi në procesverbal i thënieve të personit të intervistuar mund kenë vlerë provuese. Konkretisht, kjo do të thotë të shënohen pyetjet e bëra dhe përgjigjet e dhëna në një dokument të nënshkruar nga inspektorët dhe personi i cili merret në pyetje. Për një siguri më të madhe, procesi i marrjes në pyetje kryhet gjithmonë nga të paktën dy persona.

Është e rëndësishme që në procesverbal të pasqyrohen me saktësi të gjitha thëniet të cilat kanë rëndësi dhe të mbahet në konsideratë që thëniet e personit i cili është marrë në pyetje dhe dëgjuar të pasqyrohen saktë dhe pa shtrembërime. Ky është një proces që përvetësohet me kalimin e kohës.

Me qëllim shfrytëzimin e të dhënave të cilat janë mbledhur nëpërmjet deklarimeve, ato duhet të analizohen dhe të krahasohen me faktet dhe të dhënat e tjera të mbledhuara nga: seancat dëgjimore, dokumentet, faktet e tjera. Edhe ky proces përvetësohet me kalimin e kohës.

Të gjitha dokumentet e dosjes inventarizohen me qëllim referimin dhe identifikimin e çdo burimi të cituar në to.

1.4 Në IGJ, një organ i kontrollit të cilësisë dhe një departament dedikuar metodologjisë së hetimit administrativ

Qëllimi i hetimit administrativ është të verifikojë ankesat e paraqitura ndaj magjistratëve, duke mbledhur provat pro dhe kundër, duke i ballafaquar ato me njëra-tjetrën, si dhe duke i analizuar në raport me veprimtarinë dhe karrierën profesionale të magjistratit, me qëllim arritjen e një përfundimi nëse jemi përpara një shkeljeje disiplinore.

Komiteti i Kolegëve të IGJ-së (*Copairs*) i krijuar që në shtator 2019 është një organ kolegjal i përbërë ekskluzivisht nga anëtarë të inspektoratit, inspektorë dhe inspektorë të përgjithshëm, të ngarkuar të kujdesen për respektimin e metodologjisë, si dhe për cilësinë dhe unifikimin e përmbajtjes së akteve të prodhuara.^[14] Në fillim të çdo procesi hetimi, komiteti shqyrton projekt-raportet e hartuara dhe i analizon ato në përputhje me dokumentet kuadër të punës. Hartuesit e projekt-raportit, anëtarë të komitetit mund të marrin në konsideratë ose jo opinionin e Copairs.

Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë funksionon gjithashtu një departament i dedikuar për etikën dhe hetimet administrative. Roli i tij konsiston veçanërisht në ofrimin e këshillave për funksionet e ndryshme të hetimit administrativ, në analizimin e raporteve dhe praktikave, në analizimin e jurisprudencës në fushën disiplinore, si dhe në përditësimin e udhëzuesve metodologjikë. Veprimtaria e këtyre dy organeve kontribuon në cilësinë e hetimeve, si dhe në respektimin e garancive që i jepen magjistratit.

2. NJË SHËRBIM INSPEKTIMI QË KA MJETET PËR TË PËRFORCUAR PAVARËSINË DHE SIGURUAR MISIONIN E TIJ

2.1 Mjetet

Në mënyrë ideale, një organ inspektimi i ngarkuar për të kryer një hetim duhet të hetojë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme, të cilat i konsideron të rëndësishme, si dhe duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

Mjetet dhe burimet e nevojshme për zhvillimin e hetimit lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësinë e hetimit. Bëhet fjalë

¹⁴ Të gjitha raportet e IGJ-së janë objekt shqyrtimi nga ana e Copairs. Vetëm anëtarët të cilët janë magjistratë kanë të drejtë për të dhënë mendimin e tyre lidhur me hetimet e zhvilluar ndaj një magjistrati.

njëkohësisht për burime financiare dhe njerëzore, të cilat janë të lidhura më njëra-tjetrën. Nëpunësit e ngarkuar për kryerjen e hetimit duhet të jenë të profilizuar dhe të jenë të jenë të mjaftueshëm në numër.

Cilësia e një hetimi varet gjithashtu edhe nga profesionalizmi apo zotësia e personave të cilët janë ngarkuar për kryerjen e tij.^[15] Kur mungon profesionalizmi, hetimi mund të vuajë si në aspektin e rezultatit të pritshëm ashtu edhe në aspektin e etikës së zbatuar, nëse është zbatuar një metodologji jo korrekte dhe e ndershme. Kjo mungesë mund të jetë veçanërisht e dëmshme kur ankesa për të cilën akuzohet magjistrati lidhet me ndershmërinë e tij. Edhe pse është i rrallë për magjistratët francezë, ky rrezik nuk duhet nënvlerësuar.

2.2 Çështja e afateve të arsyeshme

2.2.1.1 Në nivelin e hetimit

Hetimi administrativ duhet të kryhet brenda një afati të arsyeshëm. Nëse është tepër i shkurtër, ai rrezikon të jetë jo i plotë. Nëse është tepër i gjatë, ai mund të humbasë interesin, veçanërisht kur magjistrati është në fund të karrierës së tij.

Hetimet administrative të kryera nga IGJ mbyllen mesatarisht brenda katër deri tetë muajve. Ato trajtohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë kur magjistrati është pezulluar përkohësisht nga ushtrimi i detyrës.

15 Në paragrafin e fundit të nenit 16 të Dekretit për krijimin e IGJ-së parashikohet se: "Stafi i inspektimit ka kompetenca të përgjithshme hetimi, verifikimi apo kontrolli mbi gjykatat, drejtoritë, institucionet, shërbimet dhe organet e parashikuara në nenin 2. Këto subjekte janë të detyruar të japin ndihmën e tyre, si dhe të vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme, si dhe t'i bëjnë me dije pavarësisht nga mjetet në dispozicion të gjitha dokumentet, informacionet apo të dhënat e nevojshme për përbushjen e misionit të inspektimit. Stafi mund të marrë në pyetje në veçanti ose bashkë magjistratët dhe nëpunësit civil, zyrtarë publik apo punonjës në ministri, si dhe punonjës apo drejtues të personave juridik publik ose privat të përmendur në nenin 2. Stafi i inspektimit ka akses të plotë dhe të lirë në gjykata, drejtori, institucione apo organe të cilat janë objekt kontrolli nga ana e tyre." Ata nuk kanë kompetenca specifike për të kryer hetime administrative të tilla si kërkimi i informacionit për shembull nga një bankë.

Kohës së hetimit i shtohet edhe koha e vendimmarrjes, nga ana e ministrit të Drejtësisë, i cili, në bazë të raportit të inspektimit mund të vendosë t'i drejtohet apo jo CSM-së, si dhe kohës së CSM-së kur çështja i është paraqitur për shqyrtim nga ana e tij.

2.2.1.2 Në nivelin e organit disiplinor

CSM është i ngarkuar me shumë detyra, ndër të cilat, më kryesorja është ajo që ka të bëjë me emërimin e magistratëve. Ndonëse rastet e trajtimit të çështjeve disiplinore janë të pakta në numër në krahasim me tërësinë e detyrave të tjera, trajtimi i çështjeve disiplinore përbën një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së tij, për sa edhe është theksuar në raportin e veprimtarisë për vitin 2021.^[16] Duke qenë se nuk ka një strukturë të dedikuar për t'u marrë me referimet nga krerët e gjykatave dhe kërkesat nga palët ndërgjyqëse^[17], CSM-ja e kryen vetë hetimin e këtyre dosjeve, të cilat u shtohen atyre të referuara nga Ministri i Drejtësisë.

Kjo situatë ndikon domosdoshmërisht mbi afatet e trajtimit të tyre, të cilat sigurisht janë të kufizuara në kohë, por mund të arrijnë, në kushte të caktuara, dy vjet pas referimit në CSM^[18].

Organi disiplinor duhet të ketë mjetet e mjaftueshme për të trajtuar brenda afateve të arsyeshme rastet e magistratëve që janë subjekte të procedimit disiplinor. Kjo lidhet me interesin e magistratëve subjekt procedimi disiplinor, i juridiksioneve në të cilat ata janë caktuar dhe, më gjerë, i Ministrisë së Drejtësisë.

16 Në vitin 2021, pranë CSM janë paraqitur për shqyrtim 17 kërkesa, ku 14 për gjyqtarë dhe 3 për prokurorë, ndërsa nga viti 2016 deri në vitin 2020, këto kërkesa kanë qenë nga 3 deri në 6. Raporti i aktivitetit të CSM-së 2021.

17 Këto ankesa të cilat janë objekt shqyrtimi ekskluzivisht në kompetencën e CSM-së duhet të lidhen me sjelljen e një gjyqtari gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

18 Vendimi i CSM-së për themelin duhet të merret brenda 12 muajve nga referimi, përveç rasteve kur zgjatet për një periudhë 6-mujore, e cila mund të rinovohet me vendim të arsyetuar.

3. ÇËSHËTJA E REFERIMIT NË INSPEKTORAT NGA ORGANI DISIPLINOR

Pas përfundimit të raportit të hetimit, IGJ-ja nuk ndërhyr as pranë Drejtorisë së Shërbimeve Gjyqësore (DSJ)^[19] të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe as pranë CSM, për të mbrojtur konkluzionet e tij. I takon DSJ-së që të përfaqësojë Ministrin e Drejtësisë përpara CSM-së. Pra, për çdo rast nuk ekziston asnjë lidhje midis IGJ-së^[20] që heton dosjen, Ministrin të Drejtësisë që referon shkeljes disiplinore në CSM, si dhe CSM-së që shqyrton rastin. Kjo situatë e mbron IGJ-në nga çdo dyshim në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

Kohët e fundit, CSM ka kërkuar që të mund t'i drejtohej drejtpërdrejt IGJ-së. Kjo situatë paraqet disa vështirësi që kanë të bëjnë si me statusin e anëtarëve të inspektoratit të cilët i ushtrojnë detyrat e tyre pranë Ministrin të Drejtësisë,^[21] ashtu edhe me parimin e ndarjes së organeve të hetimit nga ato të gjykimit.

4. GARANCITË E DHËNA PËR MAGJISTRATIN NË PROCES HETIMI TË CILAT SIGUROJNË NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR

Në përputhje me dispozitat e ligjit organik për statusin e magjistratit për një kohë të gjatë, parimi i kontradiktorialitetit dhe mundësia për magjistratin që të mbrohej ishin të parashikuara vetëm për procesin disiplinor, cili zhvillohej përpara CSM-së.

Në vitin 2016 IGJ-ja bëri një ndryshim të madh, duke i dhënë

19 Një nga nëndrejtoritë e DSJ-së është përgjegjëse për çështjet etike dhe përpunimin e dosjeve disiplinore të magjistratëve aktivë ose të nderit.

20 CSM në opinionin e datës 24 shtator 2021 drejtuar Presidentit të Republikës për përgjegjësinë e magjistratëve ka rekomanduar që kryetarët e gjykatave të mund t'i drejtohen IGJ-së.

21 IGJ-ja mund të vihet në lëvizje nga Kryeministri ose nga disa ministra për kryerjen e inspektiveve tematike apo institucionale, por kur bëhet fjalë për kryerjen e hetimeve administrative IGJ-ja vihet gjithmonë në lëvizje nga ana e Ministrin të Drejtësisë.

magjistratit mundësinë dhe të drejtën që të mbrohej dhe të njihej me të gjitha dokumentet menjëherë pas njoftimit për fillimin e hetimit administrativ, si dhe përpara gjykimin të çështjes në themel. Në janar 2021, këto garanci u zgjeruan, veçanërisht duke lejuar mbrojtësin e magjistratit të bënte pyetje, si dhe duke i dhënë magjistratit mundësinë për t'u mbrojtur nga disa persona. Përveç kësaj, magjistri mund të kërkojë të njihet me aktet që në fillim të hetimit. Në përfundim të procesit, ai mund të kërkojë akte shtesë dhe të paraqesë vërejtje

Duke ndërmarrë këtë ndryshim me vonesë IGJ-ja u dallua nga shumë inspektorate franceze duke dalë përtej fushëveprimit të vendimit të CSM-së dhe kërkesave të Këshillit të Shtetit, të cilat kishin rrëzuar procesin e hetimit nga inspektorati të një magjistri në një çështje të shqyrtuar në vitin 2013^[22].

Në shkurt 2020, Këshilli i Shtetit pohoi rëndësinë e respektimit të parimit të kontradiktorialitetit duke saktësuar në aspekt parimor në lidhje me një rast që nuk kishte të bënte me një magjistrat, se raporti dhe procesverbalet e personave të marrë në pyetje duhet t'i njoftohen dhe komunikohen nëpunësit publik.^[23] Për pasojë, ai anuloi masën disiplinore të vendosur ndaj një nëpunësi, i cili nuk ishte njohur me to.

Praktika aktuale e IGJ-së është fryt i një evolucioni të ngadaltë. Duke ndjekur një rrugë që respekton shumë më tepër të drejtat e mbrojtjes, ai është përfshirë në një qasje më të drejtë që u përgjigjet sfidave të vënies nën akuzë të një magjistri.

22 Selia e CSM S207 i 11 korrikut 2013.

23 CE 5 shkurt 2020 nr. 433130 botuar në përmbledhjen Lebon: Kur një hetim administrativ mbi sjelljen e një zyrtari publik, i është besuar organeve të inspektimit, raporti i hartuar mbi rezultatin e këtij hetimi, si dhe procesverbalet e personave të marrë në pyetje për sjelljen e zyrtarit publik subjekt hetimi janë pjesë e dokumenteve që ky i fundit duhet të njihet dhe duhet t'i marrë në zbatim të nenit 65 të ligjit të datës 22 prill 1905, përveç rasteve kur komunikimi i këtyre procesverbaleve do të mund të dëmtonte rëndë personat që dëshmuar.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE DHE KUFIJTË E KONTROLLIT TË PUNËS SË MAGJISTRATËVE



Emanuela Aliverti

*Inspektore, Inspektorati i Përgjithshëm i
Ministrit të Drejtësisë, Itali*

Znj. Emanuela Aliverti është diplomuar në vitin 1978 për Gjuhë të Huaja (Anglisht-Frëngjisht) dhe në vitin 1983 është diplomuar për Drejtësi në Universitetin “Cattolica del Sacro Cuore” në Milano. Në vitin 1986 është emëruar audituese e

drejtësisë.

Gjatë karrierës së saj, znj. Aliverti ka qenë gjyqtare civile edhe për të miturit. Ajo ka qenë gjyqtare për çështjet e punës, kujdestarisë, procedurave të paankimueshme, e ekzekutimit të dënimeve dhe gjatë periudhës kohore 1987-1989 ka mbajtur pozicionin e Kryetares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Leccos.

Gjatë periudhës kohore 1992-2004 znj. Aliverti ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Komos në Dhomën e Parë Civile (çështjet e lidhura me të drejtat e pasurive të paluajtshme, marrëdhëniet familjare, të drejtën tregtare, detyrimet, trashëgiminë si dhe marrëdhëniet e punës), si dhe në Dhomën e Dytë Civile (çështjet e lidhura me të drejtat e pronësisë, të drejtën intelektuale dhe industriale, përgjegjësinë kontraktore dhe jashtëkontraktore, të trashëgimisë, të sipërmarrjes, procedurat lidhur me njohjen atësisë, të birësimit të personave madhorë, si dhe ato në lidhje

me ndryshimin dhe përcaktimin e gjinisë, ndërprerjen e shtatzënisë për personat e mitur, si dhe gjykimet e shkurtuara dhe ankimet).

Gjatë periudhës kohore 2004-2010 znj. Aliverti ka qenë punonjëse dhe më pas ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës për të Miturit për Bolonjën dhe Milanon, si dhe gjatë periudhës kohore 2010-2014 ka mbajtur pozicionin e këshilltares në Dhomën e Parë Civile në Gjykatën e Apelit të Milanos. Gjatë periudhës kohore 2014-2022 znj. Aliverti ka ushtruar detyrën si Inspektore e Përgjithshme pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nga muaji mars i vitit 2022 ajo është Koorditore e Grupit Ndërkombëtar të Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë karrierës së saj znj. Emanuela Aliverti ka qenë pjesë e bordeve të provimeve për kandidatët për titullin avokat, magjistrat, ka qenë gjyqtare-mentore në Shkollën e formimit profesional të magistraturës, referuese në kurset e trajnimit për gjyqtarët e paqes, avokatët, audituesit gjyqësorë, në Inspektoratin e Përgjithshëm italian dhe ka referuar në shumë seminare e konferenca ndërkombëtare në fushën e drejtësisë, si në: Rabat, Marakesh, Tiranë, Paris, Kazablanka dhe në kuadrin e RESIJ.

A. Një Gjyqësor i Pavarur

Kushtetuta italiane e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 janar 1948, i ka dhënë sistemit të drejtësisë një pavarësi efikase nga pushteti politik dhe të mbrojtur nga çdo ndërhyrje nga ana e pushtetit ekzekutiv. Struktura kushtetuese e parashikuar i përgjigjet edhe në ditët e sotme arritjes së rëndësishme të krijimit të shtetit ligjor liberal, pra të konceptimit jo më të individit në shërbim të shtetit, por përkundrazi të aparatit shtetëror në shërbim të individit.

Njohja e kësaj arritjeje të rëndësishme gjendet në nenin 3, paragrafi 1, të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht se: “të gjithë qytetarët (...) janë të barabartë para ligjit”.

Struktura kushtetuese e përzgjedhur është rezultat i diskutimeve të gjera dhe debatit, të cilat gjithsesi bazoheshin në parime themelore të përbashkëta për të gjithë si:

- a) Karakteri shtetëror i së drejtës, në kuptimin që funksionet gjyqësore mund të ushtrohen ekskluzivisht vetëm nga instanca shtetërore, të cilat kanë karakter detyrues dhe autoritet të njëjtë me degët e tjera të pushtetit;
- b) Uniteti i së drejtës, në kuptimin që administrimi i drejtësisë për çdo çështje (civile, penale dhe administrative), duhet tu besohet ekskluzivisht organeve të parashikuara dhe të rregulluara nga ligji për sistemin gjyqësor, d.m.th., gjyqtarëve të zakonshëm - për të gjithë qytetarët, të cilët janë të barabartë para ligjit;
- c) Pavarësia e gjyqtarit, si në ushtrimin konkret të funksionit gjyqësor, ashtu edhe në lidhje me statusin juridik të organeve të sistemit të drejtësisë;
- d) Autonomia dhe pavarësia e sistemit gjyqësor.

Nuk ka dyshim se pavarësia e gjyqësorit përbën një “vlerë themelore të një shteti të bazuar në shtetin e së drejtës”, e sanksionuar shprehimisht nga Kushtetuta italiane në nenin 101 ku parashikohet shprehimisht se: “[...]gjyqtarët i nënshtrohen vetëm ligjit” dhe në nenin 104 ku parashikohet se: “Gjyqësori përbën një rend autonom, të pavarur nga çdo pushtet tjetër.[..].”

Kështu që, nga njëra anë, në ushtrimin e funksioneve të tij, gjyqtari i nënshtrohet vetëm ligjit (e ashtuquajtura pavarësi funksionale) dhe nga ana tjetër, organizimi i pushtetit në tërësi është plotësisht autonom, në kuptimin që ai nuk duhet të jetë i varur nga asnjë pushtet tjetër dhe duhet të ketë statusin e tij (e ashtuquajtura pavarësi strukturore).

Gjyqtarët, pra, janë të mbrojtur nga ndërhyrja e pushteteve të tjera dhe i nënshtrohen vetëm ligjit. Ndërsa pavarësia strukturore konsiston në aspekt të:

- a) Përzgjedhjes së magistratëve nëpërmjet procedurave të konkurimit (neni 106);
- b) Shpërblimin e magistratëve mbi bazën e vjetërsisë në punë dhe jo ecurinë në karrierë;
- c) Ekzistencës së administratës gjyqësore dhe përcaktimit të statusit të magistratëve duke parashikuar rregulla në lidhje me: rekrutimin, punësimin, mandatin, transferimin, vlerësimin profesional, ecurinë në karrierë, aplikimin e sanksioneve disiplinore, përfshirë edhe masat e sigurimit (neni 105 i Kushtetutës)-nga ana e një organi krejtësisht i ndarë nga pushteti ekzekutiv dhe më shumë se gjysma e anëtarëve të tij duhet të jenë magistratë (dy të tretat): Këshilli i Lartë Gjyqësor është garant i të ashtuquajturës pavarësi e jashtme e magistratëve.
- d) Në garantimin e paluajtshmërisë nga detyra (neni 107) e cila mund të aplikohet vetëm në kuadër të një mase disiplinore i dhënë nga Komisioni Disiplinor i Këshillit të Lartë Gjyqësor (HJC).

Këshilli i Lartë Gjyqësor referuar, në gjuhën e zakonshme, si organi i “vetëqeverisjes” së gjyqësorit d. m. th., i vetëorganizimit ose, më mirë, i vetëadministrimit të magistratëve dhe për rrjedhojë, i administratës së pavarur gjyqësore, nga njëra anë gëzon një formë të veçantë pavarësie për të vepruar në pjesën më të madhe, nga vetë magistratët dhe nga ana tjetër kryesohet nga Presidenti i Republikës si pushtet neutral dhe garantues i Kushtetutës.

Ministri i Drejtësisë, nga ana tjetër, sipas nenit 110 të Kushtetutës, ka për detyrë të sigurojë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të drejtësisë pa cenuar kompetencat e Këshillit të Lartë

Gjyqësor, Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe ka kompetencën për të marrë masa disiplinore (neni 107 i Kushtetutës).

Në këtë kontekst, nga interpretimi sistematik i dispozitave të mësipërme rezulton se:

- a) Ministri nuk është më në krye të pushtetit gjyqësor, por kryen vetëm funksione që plotësojnë efikasitetin e drejtësisë;
- b) Çdo vendim përfundimtar mbi emërimin e magistratëve, i cili mund të ndikojë në organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, karrierën, apo marrjen e një mase disiplinore merret eskuluzivisht nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- c) Forma e kontrollit mbi magistratët nga pushteti politik ushtrohet vetëm në kuadër të propozimit të masave disiplinore (arsyetim ky i cili rrjedh nga interpretimi a contrario i nenit 107 (2) të Kushtetutës), mbi të cilat vendos në rast Komisioni Disiplinor i HJC.

B. Përgjegjësia disiplinore për të mbrojtur imazhin e magistratit dhe prestigjin e gjyqësorit

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor funksionon Komisioni i Disiplinës një organ gjyqësor i përbërë nga gjashtë anëtarë, i cili shqyrton kërkesat (propozimet) për masa disiplinore të paraqitura nga Prokurori i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Kasacionit apo Ministrin të Drejtësisë, vendimet e të cilit mund të kundërshtohen përpara kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Kasacionit.

Sistemi ligjor italian parashikon një sistem disiplinor për magistratët e zakonshëm - me përjashtim të atyre të së drejtës administrative, të kontabilitetit dhe asaj ushtarake - d. m. th., për gjyqtarët dhe prokurorët publikë, përfshirë anëtarët e HJC, prokurorët e

Prokurorisë së Përgjithshme të Gjykatës së Kasacionit dhe këshilltarët e Gjykatës së Kasacionit. Rregullat bazë janë përcaktuar në Dekretin Legjislativ nr. 109, të vitit 2006, si për sa i përket procedurës, ashtu edhe për rastet e shkeljeve dhe masave disiplinore.

Neni 1 i Dekretit Legjislativ nr. 109/2006 përcakton, në radhë të parë, detyrat e magjistratit, i cili: “[...]...*kryen funksionet që i janë ngarkuar me paanshmëri, drejtësi, devotshmëri, kujdes, rezervë dhe ekuilibër dhe respekton dinjitetin e njeriut në ushtrimin e funksioneve të tij*”.

Shkeljet disiplinore - të cilat ligjvënësi i vitit 2006 donte t’i parashikonte shprehimisht - janë identifikuar pikërisht sepse konkretizojnë shkeljen e këtyre detyrave dhe, rrjedhimisht, dëmtimin e imazhit të gjyqtarit dhe prestigjit të gjyqësorit, interesa që legjislacioni synonte në mënyrë specifike t’i mbronte dhe dëmtimi i të cilave duhet të konstatohet që sjellja e magjistratit të sanksionohet.

Aq sa në nenin 3 bis të Dekretit Legjislativ nr. 109, të vitit 2006, ligjvënësi ka parashikuar përjashtimin nga përgjegjësia disiplinore të magjistratit kur shkeljet nuk janë të rëndësishme (*Shkelja disiplinore nuk mund të kryhet kur fakti është i parëndësishëm*), duke parashikuar hipotezën se pasi të jetë konstatuar nga ana objektive dhe subjektive shkelja specifike disiplinore e kryer, vlerësimi i saj ex post duhet të bëhet në tërësi (dhe jo vetëm për shkeljen e kryer) në raport me një sërë rrethanash të tjera të cilat kanë të bëjnë me karrierën profesionale të magjistratit dhe parë në raport me cenimin e interesave të mbrojtura nga legjislacioni si imazhi i gjyqtarit apo prestigji i pushtetit gjyqësor.

Disa shembuj:

- ▶ Gjykata Supreme (Sek. U, Vendimi nr. 1416, i datës 18.01.2019) ka vendosur përjashtimin nga përgjegjësia disiplinore të magjistratit për shkak të parëndësisë së faktit, lidhur me sjelljen e një kryetari të trupit gjykues, i cili kishte nënshkruar një vendim një ditë para zhvillimit të seancës së parashikuar për diskutim, duke arsyetuar se pavarësisht detyrimit që lidhet me funksionin e kryetarit për të kontrolluar aktin procedural, në rastin konkret duke mbajtur në konsideratë një sërë rrethanash, të cilat lidhen me saktësinë e përmbajtjes së vendimit të hartuar nga gjyqtari relator, natyrën episodike të shkeljes, si dhe formimin profesional dhe ecurinë e karrierës së magjistratit është vendosur përjashtimi nga përgjegjësia disiplinore.
- ▶ Gjykata Supreme (Sek. U, Dënimi nr. 31058 datë 27.11.2019) në procedimin disiplinor në lidhje me një zëvendësprokuror publik të akuzuar për sjellje të pahijshme ndaj një prokurori tjetër publik S.C, ka shfuqizuar vendimin e Komisionit Disiplinor, i cili nuk kishte arsyetuar ex post dhe in *concreto* mbi konceptin e “rëndësisë së faktit”, si dhe pasojat e sjelljes së magjistratit në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe funksioneve gjyqësore parashikuar nga neni 2, paragrafi 1, shkronja “d”, të Dekretit Legjislativ nr. 109 të vitit 2006, si dhe së dyti, në kuadër të imazhit të magjistratit, parashikuar nga neni 3 bis i të njëjtit Dekret, por vetëm in *abstracto* dhe në mënyrë hipotetike, mbi një cenim të mundshëm të imazhit të pushtetit gjyqësor.
- ▶ Neni 3 bis i Dekretit Legjislativ nr. 109 të vitit 2006 është zbatuar përsëri edhe në rastin kur sjellja e magjistratit subjekt procedimi disiplinor nuk ka sjellë si pasojë ndonjë cenim apo përfitim të padrejtë ndaj ndonjë individi, si dhe nuk është kryer në kuadër të neglizhencës, apo me dashje, por me mirëbesim ndaj palëve të cenuara. (HJC sez. disk. nr. 5/2010);
- ▶ Kur magjistrati gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore nuk zbaton një dispozitë, kuptimi i së cilës nuk mund të shmanget

me asnjë formë interpretimi, si dhe nëse pasojat e kësaj shkeljeje riparohen nëpërmjet procedurave të zakonshme të ankimit, duke mos sjellë asnjë pasojë tjetër por vetëm pranimin e ankimit (HJC sez. disk. nr. 153/2009).

Më pas janë parashikuar shkeljet konkrete disiplinore në lidhje kushtet dhe rrethanat në të cilat kryhet shkelja disiplinore dhe konkretisht shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit [24],

24 **Neni 2: 1.** Parashikimet e mëposhtme përbëjnë shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit:

- (a) përveç parashikimeve të nënparagrafëve (b) dhe (c), sjellje që, në shkelje të detyrave të përmendura në nenin 1, i shkakton dëm të padrejtë ose përfitim të padrejtë njëres prej palëve;
- (b) mosinformimi i Këshillit të Lartë të Gjyqësorit për ekzistencën e ndonjë prej situatave të papajteshmërisë të përmendura në nenet 18 dhe 19 të Urdhrit Gjyqësor, Dekreti Mbretëror 12, datë 30 janar 1941, i ndryshuar nga neni 29 i këtij Dekreti;
- (c) moszbatimi me dashje i detyrimit për abstenim në rastet e parashikuara nga ligji;
- (d) sjellje e pahijshme e zakonshme ose e rëndë ndaj palëve, mbrojtësve të tyre, dëshmitarëve ose kujt do që ka marrëdhënie me magjistratin brenda gjykatës, ose ndaj magjistratëve ose bashkëpunëtorëve të tjerë;
- (e) ndërhyrje e pajustificuar në veprimtarinë gjyqësore të një magjistrati tjetër;
- (f) mosinformimi i drejtuesit të gjykatës për ndërhyrjen që ka ndodhur, nga magjistrati të cilit i drejtohet ndërhyrja;
- (g) shkelje e rëndë e ligjit, shkakuar nga padijenja ose neglizhenca e rëndë dhe me faj;
- (h) keqinterpretimi i fakteve të shaktuara nga neglizhenca e rëndë dhe me faj;
- (i) shkronjë e shfuqizuar me ligjin nr. 269 të datës 24 tetor 2006;
- (l) dhënia e vendimeve vetëm nëpërmjet arsytimit të plotësimit të kriterëve ligjore për dhënien e tyre e pashoqëruar me arsyetimin mbi aplikimin e këtyre kriterëve mbi faktet konkrete të çështjes, kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji;
- (m) dhënia e vendimeve në kundërshtim me ligjin për shkak të neglizhencës së rëndë dhe me faj, të cilat kanë dëmtuar të drejtat personale ose, në një masë të konsiderueshme, të drejtat pronësore;
- (n) mospërmbyrje e rëndë ose e përsëritur e detyrës në përputhje me rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve gjyqësore dhe teknologjisë së informacionit (IT), të miratuara nga organet kompetente.
- (o) besimi i kryerjes së detyrave të cilat i takojnë magjistratit personave të tjerë;
- (p) moszbatimi në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi i detyrimit për të banuar në bashkinë ku ndodhet institucioni, duke sjellë si pasojë mosushtrimin e detyrës dhe mungesën e devotshmërisë për ushtrimin e saj;
- (q) vonesa e përsëritur, e rëndë dhe e pajustificuar në kryerjen e akteve që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave; një vonesë jo më e madhe se trefishi i periudhës kohore së përcaktuar me ligj për kryerjen e veprimit do të konsiderohet jo e rëndë, përveçse kur provohet e kundërta;
- (r) mosushtrimi i detyrës pa shkaqe të justifikuara;
- (s) mosushtrimi i detyrës si dhe mosnxjerrja e akteve të nevojshme nga ana e kryetarit të gjykatës, kryetarit të dhomës apo kryetarit të kolegjit;
- (t) mungesa e gadishmërisë për të qenë në dispozicion të institucionit, kur kjo kërkohet nga ligji apo aktet e tjera të organeve kompetente;
- (u) bërja publike për shkak të neglizhencës i akteve procedurale të cilat konsiderohen sekret, ose ndalohen për t'u publikuar, si dhe shkelja e detyrimit të konfidencialitetit në lidhje me çështjen e cila po trajtohet, kur zbulimi i të dhënave mund të dëmtojë në mënyrë të padrejtë interesat e personave të tjerë.
- (v) bërja e deklaratave publike ose dhënia e intervistave në lidhje me çështjet të caktuara ose personat palë

shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit^[25], si dhe shkeljet

- në një çështje, kur cenojnë të drejtat e të tjerëve dhe në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në nenin 5(2) të Dekretit Legjislativ nr. 106, datë 20 shkurt 2006.
- (z) shkronjë e shfuqizuar me ligjin nr. 269 të datës 24 tetor 2006;
 - (aa) publikimi i lajmeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjykatës ose krijimi dhe përdorimi i kanaleve të komunikimit të informacionit personal, konfidencial ose të privilegjuar;
 - (bb) shkronjë e shfuqizuar me ligjin nr. 269 të datës 24 tetor 2006;
 - (cc) marrja me dashje e vendimeve të cilat kanë papajtueshmëri të dukshme ndërmjet pjesës arsyetuese dhe pjesës urdhëruese duke shfaqur një kontradiktë të dukshme nga pikëpamja e përbajtjes, arsyetimit apo logjikës;
 - (dd) mosveprimi, nga drejtuesi i një zyre ose kryetari i një dhome ose kolegji, në lidhje me komunikimin me organet kompetente për fakte të njohura prej tij që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të kryera nga magjistratët e tjerë të gjykatës, Dhomës ose Panelit (Kolegjit);
 - (ee) mosveprimi nga ana e kryetarit të gjykatës, kryetarit të dhomës apo kryetarit të kolegjit lidhur me kompetencat e tij mbikëqyrëse për të informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ekzistencën e ndonjë prej rasteve të papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 18 dhe 19 të Urdhrit Gjyqësor, Dekreti Mbretëror nr. 12 i datës 30 janar 1941, i ndryshuar së fundmi nga neni 29 i këtij Dekreti; ose raste që mund të kërkojnë miratimin e masave të përmendura në nenet 2 dhe 3 të Dekretit Legjislativ Mbretëror nr. 511 datë 31 maj 1946, i ndryshuar me nenin 29 të këtij Dekreti 12 datë 30 janar 1941, i ndryshuar së fundmi nga neni 29 i këtij Dekreti; ose të rasteve që mund të kërkojnë miratimin e masave të përmendura në nenet 2 dhe 3 të Dekretit Legjislativ Mbretëror nr. 511, datë 31 maj 1946, të ndryshuar me nenin 26 (1) dhe 27 të këtij Dekreti;
 - (ff) dhënia e një vendimi në kundërshtim të hapur me ligjin për shkak të neglizhencës së rëndë dhe me faj;
 - (gg) dhënia e masave kufizuese të lirisë personale në kundërshtim të hapur me ligjin për shkak të neglizhencës së rëndë dhe me faj;
(gg-bis) moszbatimi i nenit 123 dhe dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale, sipas parashikimeve të Dekretit Legjislativ nr. 271, datë 28 korrik 1989)).
- 25 Neni 3: 1.** Parashikimet e mëposhtme përbëjnë shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit:
- (a) përdorimi i statusit të magjistratit për të marrë përfitime të padrejta për veten ose të tjerët;
 - (b) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënim më shumë se tre vjet dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;
 - (c) ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit, pa autorizimin paraprak të Këshillit të Lartë të Gjyqësoris;
 - (d) kryerja e veprimtarive të papajtueshme me funksionin gjyqësor të parashikuara në nenin 16, paragrafi 1, të Dekretit Mbretëror nr. 12 të datës 30 janar 1941, të ndryshuar më pas, ose të aktiviteteve të tilla që bien ndesh me kryerjen e detyrave të parashikuara nga neni 1;
 - (e) marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, hua ose favore nga persona nga të cilët magjistrati ka dijeni se janë palë ose nën hetim në një proces penal ose civil, i cili gjykohet pranë institucionit në të cilin ai bën pjesë ose në një zyrë tjetër që ndodhet në rrethin e Gjykatës së Apelit, në të cilin ai ushtron funksione gjyqësore, ose nga mbrojtësi i personave të tillë, si dhe marrja, drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt, hua ose lehtësira, në kushte jashtëzakonisht të favorshme, nga palët e dëmtuara ose dëshmitarët ose në çdo rast nga personat e përfshirë në këto procese.
 - (f) shkronjë e shfuqizuar me ligjin nr. 269 të datës 24 tetor 2006;
 - (g) pjesëmarrja në shoqata sekrete ose shoqata, lidhjet e të cilave janë objektivisht të papajtueshme me ushtrimin e funksioneve gjyqësore;
 - (h) anëtarësimi ose pjesëmarrja sistematike dhe e vazhdueshme në parti politike ose përfshirja në aktivitetet e personave që operojnë në sektorin ekonomik ose financiar që mund të kushtëzojnë ushtrimin e funksioneve ose në çdo rast të cenojnë imazhin e magjistratit;
 - (i) shfrytëzimi i pozicionit të magjistratit, që për shkak të pozicionit ose mënyrës së kryerjes së tij, synon të kushtëzojë ushtrimin e funksioneve të parashikuara me kushtetutë;
 - (l) shkronjë e shfuqizuar me ligjin nr. 269 të datës 24 tetor 2006.

disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale^[26].

Parashikimi dhe klasifikimi i shkeljeve disiplinore, paraqiti një hap të rëndësishëm përpara në krahasim me parashikimet e mëparshme ligjore sipas nenit 18 të Dekretit Legjislativ Mbretëror nr. 511/46, ku sa herë magjistrati nuk kryente detyrat e tij apo kishte sjellje të cilat cenonin imazhin apo prestigjin e pushtetit gjyqësor, identifikimi i rrethanave dhe çështjeve individuale bëhej nga ana e Komisionit Disiplinor të HJC.

C. “Klauzola mbrojtëse” si garanci e pavarësisë së magjistratit

Paragrafi i dytë i nenit 2 prezanton një “klauzolë mbrojtëse” në lidhje me aspektin e ushtrimit të funksioneve nga ana e magjistratëve. Dispozita parashikon se veprimtaria e magjistratëve e cila ka të bëjë me interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve apo provave nuk passjell përgjegjësi disiplinore, përveç rasteve kur ato janë diktuar nga sjellje që parashikohen shprehimisht si shkelje disiplinore (p. sh., shkelje e rëndë e ligjit, keqinterpretim i fakteve, si dhe mungesë arsyetimi nga mungesa e profesionalizmit apo neglizhenca e rëndë dhe me faj).

Kolegjet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit dhe Seksioni Disiplinor i Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë mbajtur një qëndrim

26 **Neni 4:1.** Parashikimet e mëposhtme përbëjnë shkelje disiplinore:

- (a) faktet për të cilat është marrë një dënim i formës së prerë ose është dhënë një dënim në bazë të nenit 444, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale, për një krim të kryer me dashje ose nga pakujdesia, kur ligji parashikon dënim me burgim ose gjobë;
- (b) faktet për të cilat është marrë një dënim i formës së prerë ose është dhënë një dënim në bazë të nenit 444, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale, për një kundërvajtje penale të kryer me faj ku parashikohet dënim me burg dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe pasojat e ardhura janë të rënda;
- (c) faktet për të cilat është marrë një dënim i formës së prerë ose është dhënë një dënim në bazë të nenit 444, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet dënim me burg dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale kanë një karakter të vecantë;
- (d) çdo fakt që përbën një veprë penale që mund të dëmtojë imazhin e magjistratit, pavarësisht nëse vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk mund të fillojë ose të vazhdojë.

të konsoliduar duke pohuar se përgjegjësia disiplinore nuk ka si qëllim parandalimin dhe/ose ndëshkimin e gabimeve të magistratëve, të cilat janë objekt shqyrtimi dhe trajtimi brenda shkallëve të pushtetit gjyqësor, por të sigurojë që pushteti gjyqësor të ushtrohet në përputhje me detyrat themelore që i ngarkohen magistratit. Në këtë kuadër mund të thuhet që sjellja e magistratit përbën shkelje disiplinore atëhere kur kjo sjellje cenon besimin ndaj figurës së magistratit dhe reputacionin e pushtetit gjyqësor.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që rast pas rasti të vlerësohet nëse intepretimi dhe zbatimi i dispozitave nga ana e magistratit është bërë në mënyrën më të arsyeshme të mundshme apo aq në kundërshtim me përmbajtjen e saj (Gjykata e Lartë SSU nr. 1161/2000) duke treguar mungesë të profesionalizmit, mungesën e kujdesit të nevojshëm nga ana e magistratit apo neglizhencë, sjellje këto të cilat ndikojnë konkretisht në imazhin dhe reputacionin e pushtetit gjyqësor (Gjykata e Lartë SSU nr. 12268 i vitit 2004 dhe nr. 7379 i vitit 2013).

Si përfundim, masa disiplinore nuk ka të bëjë me rezultatin e veprimtarisë gjyqësore, por me sjelljen etike devijuese të magistratit në ushtrimin e funksionit të tij (Gjykata e Lartë, SSU nr. 1628 i vitit 2010 dhe nr. 20730 i vitit 2009), me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore nuk është dhënë në përputhje me procedurën e parashikuar, ose për një shkelje të rëndë e kryer nga neglizhenca e rëndë dhe me faj (Urdhër HJC nr. 90 i vitit 2011).

Po japim disa shembuj:

(1.) Prokurori publik nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale, emrin e personit i cili ka rezultuar nga hetimi i rrethanave, si dhe nga informacioni i mbledhur në kundërshtim me parashikimet e nenit 335 të Kodit të Procedurës Penale ku thuhet shprehimisht se: *“Prokurori publik shënon menjëherë në regjistrin e posaçëm që*

mbahet në zyrë, çdo kallëzim për veprën penale të të cilit ai ka dëjjeni ose të cilën e ka marrë me iniciativën e tij, si dhe, në të njëjtën kohë ose sapo merr dëjjeni, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”. Komisioni Disiplinor i HJC (Urdhri i HJC-së nr. 47, i vitit 2019) ka vendosur që kjo sjellje pavarësisht se nuk është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore, përsëri nuk është një gabim i rëndë dhe për rrjedhojë nuk përbën shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit. Shqyrtimi i veprimtarisë së interpretimit të rregullave dhe vlerësimit të fakteve prek drejtpërdrejt parimin kushtetues të pavarësisë së magjistratit dhe, për rrjedhojë, rastet dhe kufijtë e këtij shqyrtimi duhet të përcaktohen dhe zbatohen me rigorozitet të jashtëzakonshëm;

(2) Prokurori publik (P. M.) dhe gjyqtari për hetime paraprake (G.I.P.), përkatësisht në kërkesë dhe në urdhrin për dhënien e masave paraprake ndaj të dyshuarve, ka transkriptuar disa përgjime telefonike në të cilat bashkëbiseduesit kanë treguar “kuestor”-in si personi që mbron njërin prej të dyshuarve, pa urdhëruar megjithatë regjistrimin e tij në regjistrin e veprave penale: Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit arsyetuan se në rastin konkret nuk jemi përpara shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 2(1)(g) të Dekretit Legjislativ nr. 109 (*shkelje e rëndë e ligjit, shkaktuar nga padijenja ose neglizhenca e rëndë dhe me faj*), duke arsyetuar që vlerësimi i përshtatshmërisë së një transkripti të tillë për të sqaruar tërësinë e rrethanave provuese ndaj të dyshuarve - të çon drejt një gjykimi mbi vlerën provuese të provës dhe, si rrjedhim, në dhënien e masës së sigurimit – kjo duhet t’i lihet gjykimit të magjistratëve të interesuar dhe për këtë arsye është jashtë fushës së kontrollit të gjykatës disiplinore; Në veçanti, Gjykata e Kasacionit vendosi parimin e mëposhtëm ligjor: “*Sjellja e magjistratit, e cila merr formën e një veprimtarie interpretimi dhe zbatimi të rregullave të ligjit, është objekt kontrolli sipas sistemit disiplinor vetëm në rast se masa disiplinore është marrë për shkak të kryerjes së një shkelje të rëndë disiplinore ose nga neglizhenca e rëndë dhe me faj duke*

treguar mungesë të profesionalizmit, mungesën e kujdesit të nevojshëm nga ana e magjistratit apo neglizhencë, sjellje këto të cilat ndikojnë konkretisht në imazhin dhe reputacionin e pushtetit gjyqësor” (Cass. Sec. U, vendimi nr. 11586, i datës 02.05.2019).

(3) Kur i është paraqitur një kërkesë për një propozim për marrëveshje me kreditorët në lidhje me një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, duke zbatuar dispozitën që ka të bëjë me një shoqëri të zakonshme dhe jo me një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, gjyqtari pa kryer asnjë hetim paraprak apo pyetur kërkuesin në mënyrë të paarsyeshme dhe duke u mbështetur në nënshkrimin e një formulari të përgatitur nga regjistruesi ka caktuar likuidatorin e shoqërisë në kundërshtim me objektin e kërkesës ë paraqitur. Sipas opinionit të Komisionit Disiplinor të HCJ-së (Vendimi i HCJ-së nr. 109, i vitit 2010), sjellja përbën shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si shkelje e rëndë e ligjit, shkaktuar nga padijenja ose neglizhenca e rëndë dhe me faj. Fakti që vendimet dhe interpretimet gjyqësore nuk i nënshtrohen shqyrtimit disiplinor thjesht përjashton mundësinë që pasaktësia e tyre tekniko-juridike mund të përbëjë në vetvete një shkelje të etikës, por nuk e pengon vlerësimin e përgjithshëm të sjelljes së magjistratit në këtë aspekt. Domethënë nga pikëpamja e devotshmërisë apo neglizhencës, pasojave të vendimit të dhënë, apo përkushtimit të tij moral dhe intelektual ndaj funksionit gjyqësor, i cili duhet të ushtrohet gjithmonë duke respektuar detyrat dhe të drejtat e palëve në proces. Në të njëjtën kohë, në kuadër të kujdesit dhe devotshmërisë në raport me palët magjistrati duhet të kryejë verifikimin e duhur të parakushteve faktike dhe ligjore të cilat lejojnë dhënien një vendimi gjyqësor, si dhe ndalojë kryerjen e veprimeve të tilla.

(4) Gjyqtari nënshkroi urdhra për t’i paguar shpenzimet nëpunësit të ngarkuar me përgatitjen e inventarëve, duke i ngarkuar ato në thesar dhe jo tek pasuria ose kërkuesi, për sa parashikohet në nenin 511 të Kodit Civil, si dhe duke paguar punën e kryer jo në

përputhje me dispozitat e Qarkores 1801/61 të datës 28 qershor 1958 të Ministrisë së Drejtësisë, d. m. th., si punë jashtë orarit, jo në lidhje me kohën e shpenzuar, si dhe në një masë dukshëm më të lartë se ajo që i takon: Sipas mendimit të Komisionit Disiplinor të HJC-së (vendimi HJC nr. 30 i vitit 2010), sjellja e një gjyqtari që nënshkruan disa urdhra për pagesën e shumave në favor të një regjistruesi, në kundërshtim me ligjin dhe një qarkore ministrore; që janë përgatitur materialisht nga i njëjti regjistrues pa ndonjë udhëzim ose verifikim paraprak të ligjshmërisë ose të përmbajtjes së tyre; duke mbajtur në konsideratë pjesën që lidhet me përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të anëtarit të gjyqësorit; përbën shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit në kuadër të shkeljes së rëndë të ligjit shkaktuar nga padijenja ose neglizhenca e rëndë dhe me faj për mosrespektim të përsëritur të dispozitave që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve gjyqësore, të miratuara nga organet kompetente, si dhe me besimin jo në mënyrën e duhur ndaj veprimtarive të palëve të treta në lidhje me funksionet e tij.

Në fakt, sjellja e përshkruar, evidenton kryerjen e gabimeve të rënda në zbatimin e ligjit, duke mos iu referuar interpretimeve, sado të diskutueshme, të rregullave, në lidhje me të cilin kontrolli i gjykatës disiplinore do të konstatonte një kufi i cili nuk mund të kalohej nga ana e saj si psh një mosrespektim i thjeshtë rregullave të përcaktuara nga sistemi, për shkak të mosnjohjes së tyre. Nga ana tjetër nuk mund të justifikohet as nga ngarkesa e madhe e praktikave që duhen trajtuar, pasi nënshkrimi i urdhrave nënkupton jo vetëm një marrje të përgjegjësisë personale, por edhe shtrirje të efekteve të aktit ndaj personave të tjerë si manifestim i autoritetit që sistemi ligjor i njeh vendimmarrjes së magistratëve.

SHËRBIMI I INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË, MIDIS PAVARËSISË DHE PËRGJEGJËSISË SË MAGJISTRATËVE



Michail Pikramenos

Nënkryetar, Këshilli i Shtetit, Greqi

Z. Michail Pikramenos është Nënkryetar i Gjykatës së Lartë Administrative (Këshilli i Shtetit). Profesor i së Drejtës Administrative në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Aristotelit në Selanik, si dhe gjatë periudhës kohore 2013-2016 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm në Shkollën Kombëtare të Gjyqtarëve. Z. Pikramenos ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Gjykatës Speciale për përgjegjësinë e gjyqtarëve (neni 99 i Kushtetutës), si dhe atë të Kryetarit të Bordit të Inspektimit të Gjyqtarëve në Këshillin e Shtetit. Krahas detyrave të mësipërme, z. Pikramenos ka qenë pjesëmarrës dhe në një sërë procesesh pune si Kryetar i Grupit të Punës për hartën e re gjyqësore të gjykatave administrative. Kryetar i Grupit të Punës për hartimin e Kodit të Etikës së Gjyqtarëve për gjyqtarët e gjykatave administrative. Ka marrë pjesë në Organizata të shumta Evropiane (Komiteti Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Rrjeti Evropian i Trajnimit, Komisioni i Venecias, Tabela e Rezultateve të Drejtësisë së BE, pika qendrore e Këshillit të Shtetit me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut). Ka shkruar monografi dhe artikuj në fushat e të Drejtës Kushtetuese dhe të Drejtës Administrative.

Abstrakti i prezantimit

Njëra anë e medaljes është pavarësia dhe ana tjetër është përgjegjësia. Pavarësia e gjyqësorit nuk mund të pranohet pa përgjegjësi të qartë. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) deklaroi se gjyqtarët individualë dhe gjyqësori në tërësi janë përgjegjës në dy nivele. Së pari, ata janë përgjegjës ndaj palëve të veçanta ndërgjyqëse që kërkojnë drejtësi. Së dyti, ata janë përgjegjës ndaj pushteteve të tjera të shtetit dhe, nëpërmjet tyre, ndaj shoqërisë në përgjithësi. Sipas CCJE-së, vlerësimi individual i gjyqtarëve është një mekanizëm i llogaridhënies shpjeguese. Cilësia e drejtësisë nuk mund të kuptohet sikur të ishte sinonim i thjesht “produktivitetit” të sistemit gjyqësor. Vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë të gjitha aspektet që përbëjnë performancë të mirë gjyqësore, në veçanti njohuritë ligjore, aftësitë e komunikimit, kujdesin, efikasitetin dhe integritetin.

A. Roli i gjyqësorit në demokracinë moderne

Në opinionin 18/2015 të CCJE-së “Pozicioni i gjyqësorit dhe marrëdhënia e tij me pushtetet e tjera shtetërore në një demokraci moderne” ka vërejtje shumë të rëndësishme për rolin e drejtësisë në shtet dhe pozicionin e saj sipas parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve. Sipas këtij opinioni, gjatë dekadave të fundit, marrëdhënia ndërmjet tre pushteteve të shtetit (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor) është transformuar. Pushteti ekzekutiv dhe pushteti legjislativ janë bërë gjithnjë e më shumë të ndërvarur. Në të njëjtën kohë, roli i gjyqësorit ka evoluuar. Numri i çështjeve të paraqitura në gjykata dhe numri i akteve legjislative që gjykatat duhet të zbatojnë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme. Zhvillimi i pushtetit ekzekutiv në veçanti ka sjellë më shumë sfida ndaj veprimeve të tij në gjykatë dhe kjo nga ana tjetër ka çuar në lindjen e pikëpyetjeve për shtrirjen e rolit të gjyqësorit si kontrollues të ekzekutivit. Ka pasur një numër në rritje sfidash në gjykata

ndaj pushteteve dhe veprimeve legislative. Si rezultat, gjyqësorit gjithnjë e më shumë i është dashur të shqyrtojë dhe ndonjëherë ka frenuar edhe veprimet e dy pushteteve të tjera. Sot, për palët në proces gjyqësor dhe për shoqërinë në tërësi, procesi gjyqësor ofron një lloj arene alternative demokratike, ku shkëmbehen argumente ndërmjet seksioneve të publikut dhe pushteteve të shtetit dhe debatohen çështje me shqetësime të përgjithshme. Gjykatat vendosin për çështje me rëndësi të madhe ekonomike dhe politike. Institucionet ndërkombëtare, veçanërisht Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Bashkimi Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (CJEU) kanë pasur të gjitha një ndikim të konsiderueshëm në shtetet anëtare, veçanërisht në forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në rolin e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, zbatimi i rregullave dhe standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së dhe CJEU-së kanë sjellë sfida të reja për gjyqësorin në shtetet anëtare dhe ndonjëherë aplikimi i tyre nga gjykatat është kundërshtuar nga politikanë apo komentues.

B. Pavarësia gjyqësore

Pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë. Parimet bazë për pavarësinë e gjyqësorit u miratuan nga Kongresi i 7-të i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit në Milano (26.8.-6.9.1985) për të ndihmuar shtetet anëtare në detyrën e tyre për të siguruar dhe promovuar pavarësinë e gjyqësorit. Parimet janë formuluar kryesisht duke pasur parasysh gjyqtarët profesionistë, por ato zbatohen njëlloj edhe për gjyqtarët jo magjistratë. Sipas Magna Carta të gjyqtarëve, pavarësia gjyqësore duhet të jetë statutore, funksionale dhe financiare dhe duhet të garantohet në lidhje me pushtetet e tjera të shtetit, atyre që kërkojnë drejtësi, gjyqtarë të tjerë dhe shoqërinë në përgjithësi, me anë të rregullave kombëtare në nivelin më të lartë. Shteti dhe çdo gjyqtar janë përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore. Sipas Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë (ENCJ),

pavarësia e gjyqësorit buron nga nevoja për gjykim të paanshëm të të gjitha rasteve, qofshin ato penale, civile apo administrative. Gjyqtari nuk duhet të ndikohet nga dallimet e pushtetit ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Mbrojtja e qytetarit nga pushteti i qeverisjes së shtetit është padyshim qendror. Por, çështja është më e gjerë. Gjyqtari duhet të jetë i pakorruptueshëm dhe i aftë, në një rast të duhur, të vendosë çështjet në mënyra që bien ndesh me median dhe opinionin publik. Gjykimi i paanshëm është një komponent thelbësor i shtetit të së drejtës. Aftësia e qytetarëve për të pasur besim në gjykimin e paanshëm ofron sigurinë se të drejtat e tyre do të mbrohen. Kjo është një bazë solide për të gjithë aktivitetin social dhe ekonomik.

C. Përgjegjësia e gjyqtarëve

Njëra anë e medaljes është pavarësia dhe ana tjetër është llogaridhënia (përgjegjësia). Rëndësia e përgjithshme e llogaridhënies pranohet në të gjitha shërbimet publike. Legjitimiteti i shumicës së llojeve të pushtetit publik tani varet nga mekanizmat e pranueshëm të llogaridhënies. ENCJ-ja deklaroi se Pavarësia sjell me vete përgjegjësinë për t'i demonstruar shoqërisë se si është vënë në përdorim pavarësia e gjyqësorit. Në shumicën e shoqërive evropiane, autoriteti nuk pranohet më si dikur. Në mënyrë të ngjashme, pavarësia e gjyqësorit nuk mund të pranohet pa llogaridhënie të qartë gjyqësore. Profesori Stephen Colbran vë në dukje rëndësinë e llogaridhënies gjyqësore: *“Së pari, ajo lidhet me format tradicionale të llogaridhënies gjyqësore, duke përfshirë parimin e “drejtësisë së hapur”, llogaridhënies parlamentare dhe shqyrtimit të apelit. Së dyti, ajo lidhet me analizën e attributeve gjyqësore si aftësia ligjore, paanësia, pavarësia, integriteti, temperamentit, aftësitë komunikuese, aftësitë menaxhuese dhe aftësitë e zgjidhjes, bazuar në opinionet e atyre që janë të përfshirë drejtpërdrejt me sistemin ligjor. Së treti, lidhet me matjen e performancës gjyqësore dhe administrative – me fokusin e saj në kohën dhe lëvizjen e veprimtarisë gjyqësore. Kjo është një qasje e lidhur shpesh me iniciativat e menaxhimit të çështjeve.*

Ndërsa të treja qasjet për vlerësimin e performancës gjyqësore forcojnë llogaridhënien gjyqësore, qasjet tradicionale dhe analiza e attributeve gjyqësore fokusohen në punën e gjyqtarëve individualë, ndërsa matja e performancës gjyqësore dhe administrative fokusohet në punën e përgjithshme të gjykatës”. Është e qartë se disa parametra dhe funksione të gjyqësorit luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e besimit të publikut. Sipas profesorit Stephen Burbank “Llogaridhënia (Përgjegjësia) gjyqësore duhet t’i drejtohet publikut, duke përfshirë palët ndërgjyqëse, mosmarrëveshjet e të cilëve gjykatat i zgjidhin, dhe që për këtë arsye kanë një interes legjitim në proceset gjyqësore që janë të hapura për publikun dhe në vendimet gjyqësore që janë të aksesueshme. Përgjegjësia gjyqësore duhet t’u drejtohet edhe përfaqësuesve të popullit, të cilët përvetësojnë fondet për gjyqësorin dhe ligjet e të cilëve gjykatat i interpretojnë dhe zbatojnë dhe të cilët për këtë arsye kanë një interes legjitim për të siguruar që gjyqësori të ketë qenë përgjegjës në shpenzimin e fondeve të caktuara dhe se, siç interpretohet dhe zbatohet nga gjykatat, ligjet publike funksionojnë ashtu siç synohet. Së fundi, llogaridhënia gjyqësore duhet t’i drejtohet gjykatave dhe gjyqësorit si institucion, si për shkak se pavarësia individuale e gjyqësorit ekziston kryesisht për të mirën e pavarësisë institucionale, ashtu edhe për shkak se llogaridhënia e duhur brenda degës është thelbësore nëse duhet të shmanget llogaridhënia potencialisht e papërshtatshme ndërdegëzore. Në çdo rast, respektimi i duhur për anën tjetër të medaljes – domethënë për pavarësinë gjyqësore – kërkon që llogaridhënia të mos sjellë ndikim që konsiderohet i padrejtë”. Profesori Stefan Voigt bën një vërejtje shumë interesante: “Por gjyqtarët që janë të pavarur nga shumica e vendimmarrësve të tjerë mund të përbëjnë gjithashtu një rrezik: ata mund të marrin vendime vetëm me vonesa të mëdha, të marrin vendime që neglizhojnë shumë nga provat e disponueshme, të marrin vendime që mbështeten mbi legjislacionin e parëndësishëm, ose nxjerrin vendime që janë dukshëm të rreme. Gjyqtarët e pavarur nuk janë vetëm një kusht i domosdoshëm për shtetin e së drejtës, ata përbëjnë edhe një kërcënim për shtetin e së drejtës: nëse ka një shtet të gjyqtarëve, shteti i së drejtës nuk do të realizohet”.

GJEDNJ-ja ka theksuar vendin e spikatur mes organeve shtetërore që zë gjyqësori në një shoqëri demokratike. Gjykata ka theksuar rolin e veçantë në shoqëri të gjyqësorit, i cili, si garantues i drejtësisë, një vlerë themelore në një shtet të qeverisur nga ligji, duhet të gëzojë besimin e publikut nëse dëshiron të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrave të tij dhe në këtë kuadër gjyqtarët kanë më shumë detyra dhe përgjegjësi sesa nëpunësit civilë të zakonshëm. Gjyqtarët kanë gjithashtu kufizime në të drejtat e tyre themelore, të cilat sigurojnë që ata të ushtrojnë detyrat e tyre duke respektuar parimet e neutralitetit dhe paanshmërisë. Është për këtë arsye që autoriteteve gjyqësore, për sa i përket ushtrimit të funksionit të tyre gjyqësor, u kërkohet të ushtrojnë diskrecion maksimal në lidhje me çështjet me të cilat merren për të ruajtur imazhin e tyre si gjyqtarë të paanshëm. Në këto rrethana, shteti mund t'u imponojë gjyqtarëve, për shkak të statusit të tyre, një detyrë diskrecioni dhe GJEDNJ-ja shqyrton në çdo rast nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis të drejtës themelore dhe interesit legjitim të një shteti demokratik për të siguruar që gjyqësori drejton siç duhet qëllimet e renditura në një nen të caktuar të Konventës.

CCJE-ja deklaron se gjyqtarët individualë dhe gjyqësori në tërësi janë përgjegjës në dy nivele. Së pari, ata janë përgjegjës ndaj palëve të veçanta ndërgjyqëse që kërkojnë drejtësi. Së dyti, ata janë përgjegjës ndaj pushteteve të tjera të shtetit dhe, nëpërmjet tyre, ndaj shoqërisë në përgjithësi. Gjyqtarët detyrohen të japin llogari për vendimet e tyre nëpërmjet procesit të apelimit ("përgjegjësia gjyqësore"). Së dyti, gjyqtarët duhet të punojnë në mënyrë transparente. Duke mbajtur seanca të hapura dhe duke dhënë gjykime të arsyetuara, të cilat i vihen në dispozicion publikut, gjyqtarët do t'u shpjegojnë veprimet dhe vendimet e tyre palëve ndërgjyqëse që kërkojnë drejtësi, gjyqtari gjithashtu do u japë llogari për veprimet e tij/saj pushteteve të tjera të shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi (përgjegjësia shpjeguese). Së treti, nëse një gjyqtar është përfshirë në veprime të pahijshme, ai/ ajo duhet të mbahet përgjegjës në një mënyrë më të fortë, p. sh.,

nëpërmjet zbatimit të procedurave disiplinore dhe, nëse është e përshtatshme, të ligjit penal (përgjegjësia ndëshkuese).

Sipas CCJE-së, vlerësimi individual i gjyqtarëve është një mekanizëm i llogaridhënies shpjeguese. Vlerësimi mund të jetë një mjet i dobishëm për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës. Siç shpjegohet nga CCJE-ja, vlerësimi individual i punës së gjyqtarëve mund të ndihmojë në marrjen e informacionit mbi aftësitë e gjyqtarëve të caktuar dhe për fuqitë dhe dobësitë e një sistemi gjyqësor. Vlerësimi mund të ndihmojë në identifikimin e kandidatëve më të mirë për promovim, duke ruajtur apo edhe përmirësuar cilësinë e një sistemi gjyqësor.

D. Parimet dhe procedura e inspektimit

Cilësia e drejtësisë nuk mund të kuptohet sikur të ishte sinonim i thjesht “produktivitetit” të sistemit gjyqësor. CCJE-ja beson se cilësia, jo thjesht sasia, e vendimeve të një gjyqtari duhet të jetë në qendër të vlerësimit individual. Në opinionin 11/2008, CCJE-ja diskutoi rëndësinë e gjykimeve me cilësi të lartë. Për të vlerësuar cilësinë e vendimit të një gjyqtari, vlerësuesit duhet të përqendrohen në metodologjinë që një gjyqtar zbaton në punën e tij/saj. Vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë të gjitha aspektet që përbëjnë performancë të mirë gjyqësore, në veçanti njohuritë ligjore, aftësitë e komunikimit, kujdesin, efikasitetin dhe integritetin. Për ta bërë këtë, vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë të gjithë diapazonin e punës së një gjyqtari në kontekstin në të cilin ajo punë kryhet. Prandaj, CCJE-ja vazhdon ta konsiderojë problematike bazimin e rezultateve të vlerësimit në numrin ose përqindjen e vendimeve të prishura në apel, përveç rasteve kur numri dhe mënyra e prishjeve tregojnë se gjyqtarit i mungojnë njohuritë e nevojshme për ligjin dhe procedurën. Vihet re se Raporti i ENCJ-së 2012-2013 ka të njëjtin këndvështrim. Opinioni 11/2008 i CCJE-së “Cilësia e vendimeve gjyqësore” vëren se vlerësimi i cilësisë së vendimeve gjyqësore duhet të bëhet mbi të gjitha mbi bazën e parimeve

themelore të KEDNJ-së. Nuk mund të bëhet vetëm në kuadrin e konsideratave të natyrës ekonomike ose menaxheriale. Përdorimi i metodave ekonomike duhet të merret në konsideratë me kujdes. Roli i gjyqësorit është mbi të gjitha të zbatojë dhe t'i japë fuqi ligjit dhe nuk mund të analizohet siç duhet në aspektin e efikasitetit ekonomik. Çdo sistem vlerësimi i cilësisë duhet të synojë rreptësisht promovimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe jo të shërbejë thjesht si një mjet burokratik apo qëllim në vetvete. Nuk është instrument i kontrollit të jashtëm të gjyqësorit.

Sipas CCJE-së, vlerësimi formal individual i gjyqtarëve, aty ku ekziston, duhet të ndihmojë në përmirësimin dhe ruajtjen e një sistemi gjyqësor të cilësisë së lartë për të mirën e qytetarëve të shteteve anëtare. Kjo duhet të ndihmojë në ruajtjen e besimit të publikut në gjyqësor. Kjo kërkon që publiku të mund të kuptojë parimet dhe procedurën e përgjithshme të procesit të vlerësimit. Prandaj, kuadri procedural dhe metodat e vlerësimit duhet të jenë në dispozicion të publikut. Gjithashtu, sipas CCJE-së, procesi i vlerësimit individual për qëllime karriere ose promovimi nuk duhet të marrë parasysh pikëpamjet e publikut për një gjyqtar. Procesi dhe rezultatet e vlerësimeve individuale, në parim, duhet të mbeten konfidenciale dhe nuk duhet të bëhen publike. Një veprim i tillë pothuajse me siguri do të rrezikonte pavarësinë e gjyqësorit, për arsyen e qartë se publikimi mund të diskreditojë gjyqtarin në sytë e publikut dhe ndoshta ta bëjë atë të pambrojtur ndaj përpjekjeve për të pasur ndikim tek ai. Gjithashtu, publikimi mund të nënkuptojë se gjyqtari i nënshtrohet sulmeve verbale ose sulmeve të tjera.

Në opinionin 19/2016 “Roli i kryetarëve të gjykatave” CCJE-ja deklaroi se detyra kryesore e kryetarëve të gjykatave duhet të mbetet veprimi në çdo kohë si mbrojtës të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve dhe të gjykatës në tërësi. Kryetarët e gjykatave janë përgjegjës për menaxhimin e funksionimit të gjykatës, duke përfshirë menaxhimin e stafit të gjykatës dhe burimeve materiale

dhe infrastrukturës. Është thelbësore që ata të kenë fuqitë dhe burimet e nevojshme për ta përmbushur këtë detyrë në mënyrë efikase. Në përgjithësi, performanca e kryetarëve të gjykatave i nënshtrohet vlerësimit në të njëjtën mënyrë si puna e gjyqtarëve të zakonshëm, me të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme për t'u respektuar. Gjithashtu, bazuar në rolin specifik të kryetarëve të gjykatave, vlerësimi mund të bëhet për të vlerësuar punën e përgjithshme të kryer, duke përfshirë funksionet menaxheriale, në mënyrë që të eksplorohet mundësia e përmirësimeve dhe për të mësuar nga përvoja. Një vlerësim i tillë duhet të jetë i përshtatshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarëve. Po ai vëren se kryetarët e gjykatave më të larta kanë role dhe detyra të ndryshme që rrjedhin nga roli specifik i këtyre gjykatave dhe roli i tyre si figurë është disi personifikimi i të gjithë sistemit gjyqësor, veçanërisht në ato shtete anëtare ku ka një Gjykatë të Lartë.

Në opinionin 21/2018 “Parandalimi i korrupsionit ndërmjet gjyqtarëve” CCJE-ja vëren se një sistem vlerësimi është një mjet shumë efikas për t'i bërë vendimet e ngritjes dhe avancimit më objektive dhe të besueshme. Kjo gjithashtu kontribuon në transparencën e sistemit gjyqësor në tërësi. Korrupsioni ndërmjet gjyqtarëve është një nga kërcënimet kryesore për shoqërinë dhe për funksionimin e një shteti demokratik. Ai dëmton integritetin gjyqësor, i cili është themelor për shtetin e së drejtës dhe është një vlerë thelbësore e Këshillit të Evropës.

E. Ligji i ri në Greqi për organizimin e gjykatave dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Kushtetuta e Greqisë parashikon se drejtësia do të administrohet nga gjykata të përbëra nga gjyqtarë të rregullt, të cilët gëzojnë pavarësi funksionale dhe personale (neni 87 paragrafi 1). Gjyqtarët e rregullt do të inspektohen nga gjyqtarë të rangut të lartë (neni 87 paragrafi 3). Këtë muaj në Greqi është publikuar ligji i ri për organizimin e gjykatave dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Parlamenti e votoi ligjin duke marrë parasysh tendencat ndërkombëtare dhe evropiane për pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Veçanërisht në fushën e vlerësimit dhe inspektimit ka dispozita të cilat lejojnë shqyrtimin thelbësor dhe të thelluar nga gjyqtarët inspektues në dy nivele: në nivel gjyqtarësh dhe në nivel gjykatash si organizata. Në nivel gjyqtarësh, gjyqtarët inspektues shqyrtojnë sasinë dhe cilësinë e punës gjyqësore, bazuar në kritere specifike. Ata shqyrtojnë edhe performancën e gjyqtarëve që kanë përgjegjësinë e administrimit të gjykatave. Raportet e inspektimit kanë arsye për secilin kriter dhe gjyqtari i vlerësuar mund të ankohet në bordin e inspektimit.

Ka gjyqtarë inspektues për çdo juridiksion. Për gjyqtarët dhe prokurorët civilë dhe penalë, gjyqtarët inspektues janë anëtarë të Areios Pagos, gjykatës së lartë të drejtësisë civile dhe penale. Për drejtësinë administrative, gjyqtarët inspektues janë anëtarë të Këshillit të Shtetit. Seancat plenare të gjykatave të larta sigurojnë barazi në vlerësimin e gjyqtarëve me udhëzimet që zbatohen nga gjyqtarët inspektues. Bordi i inspektimit mbledh raportet e inspektimit, bën vërejtje krahasuese duke marrë parasysh raportet e viteve të mëparshme dhe formulon propozime për Ministrin e Drejtësisë për sistemin gjyqësor.

F. Konkluzione

Pushteti gjyqësor është pjesë e pushtetit shtetëror dhe gjyqtarët janë funksionarë shtetërorë, por detyra e tyre nuk është të ndjekin vendimet e pushteteve të tjera shtetërore. Detyra e tyre është të kontrollojnë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.

Pushteti gjyqësor është shumë i lidhur me të drejtën themelore të mbrojtjes gjyqësore. Aksesit të gjithëve në gjykata garanton ushtrimin e të gjitha të drejtave themelore dhe lirive themelore.

ENCJ-ja në deklaratën e Sofjes vë në dukje se një gjyqësor i pavarur dhe i përgjegjshëm është thelbësor për ofrimin e një sistemi drejtësie efikas dhe efektiv për të mirën e qytetarëve dhe është një tipar i rëndësishëm i shtetit të së drejtës në shoqëritë demokratike. Gjyqësori duhet të jetë i përgjegjshëm, të jetë në përputhje me udhëzimet etike dhe t'i nënshtrohet: (a) një sistemi vlerësimi që motivon gjyqtarin të përmirësojë performancën e tij; (b) një sistemi disiplinor të paanshëm, i cili vendos sanksione kur gjyqtari tregon sjellje që është e padenjë për pozicionin e tij në një shtet dhe shoqëri demokratike.



SESIONI III:

ROLI I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT SI GARANTUES PËR MIRËFUNKSIONIMIN DHE PAVARËSINË E SISTEMIT TË DREJTËSISË, NË PËRPTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE. METODAT DHE SFIDAT E SË ARDHMES.

ROLI I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT, SI NJË GARANT I MIRËFUNKSIONIMIT DHE PAVARËSISË SË SISTEMIT TË DREJTËSISË NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA EVROPIANE.



Valérie Delfosse,

Magjistrate (Gjyqtare)

Kryetare e Komisionit Hetimor

Frankofon pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Belgjikë

Znj. Valérie Delfosse është magjistrate pranë Gjykatës së Policisë së Brukselit prej vitit 2013. Ajo trajton çështjet e veprave penale të trafikut, rastet e përgjegjësive civile të lidhura me aksidentet rrugore, si dhe apelimet ndaj gjobave administrative.

Përpara se të bëhej gjyqtare, përgjatë periudhës kohore 2001-2011 znj. Delfosse ka ushtruar detyrën zëvendësprokurores publike në Bruksel, si dhe gjatë periudhës 2011-2013 ka drejtuar Prokurorinë e Brukselit. Znj. Delfosse ka qenë anëtare e Këshillit Konsultativ të Magjistraturës nga viti 2014 deri në vitin 2020, si dhe aktualisht është pedagoge në shkollën e policisë së Brukselit (procedurë penale) dhe trajnere në Institutin e Trajnimit Gjyqësor (procedurë civile, e drejtë civile dhe procedurë penale).

Nga muaji dhjetor i vitit 2020, znj. Delfosse është kryetare e Komisionit Këshillimor dhe Hetimor të

Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këtë funksion ajo e kryen me kohë të plotë, për një periudhë 4 vjeçare. Në këtë cilësi, prej shkurtit të vitit 2022, ajo është menaxhere e projektit për binjakëzimin mes Belgjikës dhe Marokut. Ky binjakëzim është pjesë e programit të bashkëpunimit midis Marokut e Bashkimit Evropian dhe synon t'i sigurojë Marokut ekspertizë evropiane, duke pasur si synim forcimin e pavarësisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor të Marokut.

I. Belgjika

Belgjika është një shtet i të drejtës, në themel të të cilit qëndron ndarja e pushteteve (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor). Akti themelues i Belgjikës është Kushtetuta e vitit 1831. Belgjika është një monarki kushtetuese. Ajo renditet ndërmjet vendeve themeluese të Këshillit të Evropës. Në këtë cilësi, ajo ka nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). E drejta belge dhe, veçanërisht, rregullat e procedurës civile dhe penale frymëzohen nga neni 6 i KEDNJ-së që sanksionon të drejtën për një proces të rregullt (veçanërisht paanshmërinë dhe pavarësinë a magjistratëve).

II. Pushteti Gjyqësor: Pavarësia e magjistratëve

Neni 151 i Kushtetutës sanksionon pavarësinë e magjistratëve. § 1 parashikon që: *“Gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e kompetencave të tyre juridiksionale. Prokuroria është e pavarur në ushtrimin e hetimeve dhe ndjekjes individuale penale, pa prekur të drejtën e Ministrit kompetent për të urdhëruar ndjekje penale dhe për të nxjerrë direktiva shtrënguese të politikës penale, përfshirë në fushën e politikës së hetimit dhe ndjekjes penale”.*

§ 2 krijon Këshillin e Lartë të Drejtësisë: *“Për të gjithë Belgjikën ka një Këshill të Lartë të Drejtësisë. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë respekton pavarësinë e parashikuar në*

§ 1.” (ligji i vitit 1998).

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim CSJ): *www.csj.be*

A. Konteksti i krijimit të CSJ

Këshilli i Lartë i Drejtësisë u krijua në vitin 1998 në vazhdim të “Marshimit të Bardhë” të vitit 1996 (lëvizje qytetare e fuqishme në vijim të çështjes Dutroux), por planet për krijimin e tij janë shumë më të hershme. Qeveria dhe Parlamenti e kishin kuptuar më parë thyerjen e rëndë të besimit ndërmjet qytetarit, policisë dhe autoriteteve gjyqësore.

Drejtuesit politikë vendosën të krijonin një Këshill të Lartë të Drejtësisë, në të cilin, përveç magistratëve, bëjnë pjesë edhe anëtarë të shoqërisë civile. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (CSJ) mund të cilësohet, me të drejtë, si një forum demokratik ku shprehen të gjitha opinionet mbi funksionin gjyqësor, për shkak të barazisë së tij të dyfishtë gjuhësore dhe socio-profesionale.

CSJ funksionon në mënyrë krejtësisht të pavarur nga pushteti ekzekutiv, nga pushteti legjislativ dhe nga pushteti gjyqësor. Pra, CSJ është një organ federal, i mbështetur fort në Kushtetutë, autonom në funksionimin e tij dhe në marrjen e iniciativave.

B. Objektivat e CSJ

Objektivi i krijimit të CSJ është të forcojë besimin e qytetarit te drejtësia dhe të përmirësojë funksionimin e rendit gjyqësor. Roli i CSJ është të hedhë një vështrim objektiv dhe të pavarur mbi funksionimin e rendit gjyqësor duke konkretizuar emërimet dhe caktimet e magistratëve (ky është roli i komisioneve të emërimeve dhe caktimeve) dhe duke zhvilluar kontrollin e jashtëm të pushtetit gjyqësor (ky është roli i komisioneve këshillimore dhe hetimore).

C. Kompetencat e CSJ


Fusha e kompetencave të CSJ është e dyfishtë:

1. Komisioni i tij i emërimeve dhe caktimeve (CND) organizon përzgjedhjen e magistratëve (organizimi i testeve me gojë dhe me shkrim në kuadër të provimit të aftësisë ose të konkursit) dhe emërimin e magistratëve në vendet vakante, si dhe caktimin e magistratëve në postet e drejtuesit.
2. Komisioni i tij i përbashkët hetimor dhe këshillimor (CAER) ushtron kontrollin e jashtëm të rendit gjyqësor (auditimin, hetimin e posaçëm, ankesat) dhe ka një kompetencë këshillimore.

CSJ nuk ka asnjë kompetencë në fushën penale, as disiplinore. Fusha disiplinore është kompetencë e juridiksioneve disiplinore. Në Belgjikë ka dy gjykata disiplinore të shkallës së parë (një frëngjishtfolëse dhe një holandishtfolëse) dhe dy gjykata disiplinore të apelit (një frëngjishtfolëse dhe një holandishtfolëse). Këto janë juridiksione jo-të përhershme, të përbëra nga magistratë efektive që bëjnë pjesë në to pa pagesë, krahas veprimtarisë së tyre kryesore.

Përveç dy kompetencave të tij kryesore, CSJ merret gjithashtu me tematika që figurojnë në planin e tij disavjeçar (kërekesat për magistratë, barometri i Drejtësisë, digjitalizimi i Drejtësisë, mënyrat alternative të zgjidhjes së konflikteve).

D. Struktura dhe përbërja e CSJ




CSJ është i përbërë nga 44 anëtarë, nga të cilët 22 janë magjistratë të zgjedhur nga kolegët e tyre, dhe 22 jo-magjistratë (avokatë, profesorë universiteti, anëtarë të shoqërisë civile). 22 anëtarë janë frëngjishtfolës dhe 22 janë holandishtfolës. Të 44 anëtarët punojnë në kuadër të një mandati 4-vjeçar. Aktualisht, mandati ka filluar më 10 dhjetor 2020 dhe do të përfundojë më 10 dhjetor 2024. 4 anëtarë nga të 44 formojnë Byronë dhe punojnë aty me kohë të plotë. Byroja është një organ menaxhimi dhe ekzekutimi. Ajo mbledhet çdo javë.

Kryesia e CSJ sigurohet me radhë gjatë 4 viteve nga të 4 anëtarët e Byrosë.

Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i CSJ. Ajo mbledhet mesatarisht 3-4 herë në vit. Të 44 anëtarët janë të shpërndarë në 4 komisione që mbledhen mesatarisht çdo javë. (Komisioni i emërimeve dhe caktimeve frëngjishtfolës - CND, Komisioni i emërimeve dhe caktimeve holandishtfolës - BAC, komisioni këshillimor dhe hetimor frëngjishtfolës - CAE - dhe komisioni këshillimor dhe hetimor holandishtfolës - AOC). Të 44 anëtarët përfitojnë nga mbështetja e administratës së CSJ, anëtarët e së cilët janë të përhershëm (+/-50 persona).

E. Komisioni i përbashkët hetimor dhe këshillimor i CSJ

1. Përbërja e CAER



2. Funksionimi i CAER

CAER mbledhet sa herë është e nevojshme dhe të paktën dy herë në vit. Kryetari e thërret CAER kur e kërkojnë të paktën katër anëtarë. Në praktikë, ai mbledhet periodikisht çdo 2-3 javë. Kryesia e CAER gjatë mandatit të 2020-2024: (i) 10.12.2020-9.12.2022: Frank FRANCEUS; si dhe (ii) 10.12.2022-9.12.2024: Valérie DELFOSSE.

3. Kompetencat e CAER

CAER është kompetent për të dhënë opinione dhe për të bërë propozime. Ai kryen hetime të posaçme në rast mosfunksionimi dhe auditime të sistemit gjyqësor. Ai është i pajisur dhe me kompetenca të tjera, të tilla si mbikëqyrja dhe promovimi i kontrollit të brendshëm, përcaktimi i profileve të përgjithshme të drejtuesve dhe formulimi i rekomandimeve. Në fund, ai trajton për çdo komision, ankesat e palëve ndërgjyqësve.

a) Kompetenca këshillimore

CAER përgatit opinionet dhe propozimet mbi ligjet që kanë të bëjnë me funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor. Kërkesa për opinion vjen shpesh nga Ministri i Drejtësisë dhe ndonjëherë nga Dhoma.

CAER nuk është e detyruar të japë një opinion. Ai mund të mos japë një opinion, sepse nuk ka kapacitetin e mjaftueshëm në një moment të caktuar ose sepse afati i dhënë është shumë i ngushtë, ose sepse ligji nuk ka të bëjë me sistemin gjyqësor. Opinioni nuk ka efekt pezullues mbi procesin legjislativ dhe nuk është detyrues. Kur një opinion hartohet dhe miratohet nga CAER, pastaj nga asambleja e përgjithshme, ai u komunikohet palëve të interesuara (ministër, dhomë, senat, kryetarë të parë dhe prokurori e përgjithshme) dhe, sipas rastit, autoriteteve të tjera të interesuara (Këshilli konsultativ i magjistraturës, Kolegji i gjykatave dhe tribunalëve, Kolegji i Prokurorisë, apo tjetër).

Opinioni botohet gjithashtu në faqen web të CSJ, në llogarinë Twitter dhe llogarinë LinkedIn të CSJ dhe ndonjëherë është objekt i një komunikate për shtyp.

b) Hetimet e posaçme

CAER mund të ndërmarrë një hetim të posaçëm mbi funksionimin e sistemit gjyqësor (259bis16 i Kodit Gjyqësor) në lidhje me disa mosfunksionime ose shkelje, me përjashtim të çdo kompetence

lidhur me përgjegjësi penale ose disiplinore.

Që prej 1 janarit 2020, dosjet në proces mund të konsultohen (p. sh., EP Chovanec), pa ndërhyrje, as ndikim në përmbajtjen e tyre. CAER mund të vendosë të ndërmarrë një hetim të posaçëm ose ex-officio (për shembull, në vijim të një ankese ose në bazë të informacioneve të nxjerra në media), ose me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, të Dhomës ose të Senatit. Në 22 vite, CAER ka kryer 14 hetime të posaçme, nga të cilat, 7 me iniciativën e tij dhe 7 me kërkesë të ministrit.

Shembull: hetimi mbi çështjen Chovanec dhe mbi çështjen Steve B. Drejtuesi (= drejtuesi i juridiksionit ose drejtuesi i një prokurorie) është në parim ai që drejton hetimin, por në praktikë, është CAER që e kryen atë. Konkretisht, janë audituesit që shkojnë në terren dhe këtë e bëjnë nën drejtimin e një magjistrati anëtar të CAER. Audituesit ndjekin një metodologji të ngjashme me atë që përdoret në auditime dhe kjo, duke respektuar sekretin profesional dhe RGPD.

Pas hetimit hartohet një raport që miratohet nga CAER dhe më pas nga asambleja e përgjithshme. Raporti botohet në faqen e CSJ. Raporti përmban konstatime, një analizë, një vlerësim dhe rekomandime në lidhje me subjektet e interesuara (juridiksione, prokurori, Kolegje, Ministër, IFJ, Ligjvënës, SPF i Drejtësisë, apo tjetër) me qëllim që drejtësia të mund të funksionojë në mënyrë optimale. Rekomandimet nuk janë detyruese, por kanë një peshë morale dhe nuk cenojnë në asnjë rast pavarësinë e magjistratëve. Një ndjekje e rekomandimeve (follow-up) mund të kryhet rreth 2 vite më pas, për të verifikuar se çfarë iniciativash janë marrë nga strukturat të cilave iu janë drejtuar rekomandimet për t'i zbatuar ato. Më pas hartohet një raport i ri. Shembull: ndjekja e EP në çështjen Steve B.

c) **Auditimet**

Në ushtrimin e kompetencave të tij, CAER ka të drejtë të kryejë një auditim të funksionimit të sistemit gjyqësor. Që prej 1.1.2020, dosjet në proces mund të shqyrtohen, megjithatë pa mundur të ndërhyhet në trajtimin e themelit të dosjeve. Dallimi me një hetim të posaçëm është se ky i fundit ka të bëjë me një mosfunksionim ose një shkelje specifike.

Temat e auditimit zgjidhen nga CAER dhe duhet të paraqesin një interes për sistemin gjyqësor. Tema mund të vijë gjithashtu nga kërkesa e një juridiksioni. Për shembull, kryetari i parë i Gjykatës së Apelit Bruksel i drejtoi së fundmi kërkesë CSJ-së për të kryer një auditim të gjykatës me qëllim propozimin e rekomandimeve për të eliminuar vonesat gjyqësore të akumuluar që prej 20 vitesh në Gjykatë.

CAER planifikon auditimet dhe i kryen ato duke ndjekur një metodologji të saktë që rimerr standardet ndërkombëtare në fushën e auditimit (standardet Intossai). Kjo metodologji është përshtatur si një udhërrëfyes praktik për përdorim të brendshëm.

Konkretisht, qëllimi i auditimit përcaktohet nga CAER, pastaj audituesit ngarkohen me fazën e terrenit (intervista). Më tej, audituesit hartojnë një raport, i cili diskutohet nga CAER që e miraton më pas. Asambleja e Përgjithshme nuk është kompetente për të miratuar raportet e auditimit. Raporti i auditimit përmban rekomandime në drejtim të aktorëve të interesuar. (SPF i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Kolegjet, ligjvënësi, IFJ, drejtuesit, apo tjetër). Këto rekomandime nuk janë detyruese dhe respektojnë pavarësinë e magjistratëve.

Brenda dy viteve mund të realizohet një ndjekje e rekomandimeve (*folloë-up*) për të verifikuar se çfarë iniciativash janë marrë nga strukturat të cilave i`u janë drejtuar rekomandimet për t'i zbatuar ato.

Shembull: auditim mbi ndikimin e krizës Covid mbi Drejtësinë; mbi sistemin e vlerësimit të magistratëve; kontrollin e administrimit të pronave; prokurorinë Namur, Gjykatën e Apelit Bruksel.

Raportet e auditimeve ashtu si dhe raportet e hetimeve të posaçme botohen në faqen e CSJ, por mund të vendoset që disa raporte të botohen pjesërisht.

d) Trajtimi i ankesave

CAER është kompetent për çdo komision për të marrë dhe për të shqyrtuar ankesat e depozituara nga e palëve ndërgjyqësve. Ankesat janë thelbësore për të kuptuar perceptimet e qytetarit dhe për të nxjerrë mësimë prej tyre. Për të qenë e pranueshme, një ankesë duhet të jetë me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga ankuesi dhe të përmbajë identitetin e tij të plotë. Një ankesë anonime është e papranueshme.

Një ankesë nuk do të trajtohet nëse ajo: *(i)* i takon kompetencave të karakterit penal ose disiplinor të instancave të tjera; *(ii)* ka të bëjë me përmbajtjen e një vendimi gjyqësor; *(iii)* nëse objekti i saj mund të arrihet ose mund të ishte arritur nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së rekursit në mënyrë të zakonshme ose të jashtëzakonshme; *(iii)* është trajtuar ndërkohë dhe nuk përmban asnjë element të ri; *(iv)* është dukshëm e pabazuar.

Vendimi për të mos e trajtuar një ankesë duhet të jetë i arsyetuar dhe nuk ka asnjë mundësi rekursi. Kur është rasti, ankuesi drejtohet drejt instancave kompetente që duhet të informojnë në mënyrë të arsyetuar komisionet këshillimore dhe hetimore lidhur me ecurinë e trajtimit të ankesës.

Ankesat u bëhen të ditura drejtuesve të juridiksionit ose të prokurorisë dhe drejtuesve ose eprorëve sipas hierarkisë të personave që janë objekt i ankesës. Personat që janë njoftuar për ankesën kanë të drejtë të bëjnë deklarime me gojë ose me shkrim. Komisionet këshillimore dhe hetimore mund t'u kërkojnë këtyre

personave më shumë informacione, me kusht që të njoftojnë njëkohësisht drejtuesin e tyre ose eprorin sipas hierarkisë.

Komisionet këshillimore dhe hetimore informojnë me shkrim ankuesin lidhur me ecurinë e trajtimit të ankesës. Kur ankesa është e bazuar, komisionet këshillimore dhe hetimore mund t'u drejtojnë instancave të interesuara dhe Ministrin të Drejtësisë çdo rekomandim që mund të ofrojë një zgjidhje për problemin e ngritur, si dhe çdo propozim që synon të përmirësojë funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor.

Shembull: Raporti në lidhje me mirëqenien e personave të burgosur. Çdo komision këshillimor dhe hetimor harton të paktën një herë në vit një raport me shkrim mbi ndjekjen e ankesave të marra.

Në raportin e botuar në vitin 2021, mund të shihet se në vitin 2020, CSJ ka mbyllur 254 dosje ankesash. Ankesat e pranueshme përmbanin gjithsej 496 pretendime, ku 35,28 % e këtyre pretendimeve kishin të bënin me vendime të marra nga magjistratë dhe të kontestuara nga ankuesi. CSJ deklaroi 36 pretendime të bazuara, të cilat konsistojnë në drejtim të: (i) ngadalësisë së procedurës; (ii) afatit të gjatë për zgjidhjen e çështjes; (iii) ngadalësisë në kohën e marrjes së vendimit; (iv) mungesës së përgjigjeve ndaj kërkesave; (v) sjelljes së njëanshme të magjistratit.

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË KONTROLLIT DHE INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË NËPËRMJET APLIKIMIT TË TEKNOLOGJIVE TË REJA



Amparo Camazon Linacero

*Kryetare e Shërbimit të Inspektimit,
Këshilli i Lartë Gjyqësor, Spanjë*

Znj. Amparo Camazon Linacero është pjesë e sistemit gjyqësor që nga viti 1980. Ajo është emëruar fillimisht pranë Kryesisë së Seksionit të 14-të të Gjykatës së Rrethit Madrid dhe më pas në përputhje me Vendimin e datës 27 mars të Mbledhjes Plenare të Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit (botuar në Buletinin Zyrtar të Shtetit, datë 28 mars) ka ushtruar detyrën e magjistrates pranë institucionit të Shërbimit të Inspektimit. Me vendimin e datës 6 shkurt 2020 të Mbledhjes Plenare të Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit, znj. Amparo Camazon Linacero është emëruar Shefe e Shërbimit të Inspektimit.



Elena Burgos Herrera

Inspektore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Spanjë

Znj. Elena Burgos Herrera është pjesë e sistemit gjyqësor që nga viti 2000. Ajo është emëruar fillimisht pranë Gjykatës Sociale nr. 21 të Madridit dhe më pas në përputhje me vendimin e datës 24 shkurt 2016 të Mbledhjes Plenare të Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor (botuar në Buletinin Zyrtar të Shtetit, datë 7 Mars) ka ushtruar detyrën e inspektore së deleguar pranë Shërbimit të Inspektimit. Me vendimin nr. 8, datë 27 shkurt 2020, të Mbledhjes Plenare të Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor, znj. Elena Burgos Herrera është emëruar Ndihmës Magjistrate në institucionin e Shërbimit të Inspektimit.

I. Misioni i Shërbimit të Inspektimit CGPJ në Spanjë

Detyra e Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit (këtu e në vijim CGPJ) të Spanjës është të kontrollojë funksionimin e gjykatave dhe tribunaleve nëpërmjet kryerjes së inspektimeve, të cilat janë miratuar nga ana e Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor. Në të njëjtën kohë, objekt i këtij kontrolli është edhe përmbushja e detyrave të personelit gjyqësor duke i kushtuar një vëmendje të veçantë kërkesave për një trajtim të shpejtë dhe efikas të të gjitha çështjeve gjyqësore.

Në këtë kuadër, një nga funksionet kryesore të shërbimeve të inspektimit është kryerja e inspektimeve, të zakonshme, të jashtëzakonshme, të parashikuara më parë ose inspektime të çastit, të cilat kryhen zakonisht në vend nga një grup i përbërë nga inspektorë dhe juristë të deleguar (*të paktën një nga çdo kategori*), të cilët vizitojnë organin gjyqësor objekt inspektimi për të zhvilluar takime me personat të cilët shërbejnë në këto organe

gjqësore (*gjqtarë, magistratë, juristë të administratës së sistemit të drejtësisë po edhe zyrtarë të tjerë*), të inspektojnë gjendjen e objekteve, të shqyrtojnë proceset gjyqësore, librat dhe llogaritë dhe gjithçka tjetër që lidhet me veprimtarinë e organit gjyqësor.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se inspektimi nuk mbulon çështje të natyrës juridike, as mënyrën se si gjyqtarët dhe gjykatat zbatojnë dhe interpretojnë ligjet dhe sistemin ligjor. Gjyqtarët dhe gjykatat i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjit (nenet 9.1 dhe 117.1 të Kushtetutës dhe neni 1 të ligjit Organik për Pushtetin Gjyqësor (LOPJ)) dhe nuk mbajnë në konsideratë asnjë udhëzim të natyrës së përgjithshme apo të vecantë të Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor drejtuar gjyqtarëve apo magistratëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin të normave juridike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore, për sa parashikohet shprehimisht në nenin 12.3 të LOPJ-së.

II. Zbatimi dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në administrimin e drejtësisë.

Në dekadën e fundit, në Spanjë, është marrë një angazhim për zbatimin dhe zgjerimin e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në Administrimin e Drejtësisë.

Hapat e parë u hodhën në ligjin Organik 16/1994, të 8 nëntorit, i cili ndryshoi ligjin Organik 6/1985, të 1 korrikut për Gjyqësorin, i cili prezantoi, për herë të parë në sistemin tonë juridik, mundësinë e përdorimit teknik të mjeteve elektronike dhe kompjuterike për zhvillimin e veprimtarisë dhe ushtrimin e funksioneve të gjykatave dhe tribunaleve. Reforma përfshinte mundësinë e sigurimit të dokumenteve apo komunikimeve nëpërmjet përdorimit teknik të mjeteve elektronike dhe kompjuterike me kusht që të garantohej autenticiteti, efikasiteti, integriteti dhe respektimi i kërkesave të ligjeve procedurale.

Më 22 prill 2002, Seanca Plenare e Kongresit të Deputetëve miratoi një propozim jo legjislativ për Kartën e të Drejtave të Qytetarëve para gjykatave. Kjo Kartë parashikon në preambulën e saj se, në prag të shekullit të njëzetënjë, shoqëria spanjolle kërkoi urgjentisht një sistem drejtësie më të hapur, i cili do të mund t'u përgjigjej qytetarëve me shpejtësi, cilësi dhe efikasitet më të madh, duke përfshirë metoda më moderne dhe të avancuara organizimi dhe mjete procedurale. E titulluar “Drejtësia moderne e hapur për qytetarët”, pjesa e parë e Kartës përcakton parimet që duhet të frymëzojnë arritjen e këtij objekti: drejtësi transparente dhe e kuptueshme. Paragrafi 21, duke u thelluar në nevojën që drejtësia të jetë teknologjiksht e avancuar, njuh të drejtën “për të komunikuar me Administratën e Drejtësisë me anë të postës elektronike, videokonferencës dhe mjeteve të tjera telematike në përputhje me dispozitat e ligjeve procedurale”.

Në vijim, u miratua ligji 18/2011, i datës 5 korrik, që rregullon përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në Administratën e Drejtësisë, i cili, ndër të tjera, parashikon krijimin e dosjes elektronike gjyqësore e cila përbëhet nga tërësia e dokumenteve elektronike që i korrespondojnë një procedure gjyqësore, pavarësisht nga lloji i informacionit që përmban.

Që nga ky moment, të gjitha strukturat e sistemit të drejtësisë kanë bërë një përpjekje të rëndësishme për zbatimin dhe vendosjen e dosjes elektronike gjyqësore, gjë e cila ka sjellë si pasojë që dosjet që duhen shqyrtuar përgjatë zhvillimit të inspektimeve në vend (face to face) kanë qenë në formë elektronike dhe jo fizikisht.

III. Inspektimet telematike

Në këtë kuadër, që nga viti 2018, shërbimi i inspektimit po vlerësonte mundësinë e përdorimit të teknologjive të reja në kryerjen e inspektimeve dhe futjen e një modaliteti të ri të inspektimeve: “Inspektimet Telematike”.

Pengesa kryesore për zbatimin e tij ishte organizimi unik i drejtësisë në Spanjë, në të cilin u transferuan dhe marrin pjesë CGPJ, Ministria e Drejtësisë dhe komunitetet autonome që kanë kompetenca në çështjet e Administrimit të Drejtësisë (Andaluzia, Aragoni, Principata e Asturias, Ishujt Kanarie, Katalonja, Cantabria, Galicia, Madridi, Navarra, Vendi Bask, La Rioja dhe Komuniteti i Valencia-s).

Në organizimin e sipërpërmendur është Ministria e Drejtësisë, në lidhje me komunitetet autonome që nuk kanë transferime në çështjet e Administrimit të Drejtësisë (Ishujt Balearik, Castilla-La Mancha, Castilla y León, Extremadura dhe Rajoni i Murcias) dhe komunitetet autonome me kompetenca të transferuara janë mbajtësit e mjeteve materiale të gjykatave dhe tribunaleve, duke përfshirë sistemet e ndryshme të menaxhimit procedural (GSP) në të cilat integrohen dhe përpunohen dosjet elektronike gjyqësore që përmbajnë të gjithë informacionin në lidhje me procedurat gjyqësore, në mënyrë që të gjithë anëtarët e organit gjyqësor të përfshirë në përpunimin e një procedure të caktuar mund të aksesojnë informacionin që lidhet me garancitë e rezervimit, kontrollin dhe konfidencialitetin.

Në këto kushte, në mënyrë që shërbimi i inspektimit të KGPJ-së të kishte akses në dosjet gjyqësore, ishte thelbësore nënshkrimi i marrëveshjeve me Ministrinë e Drejtësisë dhe komunitetet autonome me kompetenca të deleguara në çështjet e Administrimit të Drejtësisë. Në bazë të këtyre marrëveshjeve inspektorët dhe juristët e shërbimit të inspektimit, të ngarkuar në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, mund të aksesojnë në distancë, nga pajisjet e tyre kompjuterike, dosjet gjyqësore dhe librat elektronikë të secilës prej gjykatave dhe tribunaleve që kanë selitë e tyre në territorin e tyre. Në të njëjtën kohë, në rastin konkret u zbatua një mënyrë e re inspektimi (inspektimet telematike), nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, si dhe u soll një risi dhe një përparim i madh për organizimin e shërbimit të inspektimit, ku dhe

për të vlerësuar situatën dhe për të përcaktuar mosfunksionimet e organit të inspektuar, procedimet gjyqësore dhe librat elektronikë u ekzaminuan elektronikisht apo intervistat u zhvilluan nëpërmjet videokonferencës, me të njëjtat rezultate sikur inspektimet të ishin zhvilluar në vend (face to face), por pa qenë e nevojshme që grupi i inspektimit të ishte i pranishëm në ambientet e organeve gjyqësore të inspektuara.

Si pasojë e shpalljes së gjendjes së pandemisë, u promovua nënshkrimi i marrëveshjeve të sipërpërmendura dhe në fillim të muajit korrik të vitit 2020, u finalizua përpunimi i një protokolli për realizimin e inspektimeve telematike, i cili u miratua nga marrëveshja 6-8 e Komisionit të Përhershëm datë 16 korrik 2020. Që nga ky moment, shërbimi i inspektimit ka kryer inspektime të shumta telematike (53 në vitin 2020 dhe 25 në vitin 2021) në ato territore ku ka një marrëveshje (Andaluzia, Aragoni, Asturias, Cantabria, Komuniteti Valencias, Galicia, La Rioja dhe Navarra), me shumë rezultate të mira.

U evidentua veçanërisht dobia e zbatimit dhe kryerjes së inspektimeve telematike duke lejuar vazhdimin e kryerjes së veprimtarisë parësore të shërbimit të inspektimit, gjatë situatës së emergjencës shëndetësore dhe shpalljes së gjendjes së alarmit, duke eliminuar zhvendosjet dhe duke respektuar masat sanitare të rekomanduara nga administrata shëndetësore, me një kosto të ulët. Për këtë arsye, vlerësimi i kësaj mënyre të re të kryerjes së inspektimeve është shumë pozitive.

IV. Inspektimet virtuale

Inspektimet telematike nuk janë i vetmi lloj inspektimi në të cilin teknologjitë e informacionit përdoren në Spanjë.

Në vitin 2012 u prezantuan të ashtuquajturat inspektime virtuale, të cilat kryhen dy herë në vit dhe përfshijnë vlerësimin e të

gjitha organeve gjyqësore të territorit kombëtar (me përjashtim të Gjykatës së Lartë dhe gjykatave e tribunaleve ushtarake), nëpërmjet informacioneve të përfshira në Këshillin e Përgjithshëm të Gjyqësorit, në thelb, atë që figuron në buletinet statistikore dhe në dokumentet e Këshillit. Ky proces konsiston në analizimin e diferencave domethënëse që paraqet çdo organ në lidhje me mesataret e organeve të të njëjtit nivel të cilat krahasohen ose, sipas rastit, të krahinës, të bashkësisë autonome apo në nivel kombëtar, në raport me një sërë parametrash të vendosur.

Ky ishte përparimi i parë i madh në përdorimin e mjeteve teknologjike që janë në dispozicion të shërbimit të inspektimit, por ky lloj inspektimi është i kufizuar pasi nuk përfshin ekzaminimin e veprimeve ose të librave dhe llogarive që janë thelbësore për verifikimin dhe kontrollin e funksionimit të Administratës së Drejtësisë. Megjithatë, bën të mundur kontrollimin e gjendjes së të gjitha organeve në nivel kombëtar dhe zbulimin e atyre që paraqesin devijime nga parametrat e vendosur duke kryer studime krahasuese të situatës së çdo organi në lidhje me ato të të njëjtit nivel, në një territor të caktuar apo në nivel kombëtar.

V. Konkluzion

Shkurtimisht, kryerja e inspektimeve virtuale dhe telematike është një angazhim për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të optimizuar funksionimin e shërbimit të inspektimit dhe është në përputhje me misionin, vizionin, vlerat dhe politikën e cilësisë së organit që, ndër të tjera, parashikon se shërbimi i inspektimit është i përkushtuar ndaj efikasitetit, cilësisë dhe frymës së krijimtarisë dhe inovacionit të burimeve të përdorura në kryerjen e aktiviteteve të inspektimit, përgjegjësisë sociale dhe respektit për mjedisin, për të cilat kontribuon reduktimi i përdorimit të letrës, si dhe racionalizimi i shpenzimeve publike.

KALIMI NGA ORGANET INSPEKTUESE TË BAZUARA NË VLERËSIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE (INSPEKTIME NDAJ MAGJISTRATËVE) NË SHËRBIMET PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIMIN E CILËSISË DHE PERFORMANCËS SË GJYKATAVE (INSPEKTIMET E BAZUARA NË GJYKATA). DISA MËSIMET NGA PROJEKTET NË SHTETET ANËTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS DHE MË GJERË. METODAT DHE SFIDAT E MUNDSHME PËRPARA PËR SHËRBIMET E INSPEKTIMIT GJYQËSOR.



Vincent Delbos

Anëtar i Komisionit për Parandalimin e Torturës, Këshilli i Evropës

Z. Vincent Delbos ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për vite me radhë, si dhe të anëtarit të Komisionit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës.

Në të njëjtën kohë, z. Delbos ka ushtruar detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë së Francës. Z. Delbos ka ushtruar dhe detyrën e Kontrollorit të Përgjithshëm të Vendeve të Ndalimit apo Kufizimit të Lirisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Abstrakti i prezantimit

Si të kalohet nga “organe inspektimi përgjegjëse për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” (“judges-based inspections”) në shërbime të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë dhe performancës së gjykatave (court-based inspections)?

Përgjatë prezantimit tim, do të doja t’ju çoja në një udhëtim të shkurtër në disa vende anëtare të Këshillit të Evropës dhe më tej. Një udhëtim nëpër disa sisteme drejtësie të cilat janë në vështirësi, madje në krizë, ku qytetarët kërkojnë forcimin e tyre.

Ne jetojmë në një paradoks të çuditshëm: asnjëherë kërkesa për drejtësi nuk ka qenë kaq e fortë dhe asnjëherë sistemet e drejtësisë nuk kanë qenë në gjendje kaq të keqe.

Para gjashtë muajsh në Francë, më shumë se gjysma e gjyqtarëve dhe prokurorëve nënshkruan një petition për të denoncuar kushtet e punës, gjë që shkaktoi ngritjen nga ana e ekzekutivit të asambleve të përgjithshme të drejtësisë, si në kohën e Revolucionit Francez.

Në Armeni, një nga themelet e “revolucionit” të kadifenjtë të vitit 2018 ishte kërkesa për një drejtësi më pak të korruptuar, më të pavarur dhe më të paanshme.

Në vendet e jugut të Mesdheut, lëvizjet shoqërore të këtyre viteve të fundit kanë vënë në qendër të pretendimeve të tyre kërkesën e qytetarëve për drejtësi.

Ka një pikënisje: nevoja për vlerësimin e drejtësisë, element kyç i besimit të qytetarëve në shtetin e të drejtës.

Kush është ai që i vlerëson sistemet e drejtësisë? Auditues të jashtëm? Organizatat e shoqërisë civile? Qytetarët? Ekzekutivi? Legjislativi?

Nevoja për këtë vlerësim është e rëndësishme, pasi në tërësi, nëse shohim raportet e CEPEJ, drejtësia si një shërbim publik është ende shumë i kërkuar, është ende i pafinancuar në masën e duhur dhe shpeshherë nuk kryen funksionin e saj. Në këto kushte lind

pyetja: Në cilat drejtime duhet të rriten burimet për financimin e sistemit të drejtësisë?

Në këtë kuadër, shtrohet për diskutim në disa aspekte veprimtaria e organeve, të cilat janë kompetente në këtë fushë:

- ▶ Cilat organe kanë njohuri mbi mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë;
- ▶ Çfarë ndikimi kanë një sërë procesesh si hetimi administrativ apo vlerësimi i punës së magjistratëve në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë. Të drejta dhe detyrimet;
- ▶ Cilat janë disa nga mësimet e nxjerra nga projektet e kohëve të fundit;
- ▶ Si mund të shkohet drejt procesit të inspektimit të sistemit të drejtësisë me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemeve të drejtësisë.

1. Çfarë ndikimi kanë një sërë procesesh si hetimi administrativ apo vlerësimi i punës së magjistratëve në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë. Të drejtat dhe detyrimet.

Masat e ndërmarra dëri më tani tregojnë se veprimtaria kryesore e organeve kompetente për inspektimin e sistemeve të drejtësisë fokusohet në zhvillimin e hetimeve administrative dhe disiplinore ndaj punës së magjistratëve. Këto masa konsistojnë në metoda apo praktika pune, të cilat synojnë respektimin e parimit të kontradiktorialitetit, transparencës, mbrojtjes efektive apo përcaktimin e rregullave deontologjike të sjelljes profesionale të magjistratëve.

Këto masa pasqyrojnë indirekt pritshmëritë e këshillave të drejtësisë si organe përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të drejtësisë, por

nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pritshmëritë e qytetarëve apo përdoruesve të tjerë të sistemit të drejtësisë.

Mënyra e fillimit të hetimeve administrative, të cilat kanë karakter individual (dhe që kryhen rast pas rasti), si dhe shkaqet për të cilat ka filluar hetimi administrativ pasqyrojnë pjesërisht mangësitë apo vështirësitë që hasin sistemet e drejtësisë. Ky informacion i përfituar nëpërmjet zhvillimit të hetimeve disiplinore mund të plotësohet edhe me informacion shtesë nga veprimtaria e organeve të inspektimit lidhur me vlerësimin e punës apo vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto informacione janë një tregues i rëndësishëm për mënyrën e funksionimit të sistemeve të drejtësisë por nuk janë të qarta dhe të plota.

Duke qenë se treguesit lidhur me vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve synojnë të masin përputhshmërinë e veprimtarisë së magistratëve me rregullat dhe procedurat ato pasqyrojnë vetëm një pjesë të veprimtarisë së sistemit të drejtësisë. Janë ende të rralla shërbimet e inspektimit, të cilat aplikojnë metoda vlerësimi të plota 360° dhe që kryhen në përgjithësi nga ana e Këshillave të Drejtësisë. Në këto kushte arrihet në përfundimin se zhvillimi i hetimeve disiplinore apo proceseve të vlerësimin të punës së magistratëve janë të dobishme por të pamjaftueshme për të dhënë një pamje shëruese të funksionimit të sistemeve të drejtësisë.

2. Disa mësimë të nxjerra nga projekte të kohëve të fundit

Për të përmirësuar performancën e sistemeve të drejtësisë, për të reduktuar afatet, për të kuptuar ngarkesën e punës së gjyqtarëve, si dhe për të bërë të mundur shpërndarjen e çështjeve në mënyrë sa më objektive është e nevojshme të merren masa të mëtjetshme. Sistemet e drejtësisë duhet të pajisen me struktura të posaçme, të cilat bëjnë të mundur këtë vrojtim “endogjen” të funksionimit të tyre.

Shumë projekte të kohëve të fundit tregojnë nevojën për të shkuar më tej, por edhe që është e mundur të kalohet nga inspektime të bazuara te gjyqtarët në inspektime të bazuara në analizën e funksionimit të gjykatave dhe tribunalëve dhe që kjo qasje është premtuese.

- ▶ Në Jordani, Bashkimi Evropian mbështet një projekt të forcimit të inspektoratit gjyqësor, që ka për funksion kryesor inspektimin e gjyqtarëve, vlerësimin e tyre, por edhe atë të gjykatave e tribunalëve. Në të njëjtën kohë, këtij organi i është besuar për qëllime disiplinore edhe trajtimi i ankesave të qytetarëve në lidhje me sistemin e drejtësisë. Si mund të bëhet e mundur kjo? Duke i analizuar këto ankesa në bazë të disa kriterëve si: (i) bëhet fjalë për një mosfunksionim me karakter individual që është raportuar apo për një çështje strukturore? (ii) A nuk ngre përsëritja e ankesave dhe akuzave në lidhje me një lloj mosmarrëveshjeje çështje të përdorimit të gabuar të burimeve njerëzore? (iii) elemente të dobishme për Këshillin e Lartë Gjyqësor (HJC) me qëllim që ai t'i pajisë më mirë disa gjykata me gjyqtarë dhe me personel. Vetëm një inspektim i bazuar në një analizë të hollë të funksionimit të gjykatave është në gjendje të sjellë të dhëna, një panoramë objektive dhe të paanshme që do të ndihmojë në vendimmarrjen e HJC, apo organeve të tjera ligjvënëse.
- ▶ Në Armeni, problematika është disi e ndryshme: ka një kërkesë për të bashkë-ndërtuar një instrument vlerësimi të gjykatave të dobishëm për gjyqtarët dhe për shërbimet mbështetëse. Kultura e vlerësimit është e re dhe për rrjedhojë kultura e sigurimit të të dhënave është e dobët. Tërësia e mjeteve ekziston, është ajo e CEPEJ, në lidhje me vendimet, me inventarët, rastet komplekse, apo ngarkesën e punës. Për vënien në zbatim apo për të pilotuar trajnimet e nevojshme të aktorëve, sigurisht ekziston një inspektorat, por ai ka një mandat ekskluziv dhe të përcaktuar vetëm për procedurat disiplinore, si dhe është i përqendruar në duart e pushtetit ekzekutiv. Në këto kushte lind pyetja, kush

do t'i bëjë? Kush do t'i prodhojë udhërrëfyesit e nevojshëm dhe tabelat e kontrollit? Këshilli Suprem Gjyqësor (SJC), ekuivalenti i Këshillit të Drejtësisë që është njëkohësisht i ngarkuar me vlerësimin katërvjeçar të gjyqtarëve duhet të ngarkohej si fillim edhe me kryerjen e këtij vlerësimi.

Aktivitetet kryesore të RESIJ të ndërmarra së pari përmes projektit të vlerësimit të instrumenteve të bashkëpunimit civil dhe më pas në kuadër të masave ndërkufitare për mbrojtjen e personave vulnerabël ishin një tregues mbi nevojën dhe dobishmërinë e aplikimit të një qasjeje tematike, më gjithëpërfshirëse dhe me karakter global.

Veprimtaria e disa inspektorateve është e fokusuar kryesisht në kontrollin e veprimtarisë së gjykatave sipas një qasjeje nga poshtë-lartë (Bottom up), por ky proces nuk ndiqet nga të gjithë inspektoratet. Mendimi im është që të gjithë inspektoratet duhet të ndjekin këtë rrugë. Nga përvoja e kohëve të fundit, rezulton se ka një tendencë që inspektoriatet po rrisin dhe forcojnë kompetencat e tyre të reja në këtë drejtim.

Duke qenë se inspektoratet përbëhen në pjesën më të madhe të tyre nga magistratë, të cilët kanë njehuri lidhur me proceset dhe vendimet gjyqësore, parimin e kontradiktorialitetit, parimin e barazisë së armëve, këto organe kanë luajtur një rol kyç për përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

3. Si të shkohet më tej?

Shumë shembuj tregojnë se ka rrugë të tjera, të cilat mund të ndiqen dhe që garantojnë siguri, si:

Thellimi i inspektimeve në lidhje me funksionimin e gjykatave dhe tribunalëve. Por a është kjo gjithmonë e mundur. Në këtë rast mund t'i referohemi shembullit të ndjekur në Jordani lidhur me

inspektimin e procedurave të gjykimit dhe veprimtarisë së gjykatës penale kombëtare.

- ▶ Zhvillimi i analizave me karakter tematik lidhur me funksionimin e brendshëm të sistemeve të drejtësisë, si:
 - ▶ Analiza e ndikimit të një reforme: për shembull vendosja e gjyqtarëve të specializuar, efektet e nxjerrjes jashtë juridiksionit gjyqësor të një kategorie të veçantë çështjesh apo tjetër.
 - ▶ Përmes shqyrtimit të një problematike, nga pikëpamja e organizimit dhe strukturës, organikën dhe burimet njerëzore, organizimin dhe funksionimin e një juridiksioni të caktuar, apo ndarja e punës.
- ▶ Vlerësimi i rolit që mund të pëmbushin sistemet e drejtësisë në rregullimin e një sërë çështjesh apo mosmarrëveshjesh të reja si drejtësia dhe mjedisi.

Për sa më sipër, arrihet në përfundimin që kjo rrugë është jo vetëm e mundur, por edhe e domosdoshme dhe e nevojshme. Sigurisht, ajo ndryshon profesionin e inspektorit të drejtësisë që megjithatë nuk bëhet një formë super-konsulenti sepse ai është pjesë e sistemit të drejtësisë, por mund të jetë një këshilltar (adviser) i dobishëm për sistemin e drejtësisë dhe për të luajtur një rol nxitës në ndryshimet që po ndodhin.

NË VEND TË MBYLLJES

Artur Metani

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në Shqipëri

Z. Artur Metani ka përfunduar në vitin 1996 studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjatë viteve 2002-2012, z. Metani ka punuar si Këshilltar Juridik i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, si dhe gjatë periudhës kohore 1998-2008 është angazhuar si asistent pedagog/lektor i të Drejtës Kushtetuese pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Për periudhën kohore 2013-2017, ka drejtuar Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave. Ndërsa gjatë periudhës kohore 2017-2018, ka qenë anëtar zëvendësues i Komisionit të Venecias si dhe ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, Këshilli i Ministrave. Në periudhën kohore 2018-2020, z. Metani ka mbajtur pozicionin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, si dhe ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Aktualisht mban pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 2/2020.

Abstrakti i prezantimit

Cilësia e drejtësisë është prioritet për të gjitha vendet. Koncepti i “cilësisë së drejtësisë” nuk përfshin vetëm cilësinë e vendimeve gjyqësore, të cilat përgjithësisht i nënshtrohen kontrollit brenda vetë gjyqësorit, por përfshin një sërë elementesh që lidhen me funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë. Ky mision i rëndësishëm, në lidhje me garantimin e këtyre standardeve, i është besuar institucioneve tona, institucioneve të inspektimit.

Parimet bazë që zbatohen në organizimin e gjyqësorit bazohen në parimin universal të pavarësisë së gjyqësorit. Duhet pranuar se rritja e kompetencës dhe pavarësisë së magistratëve duhet të shoqërohet nga një sistem llogaridhënës. Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por përgjegjësi. Në këtë rast, duhet të ketë një proces të vazhdueshëm të balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Nga ana tjetër niveli i besimit të qytetarëve tek gjyqësori është një element shumë i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë. Megjithatë, fitimi i besimit të publikut nuk do të thotë se gjyqësori duhet të jetë nën presion të vazhdueshëm për të marrë vendime që publiku duhet t'i pëlqejë ose detyrimisht t'i pranojë.

Një vendim gjykate mund të nxisë kundërshtimin e publikut dhe madje zemërimin apo ndjenjën e protestës. Por, në këtë rast rëndësi ka reagimi. Vendimet gjyqësore mund të jenë objekt diskutimi dhe debati publik, por ato janë gjithmonë të detyrueshme për zbatim. Forma më e lartë e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë është respektimi dhe njohja e “legjitimitetit” të pushtetit gjyqësor.

Të nderuar kolegë,

Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë, përtej ndryshimeve mes vendeve, nuk është një stacion fundor për askënd, por një proces dinamik dhe vazhdimisht në zhvillim. Megjithatë, themelore ka qenë dhe mbetet, për të gjitha vendet, gjetja e balancës mes të drejtës që ka publiku për të ditur se si administrohet drejtësia nga gjykatat dhe prokuroritë, e nga ana tjetër, të pavarësisë së vetë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjetja e kësaj balance nuk është aspak e thjeshtë, nuk është e shkruar diku, por vjen si rrjedhojë e përvojave më të mira, e studimeve dhe analizave, e vlerësimit të çështjeve përpara nesh, në raport me këto parime kushtetuese.

Në këtë këndvështrim, programi i konferencës ishte intensiv dhe

çështjet e diskutuara ishin të shumta. Por, besoj ishte një debat i nevojshëm dhe shumë frytdhënës për të gjithë ne. Dhe në përpjekje për të sintetizuar disa mendime dhe ndjesi që erdhën nga kjo konferencë, por edhe personale gjithashtu, çmoj që mendimet e mia në kuadër të mbylljes së këtij aktiviteti t'i shpreh mbi bazën e disa koncepteve themelore apo faktorëve që janë të lidhur ngushtë dhe që ndikojnë në mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të punës së magistratëve dhe si rrjedhojë edhe e sistemit të drejtësisë, si më poshtë:

► CILËSIA E DREJTËSISË

- Cilësia e drejtësisë është një prioritet i të gjitha vendeve. Ka probleme të cilat janë të njëjta për vendet e Bashkimit Evropian. Disa janë në bllok për të gjitha vendet e Këshillit të Evropës dhe të tjera janë specifike për secilin prej tyre.
- Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Realizimi i këtij qëllimi kërkon një nevojë të vazhdueshme për t'iu përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të rinj të mbrojtjes së tyre.
- Veprimtaria e magistratëve, por edhe gjykatat, prokuroritë apo institucionet e tjera të drejtësisë duhet t'i nënshtrohen kontrollit apo vlerësimit në aspekt të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë së tyre.
- Koncepti i "*cilësisë së drejtësisë*" nuk përfshin vetëm cilësinë e vendimeve gjyqësore, të cilat përgjithësisht janë objekt kontrolli brenda vetë pushtetit gjyqësor, por përfshin një sërë elementesh të cilat lidhen me mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë si qartësia e zhvillimit të procedurave dhe vendimeve gjyqësore, aksesit i individëve te organet e sistemit të drejtësisë, infrastruktura, afatet apo mekanizmat e vënë në dispozicion të publikut.
- Efikasiteti i punës së magistratëve nga njëra anë dhe i sistemeve

të drejtësisë nga ana tjetër është kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë individëve, për respektimin e kërkesave të një gjykimi të drejtë, për të pasur siguri juridike dhe për të garantuar besimin e publikut në shtetin e së drejtës.

► **BESIMI I PUBLIKUT**

- Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë. Në demokraci drejtësia jepet në emër të qytetarëve. Besimi i publikut është i domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe ky legjitimim kërkon angazhimin e të gjitha shoqërive për të ruajtur këtë besim.
- Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë, pasi ai është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar se si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sundimi i ligjit në një vend.
- Në këtë kuadër, një magjistrat nuk duhet të jetë përgjegjës vetëm për respektimin apo jo të normave ligjore, por edhe ndaj njerëzve, shoqërisë si dhe organeve të pushtetit shtetëror. Duke ndikuar kështu, në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.
- Megjithatë fitimi i besimit të publikut, nuk do të thotë që pushteti gjyqësor duhet të jetë në një trysni të vazhdueshme për të dhënë vendime të cilat duhet t'i pëlqejnë publikut, apo publiku duhet të pajtohet domosdoshmërisht me to. Madje gjykatat duhet të jenë të pavarura dhe nuk duhet të ndikohen nga perceptimi i publikut mbi një çështje të caktuar.
- Një vendim gjyqësor mund të ngjallë kundërshtim publik deri

dhe në zemërim apo ndjenjë proteste. Por në këtë rast rëndësi ka REAGIMI. Mënyra se si publiku reagon ndaj një vendimi gjyqësor, si dhe debati i krijuar shërben jo vetëm si frymëzim dhe si një ndihmesë për formimin e karakterit social dhe politik të shoqërisë së një vendi, por edhe si tregues i nivelit të besimit të tij ndaj sistemit të drejtësisë.

- Vendimet gjyqësore mund t'i nënshtrohen diskutimit dhe debatit publik, por janë gjithmonë të detyrueshme për zbatim. Forma më e lartë e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë është respekti dhe njohja e “legjitimitetit” të organeve të pushtetit gjyqësor. Kjo arrihet atëherë kur qytetarët e një vendi njohin, zbatojnë dhe respektojnë me devotshmëri vendimet e pushtetit gjyqësor, duke pranuar “legjitimitetin” e tij në çdo rast, pavarësisht nëse janë dakord me të.
- Tashmë sfida e të gjithëve ne, nuk është më koha për të fituar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, por ndërtimi i një sistemi drejtësie, i cili të respektohet nga ana e tij.

► PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE

- Sistemi i drejtësisë, krahas veçorive dhe specifikave të cilat mund të ketë në vende të ndryshme, karakterizohet nga të njëjtat vlera, si dhe funksionon mbi të njëjtat standarde ndërkombëtare dhe parime të organizimit apo funksionimit të tij.
- Parimet themelore të aplikuara për organizimin e pushtetit gjyqësor mbështeten në parimin universal të pavarësisë gjyqësore. Gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm është institucioni me vlerën më të lartë në çdo shoqëri dhe përbën një shtyllë të domosdoshme të demokracisë dhe sundimit të ligjit.
- Pavarësia e pushtetit gjyqësor mund të shoqërohet me ndryshime strukturore, institucionale dhe ligjore, por ajo

mund të ketë sukses vetëm kur shoqëria e një vendi të ketë besim në legjitimitimin e pushtetit gjyqësor dhe të tregojë një përkushtim real ndaj këtij standardi.

- Ekziston një prirje e rëndësishme për të siguruar pavarësinë e pushtetit gjyqësor nëpërmjet vendosjes së garancive formale dhe procedurave fikse. Edhe pse është e rëndësishme të pranohet që sistemet gjyqësore në vende të ndryshme kanë pasur evoluim apo rrugëtime të ndryshme të konsolidimit të tyre. Megjithatë, është i diskutueshëm fakti nëse duhet të aplikohet një standard ndërkombëtar uniform.

► SISTEMI LLOGARIDHËNËS

- Duhet pranuar se rritja e kompetencës dhe pavarësisë së magistratëve duhet të shoqërohet me një sistem llogaridhënës efektiv.
- Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi. Në rastin konkret duhet të ekzistojë një proces i vazhdueshëm i balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Këto procese duhet të karakterizohen nga veprimi dhe kundër reagimi në të njëjtën kohë. Sa më shumë kompetenca të zotërojnë pushteti gjyqësor, aq më të larta duhet të jenë kërkesat për llogaridhënie.
- Funkzioni i magistratëve të pavarur dhe të ngarkuar me interpretimin dhe zbatimin e ligjit njihet në mënyrë universale si tipari themelor i shtetit demokratik modern, gur themeli i vetë shtetit të së drejtës, por *ky pushtet nuk është absolut*. Kjo pasi magistratët janë përfaqësues të organeve publike dhe ato kanë vetëm atë pushtet çfarë u cakton rendi juridik.
- Për këtë qëllim, është e nevojshme që organet e qeverisjes së gjyqësorit të kenë një qasje aktive ndaj **sistemit llogaridhënës** të magistratëve duke aplikuar qasje të reja, të cilat konsistojnë në aplikimin në mënyrë të kombinuar të

standardeve të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së tyre.

- Sistemi llogaridhënës i magistratëve nuk duhet të keqpërdoret nga ana e organeve të tjera të pushtetit me qëllim kontrollin dhe cenimin e pavarësisë gjyqësore.
- Sistemi llogaridhënës duhet të udhëhiqet pikësëpari nga nocioni i përgjegjshmërisë së magistratëve, si një mekanizëm parandalues dhe që siguron ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

► **SISTEMI I PËRGJEGJËSISË**

- Në rast se këto mjete nuk rezultojnë efektive, atëherë në raste përjashtimore, si dhe në varësi të rrethanave të caktuara mund të aplikohen masat mbi përgjegjësinë penale, civile apo disiplinore të tyre, si dhe gjithmonë në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, sipas kërkesave të nenit 6/1 të KEDNJ-së.
- Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së magistratëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në ligj. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep magistratëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim.

► **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT**

- Legjislacionet kombëtare të vendeve të ndryshme ofrojnë modele të ndryshme të organizimit, funksionimit, apo raporte që organet e inspektimit të sistemit të drejtësisë kanë me institucionet e tjera.
- Çdo model i përzgjedhur duhet kuptuar si rezultat i zhvillimeve historike, traditës ligjore dhe kushtetuese, apo asaj politike

dhe sociale të secilit vend. Këta faktorë diktojnë dhe rezultatin e arritur.

- Ndërsa ushtrimi i të drejtës së ankimit dhe kontrolli nga një gjykatë më e lartë dhe brenda vetë pushtetit gjyqësor është mekanizmi i zbatuar tradicionalisht nga sistemet e drejtësisë për të garantuar kontrollin, cilësinë e një procesi gjyqësor, apo bazueshmërinë e së drejtës, sot ky mekanizëm po plotësohet me forma të tjera të jashtme kontrolli për të matur apo mbikëqyrur cilësinë e drejtësisë në kuadër të zhvillimit në mënyrën e duhur të proceseve gjyqësore dhe menaxhimit efektiv të organeve të sistemit të drejtësisë.
- Ky mision i rëndësishëm, lidhur me garantimin e këtyre standardeve i është besuar institucioneve tona, institucioneve të inspektimit.
- Shërbimet e inspektimit duhet të përshtatin dhe të aplikojnë metodologji të posaçme kontrolli, si dhe ky proces duhet të realizohet gradualisht dhe mbështetur në një sërë kriteresh, standarde dhe garanci të mirëpërcaktuara.
- Rregullat lidhur me organizimin dhe funksionimin e tyre duhet të përcaktohen qartë dhe në mënyrë shteruese në aktet më të larta hierarkike legjislative si Kushtetuta apo të paktën në legjislacionin parësor të secilit vend. Kjo shërben si një garanci dhe stabilitet për veprimtarinë e tyre.
- Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit është garantimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së veprimtarisë së tij. Shërbimi i inspektimit duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe nga organi që vendos për vendosjen e sanksioneve disiplinore. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet aplikimit të politikave apo masave të cilat synojnë garantimin e pavarësisë substanciale, strukturore dhe financiare të këtyre organeve. Nga ana tjetër për të siguruar besueshmëri dhe legjitimitet duhet që rekrutimi apo përzgjedhja e punonjësve të kryhet në bazë të meritave.

► BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSPEKTORATEVE

- Për të arritur këto, të gjithë ne duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë.
- Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit; shkëmbimit të të dhënave; apo dhe ndihmës juridike të ndërsjelltë ndërmjet shteteve.
- Në të njëjtën kohë, ky proces duhet të realizohet duke mbajtur në konsideratë zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian të transpozuar në legjislacionet kombëtare; parimet, frymën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; aktet e Këshillit të Evropës; si dhe në aplikim të metodave, instrumenteve dhe praktikave më të mira të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor.
- Duke vepruar kështu, të gjithë ne do të kontribuojmë në funksionimin e duhur të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë, duke arritur qëllimin tonë të përbashkët.

Të nderuar kolegë,

I nderuar lexues,

Drejtësia ka kontributin e vet në jetën dhe cilësinë e çdo shoqërie. Krijimi apo konsolidimi i shtetit të së drejtës nuk është një proces i lehtë. Në çdo vend, ky është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm për gjetjen e mekanizmave të duhur, të cilat siguro-

jnë respektimin e një sërë standardesh apo vlerash për një sistem drejtësie efikas, të përgjegjshëm dhe të pavarur.

Një sistem drejtësie efikas, një sistem llogaridhënës efikas dhe një demokraci funksionale nuk mund të ngrihen dhe as të kenë sukses nëse nuk mbështeten fort në vizionin afatgjatë të balancimit të interesit të publikut për punën e magistratëve dhe pavarësisë së tyre. Kjo pavarësi nuk është dhe nuk duhet të shihet si një parim për të mbrojtur shkeljet e ligjit, që magistratët mund të kryejnë apo pretekst për të anashkaluar përgjegjësinë e tyre ligjore. Aspak! Por, nëse një gjyqtar ose prokuror vihet para përgjegjësisë sot, sepse shoqëria nuk është dakord me vendimin e tij apo se shoqëria nuk orientohet tek institucionet, të cilat, Kushtetuta, ligji dhe shteti i së drejtës ka ngritur enkas, pikërisht për trajtimin e pakënaqësive ndaj sistemit gjyqësor apo më keq akoma, sepse pushtete të tjera duan të përfitojnë nga pamundësia ligjore e reagimit publik të gjyqtarëve dhe prokurorëve, atëherë nuk mund të kemi demokraci funksionale, por vetëm zgjatje të agonisë tonë në përpjekjet për zhvillim.

Nga ana tjetër, ky parim i ndarjes së pushteteve nuk mund të ketë sukses, dhe më pas as vetë shteti i së drejtës nuk ka për të patur sukses, nëse ne nuk e kultivojmë drejtësinë si një vlerë shoqërore, nuk e kultivojmë ndarjen e pushteteve, si një sistem që garanton paanësi dhe qetësi. Drejtësia nuk mund të jetë statistikë. Ajo duhet të jetë standard. Gjyqtarët dhe prokurorët vijnë nga shoqëritë tona, që së bashku po përpiqemi të konsolidojmë. Pra, edhe magistratët reflektojnë patjetër të mirat dhe të këqijat e shoqërive tona, karakterin dhe problemet tona. Për këtë arsye, mendoj unë, që drejtësia nuk mund të jetë thjesht numra gjyqtarësh dhe prokurorësh të shkarkuar e proceduar, por vetëm standardesh të kultivuara dhe të vendosura për të ardhmen. Dhe për këtë, konsolidimi i shtetit të së drejtës nuk është një betejë vetëm e institucioneve të drejtësisë. Padyshim që ato kanë rolin dhe përgjegjësinë më të madhe. Por, ajo është përgjegjësi morale e të gjithëve ne, edhe e institucioneve

të tjera, e politikës, e medias, e shoqërisë në përgjithësi, që të kultivojmë sensin e së drejtës dhe të ndarjes së punëve, në një shtet demokratik.

Për këtë shkak, konferenca apo takime si i këtij qershori në Tiranë, i shërbejnë më së miri shkëmbimit të mendimeve mbi këto çështje, të gjetjes së praktikave më të mira në përgjigje të dinamizmit të zhvillimeve shoqërore dhe mbi të gjitha në përputhje me standartet dhe vizionin e ndarjes së pushteteve. Kjo, jo vetëm për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet zyrave tona, por çmoj të evidentoj se respektimi i të drejtave të njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës përbëjnë një aset kryesor për Bashkimin Evropian dhe ruajtja apo sigurimi i tyre përbën një përgjegjësi të përbashkët për të gjitha institucionet e BE-së, si dhe shtetet anëtare të tij. Megjithatë qasja ndaj tyre, nuk duhet të shihet si kufi, pengesë apo kusht ndaj shteteve të tjera jo anëtare, por si një simbol, i cili na bashkon të gjithëve ne. Evropa para se të jetë një projekt politik është një sistem vlerash njerëzore. Pasi në fjalët e Jean Monnet, Bashkimi Evropian nuk ka për qëllim bashkimin e shteteve, por mbi të gjitha bashkimin e njerëzve të cilët besojnë dhe jetojnë në sistemin e vlerave evropiane.





